

**VLERËSIME DHE KONKLUSIONE NGA RAPORTET E
PUNËS SË GJYKATAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË
SË VERIUT, PËR VITIN 2021**

HYRJE

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me Rendin kushtetues dhe parimin e ndarjes së pushteteve, si gjykatë më e lartë në shtet dhe bartëse e pushtetit gjyqësor, përmes kompetencës së Seancës së përgjithshme e ndjek punën e të gjitha gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në mënyrë që siguron principin e unitetit dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, jep vlerësimin e funksionimit të tyre nga aspekti i përditësimit dhe kualitetit në sigurimin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe ofrimin e sigurisë juridike të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në përputhje me Ligjin për gjykatat dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 29.03.2022 u mbajt Seancë e përgjithshme e zgjeruar për shqyrtimin e raporteve të punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, ku ishin të ftuar dhe të pranishëm kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative dhe kryetarët e gjykatave të apelit Shkup, Manastir, Gostivar dhe Shtip, ndërsa nuk ishin të pranishëm përfaqësuesit nga Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për sigurimin e parimit të transparencës, të ftuar dhe që ndoqën me interes të madh punën e Seancës së përgjithshme të zgjeruar ishin përfaqësues të mjeteve për informimin publik, shtëpitë televizive dhe portalet e internetit.

Të dhënat nga raportet e gjykatave për vitin 2021, tregojnë se nga gjyqtarët dhe shërbimi gjyqësor është bërë një përpjekje e madhe në mënyrë që mund të konstatohet se edhe në kushte të jashtëzakonshme të pandemisë së shkaktuar nga Kovid 19, me resurset njerëzore ekzistuese, kuadrin e gjyqtarëve dhe shërbimin profesional, teknologjinë informatike, kushtet hapësinore dhe financiare materiale, një numër i madh i gjykatave me përditësim e kanë përfunduar vitin raportues.

Gjykatat vitin 2021 e kanë filluar me 98.188 lëndë, si pjesë e mbetur e vitit të kaluar. Gjatë vitit 2021 të reja të pranuar janë 524.771 lëndë, së bashku me lëndët përsëri në punë 5.132 dhe 269 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej ka pasur 627.837 lëndë. Të kryera janë 531.957, lëndë, kurse kanë mbetur të pakryera 95.880 lëndë. Me atë, si konstatim përfundimtar pozitiv është se një numër i konsiderueshëm i gjykatave në vitin 2021 kanë arritur të tejkalojnë fluksin e lëndëve dhe të zvogëlojnë numrin e lëndëve që kanë mbetur.

Gjykata Administrative e Lartë gjatë vitit 2021, në punë ka pasur gjithsej 4.297 lëndë, të reja të pranuar janë 3.155 lëndë. ndërsa të kryera janë 3.502 lëndë, ashtu që është tejkaluar fluksi i lëndëve.

Gjykata Administrative gjatë vitit 2021, në punë ka pasur gjithsej 13.434 lëndë, të reja të pranuar janë 8.871 lëndë ndërsa të kryera janë 7,854 lëndë, në mënyrë që është tejkualuar fluksi i lëndëve.

Gjykatat e apelit gjatë vitit 2021 në punë kanë pasur gjithsej 32.625 lëndë, të reja të pranuar janë 24.856 lëndë ndërsa të kryera janë 23,916 lëndë, në mënyrë që nuk është tejkualuar fluksi i lëndëve.

Gjykatat themelore gjatë vitit 2021, në punë kanë pasur gjithsej 577.481 lëndë, të reja të pranuar janë 487.889 lëndë ndërsa të kryera janë 496.685 lëndë, në mënyrë që kanë arritur që të tejkalojnë fluksin e lëndëve.

Nga vlerësimet e miratuara dhe konkluzionet e nxjerra sipas raporteve të punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe propozim masat e dhëna ngelet përshtypja se mund të arrihen rezultate edhe më të mira në qoftë se plotësohen vendet e zbrazura për gjyqtarë me zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj, të plotësohen vendet e zbrazura të punës në shërbimin gjyqësor për të gjitha profilet me kuadro përkatës, të sigurohet edukimi i vazhdueshëm, si dhe me rikuperimin e pajisjes informatike, përmirësimin e kushteve hapësinore dhe gjendjes materiale dhe financiare.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut i miratoi si vijon:

VLERËSIMET DHE KONKLUZIONE MBI PUNËN E GJYKATAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, PËR VITIN 2021

GJYKATA E LARTË ADMINISTRATIVE

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në fillim të periudhës raportuese për vitin 2021, në Gjykatën e Lartë Administrative kanë mbetur 1.147 lëndë të pakryera, 3.155 janë lëndë të reja të pranuar, 5 lëndë janë të evidentuara gabimisht ose gjithsej në punë ka pasur 4.297 lëndë gjatë tërë vitit, nga të cilat 3.502 janë lëndë të kryera, ndërsa kanë mbetur të pakryera 795 lëndë.

Gjatë vitit 2021 Gjykata e Lartë Administrative, në mënyrë administrative ka kthyer në Gjykatën administrative 230 lëndë për shkak të lëshimeve në përgatitjen e lëndëve dhe në veprimet jo në tërësi të ndërmarra, kurse prej tyre vetëm 222 lëndë janë kthyer në Gjykatën e Lartë Administrative.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore, në fillim të vitit 2021 nuk ka pasur lëndë të pakryera nga administrata gjyqësore, të reja të pranuar janë 1.184 lëndë dhe të gjitha janë kryer.

Nga lëndët e pranuar në Administratën gjyqësore në Regjistrin "Su" janë evidentuar 942 lëndë, nga të cilat nën "Su.Str.Dov" janë evidentuar 2 lëndë dhe të njëjtat janë kryer. Në Regjistrin "UPP" janë evidentuar 237 lëndë dhe të njëjtat janë kryer. Në Regjistrin "SPI" janë pranuar 5 lëndë të reja dhe të njëjtat janë kryer.

Puna e sektorëve

Këshilli i specializuar gjyqësor për sferën juridiko–pronësore dhe të drejta tjera

Nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur të pakryera 278 lëndë nga sfera juridiko – pronësore dhe të drejta tjera, të reja të pranuar janë 903 lëndë, të evidentuara gabimisht janë 3 ose gjithsej në punë ka pasur 1.178 lëndë. Janë kryer gjithsej 926 lëndë, kurse kanë mbetur të pakryera 252 lëndë. Në nivelin e këtij këshilli është tejkualuar fluksi për 23 lëndë, përkatësisht është ulur numri i lëndëve që kanë mbetur për 26 lëndë.

Në këtë këshill nga viti i kaluar 2021, kanë mbetur 410 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 803 lëndë, të evidentuara gabimisht 1 lëndë ose në punë kanë qenë gjithsej 1.212 lëndë, nga të cilat 964 lëndë janë të kryera, kurse kanë mbetur 248 lëndë të pakryera. Në nivelin e këtij këshilli është tejkualuar fluksi për 161 lëndë, përkatësisht është zvogëluar numri i lëndëve që kanë mbetur për 162 lëndë.

Këshilli i specializuar gjyqësor për të drejtat tatimore, doganore dhe të drejta tjera

Këshilli i parë për të drejtat nga sfera e të drejtave tatimore dhe të drejta tjera

Në këtë këshill nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur 238 lëndë të pakryera, të pranuar nga sektor tjetër (të rishpërndara) 133 lëndë, të reja të pranuar janë 572 lëndë, gabimisht të evidentuar është vetëm 1 lëndë ose gjithsej në punë kanë qenë 942 lëndë, nga të cilat 758 janë lëndë të kryera, kurse kanë mbetur të pakryera 184. Në nivelin e këtij këshilli është tejkualuar fluksi për 186 lëndë, përkatësisht është zvogëluar numri i lëndëve që kanë mbetur për 54 lëndë.

Këshilli i specializuar për të drejtat tatimore, doganore dhe të drejta tjera

Këshilli i dytë për të drejtat nga sfera e të drejtave doganore dhe të drejta tjera

Në këtë këshill nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur 221 lëndë të pakryera, janë pranuar nga sektor tjetër (të rishpërndara) 133 lëndë, të reja të pranuar janë 877 lëndë ose gjithsej kanë qenë 965 lëndë në punë, nga të cilat 854 lëndë janë të kryera, kurse kanë mbetur 111 lëndë të pakryera. Në nivelin e këtij këshilli nuk është tejkualuar fluksi për 23 lëndë, por është tejkualuar fluksi i lëndëve që kanë mbetur për 111 lëndë.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në Gjykatën e Lartë Administrative deri më 31.12.2021, nuk ka lëndë të vjetra të pakryera.

Burime njerëzore

Në vitin 2021, në Gjykatën e Lartë Administrative ka Kryetar të gjykatës dhe 13 gjyqtarë.

Në këtë gjykatë, të punësuar janë gjithsej 14 nëpunës gjyqësor dhe një pjesëtar i policisë gjyqësore.

Gjatë muajit dhjetor 2021 është shpallur Shpallje publike numër 1/2021 për 5 vende të punës.

Sipas numrit të konstatuar të vendeve të punës në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën e Lartë Administrative, nevojitet plotësimi i numrit të përmbaruesve dhe ri pajisjen me kuadro (para se gjithash daktilografistë dhe bashkëpunëtorë gjyqësorë). Në Gjykatën e Lartë Administrative ka të punësuar vetëm një pjesëtar i policisë gjyqësore, orari i punës i të cilit përfundon në orën 15,30, ndërsa pastaj nuk ka kujdestari, ndërsa për mbrojtjen e gjykatës është vendosur video mbikëqyrës që realizohet përmes 4 kamerave të vendosura në brendinë e pjesëve të hapësirave të Gjykatës.

Kapacitete hapësinore

Nga themelimi i saj Gjykata e Lartë administrative aktivitetet nga kompetenca ligjore i realizon në objektin, në Shkup me sipërfaqe prej 484 m², që disponon me 17 hapësira pune, në të cilat rruhen lëndët për të cilat vendos kjo gjykatë dhe 3 hapësira të vogla ndihmëse që shërbejnë për rruajtjen e materialit për zyra, fotokopjim dhe të ngjashme. Hapësira e theksuar ku është vendosur Gjykata e Lartë Administrative nuk i përmbush nevojat e gjyqtarëve dhe të punësuarve, ngase gjyqtarët janë vendosur në hapësira që janë shumë të vogla edhe atë në një hapësirë nga dy gjyqtarë.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në përdhën raportuese, Gjykata e Lartë Administrative e tejkaloj fluksin e lëndëve për 347, përkatësisht e zvogëloi numrin e lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 352 dhe konsiderohet si **gjykatë e përditësuar**. Kushtet hapësinore për punë nuk i plotësojnë nevojat e gjyqtarëve.

Propozim masa:

Pajisja e gjykatës me kuadro të këshilltarëve gjyqësorë dhe bashkëpunëtorëve si dhe me daktilografistë;

Sigurimi adekuat i kushteve me hapësira për punë në Gjykatën e Lartë Administrative;

Edukimi në vazhdimësi i gjyqtarëve dhe të punësuarve tjerë në gjykatë;

Vendosja elektronike ndërlidhëse e organeve administrative me Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e Lartë Administrative;

GJYKATA ADMINISTRATIVE

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në fillim të periudhës raportuese për vitin 2021, në Gjykatën Administrative kanë mbetur 4.389 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 8.871 lëndë, përsëri në punë janë 222 lëndë, të evidentuara gabimisht janë 48 lëndë ose gjithsej në punë ka pasur 13,434 lëndë, nga të cilat 7.854 janë lëndë të kryera, kurse të pakryera kanë mbetur 5.580 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore nga viti i kaluar kanë mbetur 34 lëndë të pa kryera, të reja të pranuar 1.801 lëndë, të evidentuar përsëri 1 lëndë ose gjithsej në punë ka pasur 1.836 nga të cilat 1.834 të kryera, kurse kanë mbetur të pa kryera 2 lëndë.

Në administratën gjyqësore nga viti i kaluar kanë mbetur 2 lëndë të pakryera, janë pranuar 1.827 lëndë të reja ose gjithsej në punë ka pasur 1.829 lëndë, nga të cilat 1.819 lëndë të kryera, ndërsa kanë mbetur të pakryera 10 lëndë.

Në Regjistrin "Su" janë evidentuar 1.306 lëndë të reja të pranuar, janë kryer 1.300 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 6 lëndë. Në Regjistrin "Su-Dov" janë pranuar 9 lëndë të reja dhe të njëjtat janë të kryera. Në Regjistrin "SPI" janë pranuar 28 lëndë të reja dhe të njëjtat janë kryer. Në Regjistrin "UPP" kanë mbetur nga viti i kaluar 2 lëndë të pakryera, ndërsa janë pranuar 484 lëndë të reja dhe nga gjithsej 486 lëndëve në punë, janë kryer 482 lëndë, ndërsa 4 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Puna në sektorë

Puna e lëndëve në këtë gjykatë në vitin 2021 zhvillohet në tre sektorë të specializuar edhe atë:

Spektori për sferën juridiko – pronësore, denacionalizim, urbanizëm, ndërtimtari dhe të drejta tjera të ngjashme

Në këtë sektor funksionojnë tre këshilla edhe atë: një këshill vepron dhe vendos për lëndë nga sfera juridiko – pronësore dhe të drejta tjera të ngjashme dhe dy këshilla që veprojnë dhe vendosin për lëndë nga sfera e denacionalizimit, urbanizëm, ndërtimtari dhe të drejta tjera të ngjashme.

Gjendja me lëndët nga sfera juridiko – pronësore dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur të pa kryera 505 lëndë nga sfera juridiko – pronësore dhe të drejta tjera të ngjashme, të reja të pranuar janë 1.100 lëndë, të reja të pranuar nga gjyqtar tjetër 15 lëndë, që janë dhënë një gjyqtari tjetër 15 lëndë, të evidentuara gabimisht 1 lëndë ose nga gjithsej 1.604 lëndëve në punë, janë kryer 937 lëndë, ndërsa kanë mbetur 667 lëndë të pakryera. Në nivel të këtij këshilli nuk është tejkualuar fluksi për 163 lëndë, përkatësisht është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 162 lëndë.

Gjendja me lëndët nga sfera e denacionalizimit dhe të drejta tjera, urbanizëm, ndërtimtari dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur të pakryera 1.205 lëndë, të reja të pranuar janë 2.074, të reja të pranuar nga gjyqtar tjetër 173 lëndë, që janë dhënë një gjyqtari tjetër 167 lëndë, të evidentuara gabimisht 17 ose gjithsej në punë kanë qenë 3.268 lëndë, gjithsej janë kryer 2.129 lëndë, kurse kanë mbetur të pakryera 1.139 lëndë. Është tejkualuar fluksi për 55 lëndë, përkatësisht është zvogëluar numri i lëndëve që kanë mbetur për 66 lëndë.

Spektori për pensione, të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe të drejta tjera, doganat dhe të drejta tjera të ngjashme

Në këtë sektor funksionojnë dy këshilla, nga të cilat njëri këshill është kompetent për lëndët nga sfera e pensioneve, të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe të drejta tjera, kurse tjetri për lëndët nga sfera për doganat dhe të drejta tjera.

Gjendja me lëndë nga sfera e pensioneve, të drejtat për sigurimin pensional dhe invalidor dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur të pakryera 242 lëndë, të reja të pranuar janë 895 lëndë, të reja të pranuar nga një gjyqtar tjetër 91 lëndë, që janë dhënë një gjyqtari tjetër 91 lëndë, të evidentuara gabimisht 3 ose gjithsej në punë kanë qenë 1.134 lëndë, gjithsej janë kryer 635 lëndë, kurse kanë mbetur të pakryera 499 lëndë. Nuk është tejkualuar fluksi i lëndëve për 260, përkatësisht është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur për 257.

Gjendja me lëndët nga sfera e doganave dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur të pakryera 1.472 lëndë, të reja të pranuar janë 2.460 lëndë, të reja të pranuar nga një gjyqtar tjetër 1.000 lëndë, që i janë dhënë një gjyqtari tjetër 1002 lëndë, të evidentuara gabimisht 16 ose gjithsej në punë kanë qenë 3.914 lëndë, gjithsej të kryera janë 2.280 lëndë, kurse kanë mbetur të pakryera 1.634 lëndë. Nuk është tejkualuar fluksi i lëndëve për 180 lëndë, përkatësisht është rritur numri i lëndëve të mbetura për 162 lëndë.

Spektori i prokurimeve publike dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur 965 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 2.562 lëndë, të reja të pranuar nga një gjyqtar tjetër 946 lëndë, që janë dhënë një gjyqtari tjetër 950 lëndë, të evidentuara gabimisht 11 lëndë ose gjithsej në punë kanë qenë 3.512 lëndë, gjithsej të kryera janë 1.871 lëndë, kurse kanë mbetur të pakryera 1.641 lëndë. Nuk është tejkualuar fluksi për 691 lëndë, përkatësisht është rritur numri i lëndëve të mbetura për 676 lëndë.

Kualiteti i lëndëve në nivel të gjykatës

Në vitin 2021 në Gjykatën Administrative janë parashtruar 2.777 ankesa, ndërsa në Gjykatën e Lartë Administrative me vendime të shkallës së dytë janë kthyer 3.368 lëndë.

Kualiteti i lëndëve në nivel të sektorëve

Spektori për sferën juridiko – pronësore, denacionalizim, urbanizëm, ndërtimtari dhe të drejta tjera të ngjashme.

Lëndë nga sfera juridiko – pronësore dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga gjithsej 353 lëndët për ankesa të pranuar në Gjykatën e Lartë Administrative, 250 janë të konfirmuara ose 70,82%, 25 të ndryshuara ose 7,08%, 29 të abroguara ose 8,22%, dhe 48 të hedhura poshtë ose 13,60%.

Lëndët nga sfera e denacionalizimit dhe të drejta tjera të ngjashme, urbanizëm, ndërtimtari dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga gjithsej 631 lëndë të pranuar për ankesa në Gjykatën e Lartë Administrative, 388 janë të konfirmuara ose 61,49%, 85 të ndryshuara ose 13,47%, 61 të abroguara ose 9,67% dhe 97 të hedhura poshtë ose 15,37%.

Sektori për pensionet, të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe të drejta tjera, doganat dhe të drejta tjera të ngjashme

Lëndët nga sfera e pensioneve, të drejtat për sigurimin pensional dhe invalidor dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga gjithsej 317 lëndë të pranuar për ankesa në Gjykatën e Lartë Administrative, 209 të konfirmuara ose 65,93%, 64 të ndryshuara ose 20,19%, 16 të abroguara ose 5,05% dhe 28 të hedhura poshtë ose 8,83%.

Lëndët nga sfera e doganave dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga gjithsej 1.255 lëndëve të pranuar për ankesa në Gjykatën E Lartë Administrative, 906 janë të konfirmuara ose 72,19%, 165 të ndryshuara ose 13,15%, 69 të abroguara ose 5,50% dhe 114 të hedhura poshtë ose 9,08%.

Sektori për prokurime publike dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga gjithsej 812 lëndët e pranuar për ankesa në Gjykatën e Lartë Administrative, 532 janë të konfirmuara ose 65,52%, 77 të ndryshuara ose 9,48%, 41 të abroguara ose 5,05% dhe 162 të hedhura poshtë ose 19,95%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fillim të periudhës raportuese kanë mbetur 24 lëndë të vjetra. Gjatë vitit 2021 statusin e lëndëve të vjetra e kanë fituar 153 lëndë, ose gjithsej 177 nga të cilat janë kryer 153 lëndë, kurse në fund të vitit 2021 kanë mbetur të pakryera 24 lëndë.

Burime njerëzore

Në vitin 2021 në Gjykatën administrative janë plotësuar 30 vende të gjyqtarëve duke e përfshirë edhe Kryetarin e gjykatës nga gjithsej 33 vendet e parapara të gjyqtarëve së bashku me Kryetarin e gjykatës.

Një gjyqtari i pezullohet funksioni – gjyqtar i Gjykatës Administrative ngase është zgjedhur për Kryetar të Gjykatës së Lartë Administrative. Gjatë muajit korrik 2021, për shkak të skadimit të afatit të Kryetarit të gjykatës, me Vendim të Këshillit gjyqësor është emëruar ushtrues detyre – kryetar i Gjykatës Administrative, ndërsa me Vendim të Këshillit gjyqësor të RMV të datës 30.11.2021 është zgjedhur Kryetar i Gjykatës Administrative. Gjatë muajit dhjetor 2021, është konstatuar ndërprerja e funksionit të një gjyqtari për shkak të kushteve të plotësuara për realizimin e të drejtës së pensionimit sipas moshës.

Në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën Administrative deri më 31.12.2021 janë paraparë gjithsej 179 vende pune nga të cilat 78 janë plotësuar, kurse 101 vende pune të paplotësuara, në të cilat janë përfshirë edhe 13 nëpunës gjyqësor, të punësuar në gjykatë me kohë të caktuar deri më 31.12.2021.

Në këtë gjykatë deri më 31.12.2020 janë punësuar 76 persona në kuadër të shërbimit gjyqësor duke i përfshirë edhe nëpunësit gjyqësor të punësuar me kohë të caktuar – deri më 31.12.2020, ashtu që 11 persona me të cilët është lidhur marrëveshje për punësim me kohë të caktuar u është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Gjatë vitit 2021, në muajin mars dhe në muajin qershor në procedurën e punësimit pa shpallje publike nëpërmjet marrjes së përhershme janë punësuar 2 nëpunës gjyqësor.

Deri më 31.12.2021, me ndërprerjen e marrëdhënies së punës të 14 personave, të cilët kanë qenë të punësuar me kontratë për punësim në kohë të caktuar, në këtë gjykatë janë punësuar me marrëveshje pune në kohë të caktuar, në këtë gjykatë janë punësuar 78 persona në kuadër të shërbimit gjyqësor, duke përfshirë edhe nëpunësit gjyqësor të punësuar në kohë të caktuar.

Kapacitete hapësinore

Në periudhën raportuese Gjykata Administrative, aktivitetet e saj nga fushëveprimi i paraparë ligjor i realizon në objektin të cilin e shfrytëzon që nga themelimi i saj në vitin 2007. Për arsye të kushteve jo adekuate hapësinore për funksionimin normal dhe efikas të gjykatës, me Vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të datës 25.09.2018, i është dhënë një objekt në Shkup për shfrytëzim të përhershëm pa kompensim, që në vitin 2021 në vazhdimësi po adaptohet dhe rinovohet.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjatë periudhës raportuese Gjykata Administrative nuk e tejkaloi fluksin e lëndëve për 1.017 lëndë, respektivisht e zmadhoi numrin e lëndëve që kanë mbetur për 1.191 lëndë, në mënyrë që për periudhën e vitit 2021 është **gjykatë e pa përditësuar**.

Propozim masa:

-Përforcimi i burimeve njerëzore me pajisjen e kuadrove të gjykatës me nëpunës gjyqësor;

-Sigurimi i kushteve hapësinore për punën e gjykatës, që do të mundësojnë mbajtjen e seancave të lëndëve, me qëllim që të mundësohet zbatimi i Ligjit për konteste administrative, që zbatohet nga muaji maj i vitit 2020.

-Edukimi në vazhdimësi i gjyqtarëve dhe të punësuarave në gjykatë;

-Gjykata edhe në periudhën e ardhshme të vazhdojë të zvogëlojë numrin e lëndëve të vjetra të pakryera;

-Të bëhet vendosja elektronike ndërlidhëse e organeve administrative me Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e Lartë Administrative.

GJYKATA E APELIT SHKUP

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në vitin raportues 2021, Gjykata e Apelit Shkup ka pasur në punë 20.508 lëndë, nga të cilat 6.503 lëndë, të cilat si të pakryera kanë kaluar nga viti i kaluar, (nga të cilat 4 janë evidentuar gabimisht), 13.931 lëndë të reja të pranuar (nga të cilat 4 janë të evidentuara gabimisht) dhe 82 lëndë përsëri në punë.

Gjatë vitit raportues nga numri i gjithsej lëndëve në punë, gjykata ka kryer 13.611 lëndë edhe atë 13.502 nga lëndë të reja të pranuar dhe 109 nga lëndët përsëri në punë.

Deri më 31.12.2021 kanë mbetur 6.897 lëndë të pakryera, që përfaqëson rritjen e numrit të lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 394 lëndë krahasuar me vitin e kaluar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Gjatë vitit 2021, gjykata në punë ka pasur gjithsej 3.046 lëndë, nga të cilat janë kryer në vitin raportues 3.045 lëndë, kurse ka mbetur e pakryer një lëndë.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Spektori penal

Lëndët penale, lëndë penale nga krimi i organizuar, lëndë penale – fëmijët dhe lëndë për kundërvajtje

Në sektorin penal në vitin raportues, gjithsej në punë ka pasur 1.655 lëndë penale (KZH) nga të cilat 443 lëndë janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar, kurse 1.199 lëndë janë të reja të pranuar dhe 13 lëndë përsëri në punë, ashtu që gjykata ka kryer 1.258 lëndë, që do të thotë se fluksi është tejkaluar, kurse në fund të vitit kanë mbetur 397 lëndë të pakryera të cilat barten për vitin e ardhshëm. Në krahasim me vitin e kaluar, kur gjykata ka pasur në punë gjithsej 1.233 lëndë, në vitin raportues vëllimi i punës është rritur për 422 lëndë. Fluksi i lëndëve të reja të pranuar është rritur për 314 lëndë në krahasim me vitin e kaluar, kur janë pranuar 898 lëndë. Numri i lëndëve të kryera penale është rritur për 468 lëndë. Për dallim nga viti i kaluar kur kanë mbetur të pakryera 443 lëndë, në vitin raportues

numri i lëndëve të pakryera penale është zvogëluar për 46 lëndë, gjegjësisht kanë mbetur 397 lëndë të pa kryera.

Në kuadër të sektorit penal, segment të veçantë paraqet veprimi me lëndët penale nga krim i organizuar (KOKZH), ku në punë ka pasur gjithsej 167 lëndë, nga të cilat 118 lëndë janë pranuar në vitin raportues, 1 lëndë është evidentuar përsëri në punë, kurse 48 lëndë janë bartur si të pakryera nga periudha e kaluar. Nga lëndët në punë janë kryer 118 lëndë, që do të thotë se **e ka tejkaluar fluksin**, kurse si të pakryera kanë mbetur 49 lëndë. Sa i përket vitit të kaluar, në vitin raportues vëllimi i punës është rritur për 36 lëndë, numri i lëndëve të reja është më i madh për 10 lëndë, kurse numri i lëndëve të pakryera është rritur për një lëndë.

Po ashtu, në kuadër të sektorit penal, segment të veçantë paraqet veprimi me lëndët penale – fëmijët. Në periudhën raportuese gjithsej në punë ka pasur 32 lëndë, nga të cilat 31 janë lëndë të reja të pranuar, ndërsa një lëndë është bartur si e pakryer nga periudha e kaluar, nga të cilat në periudhën raportuese janë kryer 30 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 2 lëndë.

Në kuadër të këtij sektori, segment të veçantë paraqet veprimi me lëndët për kundërvajtje (PRKZH). Gjatë vitit 2021 në punë ka pasur gjithsej 3.627 lëndë, nga të cilat 1.891 janë lëndë të reja të pranuar dhe 2 lëndë janë evidentuar përsëri në punë, ndërsa 1.779 lëndë janë bartur nga viti i kaluar. Gjykata ka kryer 2.011 lëndë, gjegjësisht e ka tejkaluar fluksin, kurse në fund të vitit kanë mbetur të pakryera 1.661 lëndë dhe ky numër është bartur për vitin e ardhshëm. Sa i përket vitit të kaluar kur gjykata në punë ka pasur 3.727 lëndë, vëllimi i punës në vitin raportues është zvogëluar për 55 lëndë, numri i lëndëve të kryera është rritur për 63 lëndë në krahasim me vitin e kaluar, kurse numri i lëndëve të pakryera që kanë mbetur deri në fund të vitit 2021 është zvogëluar për 118 lëndë në krahasim me periudhën e kaluar raportuese.

Cilësia e punës në sektorin penal

Në vitin raportues lëndë vlerësimi nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut me rastin e mjeteve të deklaruara juridike kanë qenë 95 vendime të për lëndë penale të Gjykatës së Apelit Shkup, që paraqet 2.22% nga gjithsej numri i 4290 vendimeve të miratuara në vitin raportues. Nga ato vendime, 78 kanë qenë të konfirmuara (82,10% nga numri i lëndëve që kanë qenë për mjet të jashtëzakonshëm juridik dhe 1,82% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera), 15 vendime janë abroguar (15,79% nga numri i lëndëve që kanë qenë për mjet të jashtëzakonshëm juridik gjegjësisht 0,35% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera) dhe 2 vendime janë të ndryshuara (2,11% nga numri i lëndëve që kanë qenë për mjet të jashtëzakonshëm juridik gjegjësisht 0,05% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera.

Sektori civil

Gjatë vitit 2021, gjykata ka pasur në punë gjithsej 6.598 lëndë civile nga të cilat 1.675 lëndë (prej tyre 1 lëndë është evidentuar gabimisht) janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar, 4.891 lëndë (prej tyre 1 është evidentuar gabimisht) janë të reja të pranuar dhe 34 lëndë përsëri në punë, në mënyrë që gjykata ka kryer gjithsej 4.305 lëndë, gjegjësisht nuk e ka tejkaluar fluksin, kurse në fund të vitit kanë mbetur të pakryera 2.293 lëndë, të cilat barten për vitin e ardhshëm. Sa i përket vitit të kaluar, kur në këtë sektor në punë ka pasur gjithsej 6.103 lëndë, vëllimi i punës në vitin raportues është rritur për 1.355 lëndë në krahasim me vitin e kaluar, kur janë pranuar 3.569 lëndë. Numri i lëndëve të kryera në vitin raportues është zvogëluar për 123 lëndë në krahasim me vitin e kaluar, numri i lëndëve të cilat kanë mbetur në punë në fund të periudhës raportuese është rritur për 618 lëndë në krahasim me lëndët të cilat kanë mbetur në punë në fund të vitit 2020.

Cilësia e punës në sektorin civil

Lëndë vlerësimi nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut me rastin e mjeteve juridike të deklaruara kanë qenë 271 vendime të Gjykatës së Apelit, që

paraqet 6,29% nga gjithsej numri i 4.305 vendimeve të miratuara në vitin raportues, nga të cilat 183 kanë qenë të konfirmuara, (67,53% nga numri i lëndëve të cilat kanë qenë për mjet të jashtëzakonshëm juridik, gjegjësisht 4,25% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera), 56 vendime kanë qenë të abroguara, (20,66% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera të cilat kanë qenë për mjet të jashtëzakonshëm juridik, gjegjësisht 1,30% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera) dhe 32 vendime kanë qenë të ndryshuara (që përfaqëson 11,81% nga numri i lëndëve për mjet të jashtëzakonshëm juridik, gjegjësisht 0,74% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera).

Spektori i kontesteve të punës

Gjatë vitit 2021 ky sektor ka pasur gjithsej 4.373 lëndë në punë, nga të cilat 1.641 lëndë janë bartur nga viti i kaluar, 2730 lëndë janë të reja të pranuar (nga të cilat 2 janë të evidentuara gabimisht) dhe 4 lëndë përsëri në punë, ashtu që gjykata ka zgjidhur gjithsej 2.495 lëndë, gjegjësisht **nuk e ka tejkeluar fluksin**, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 1.878 lëndë të pakryera të cilat barten në vitin e ardhshëm.

Sa i përket vitit të kaluar, vëllimi i punës është rritur për 1.145 lëndë, është rritur edhe numri i lënëve të kryera për 908 lëndë, ndërsa numri i lëndëve që kanë mbetur në punë është rritur për 237 lëndë në krahasim me numrin e lëndëve që kanë mbetur në punë në fund të vitit 2020.

Cilësia e punës në sektorin e kontesteve të punës

Lëndë e vlerësimit nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut me rastin e mjeteve të deklaruara juridike kanë qenë 107 vendime të Gjykatës së Apelit, që përfaqëson 4,29% nga gjithsej numri i lëndëve 2.495 vendimeve të miratuara në vitin raportues, nga të cilat 87 janë të konfirmuara (87,31% nga numri i lëndëve që kanë qenë për mjet të jashtëzakonshëm juridik, përkatësisht 3,49%) nga gjithsej numri i lëndëve të kryera), 9 vendime janë të abroguara, përkatësisht 0,36% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera) dhe 11 vendime janë të ndryshuara (që paraqet 10,28% nga numri i lëndëve që kanë qenë për mjet të jashtëzakonshëm juridik, përkatësisht 0,44% nga gjithsej lëndët e kryera).

Spektori i kontesteve tregtare

Spektori gjatë rrjedhjes së vitit raportues 2021, në punë ka pasur gjithsej 3.080 lëndë, nga të cilat 868 (nga të cilat 2 janë gabimisht të evidentuara), janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar, 2.186 lëndë janë të reja të pranuar dhe 28 lëndë janë përsëri në punë, në mënyrë që gjykata ka kryer 2.521 lëndë dhe ka tejkeluar fluksin, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 559 lëndë të pakryera që barten në vitin e ardhshëm.

Në krahasim me vitin e kaluar kur gjykata ka pasur në punë 3.519 të këtij lloji të lëndëve, në vitin raportues vëllimi i punës është zvogëluar për 439 lëndë. Fluksi i lëndëve në vitin raportues është rritur për 714 lëndë në krahasim me vitin e kaluar. Numri i lëndëve të kryera të kontesteve tregtare është zvogëluar për 130 lëndë në krahasim me vitin e kaluar kur kanë qenë 2.505 lëndë të kryera. Në fund të vitit 2020 kanë mbetur 559 lëndë të pakryera, që është për 309 lëndë më pak në krahasim me vitin e kaluar.

Cilësia e punës në sektorin e kontesteve tregtare

Lëndë vlerësimi nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut me rastin e mjeteve të deklaruara juridike kanë qenë 154 vendime të Gjykatës së Apelit, që paraqet 6,11% nga gjithsej numri i 2.521 vendimeve të miratuara në vitin raportues, nga të cilat 104 janë të konfirmuara (67,54% nga numri i lëndëve të cilat kanë qenë për mjet të jashtëzakonshëm juridik, përkatësisht, 4,13% nga gjithsej numri i lëndëve), 42 vendime janë të abroguara (27,72% nga numri i lëndëve që kanë qenë për mjet të jashtëzakonshëm juridik, përkatësisht 1,67% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera) dhe 8 vendime janë të ndryshuara (që paraqet 5,19% të numrit të lëndëve që kanë qenë për mjet të jashtëzakonshëm juridik, përkatësisht 0,31% të gjithsej numrit të lëndëve).

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë rrjedhjes së vitit 2021, gjykata ka pasur në punë gjithsej 8.727 lëndë të vjetra, nga të cilat 3.231 lëndë janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar, kurse për 5.496 lëndë gjatë rrjedhjes së vitit raportues ka kaluar periudha prej 6 muajve nga pranimi i lëndëve në gjykatë. Në gjykatë ka pasur gjithsej 6.319 lëndë të vjetra të kryera, ndërsa kanë mbetur të pakryera 2.408 lëndë të vjetra.

Burime njerëzore

Në përputhje me aktin e sistematizimit dhe vendimin nga viti 2015 të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, është konstatuar se në Gjykatën e Apelit Shkup, funksionin e gjyqtarit ta ushtrojnë 51 gjyqtarë, në mënyrë që gjatë vitit raportues, gjykata ka funksionuar me përbërje jo të plotë.

Vitin kalendarik 2021, gjykata e ka filluar me 41 gjyqtarë, duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës. Gjatë vitit, në muajin prill, njërit prej gjyqtarëve i është ndërprerë funksionit për shkak të vdekjes, ndërsa më 29.11.2020 njërit prej gjyqtarëve i është ndërprerë funksioni për shkak të kushteve të plotësuara për pensionim me moshë, ashtu që gjykata vitin raportues e ka përfunduar me 39 gjyqtarë në të cilin numër përfshihet edhe kryetari i gjykatës.

Gjatë vitit raportues, në shërbimin gjyqësor, janë realizuar 9 punësime me shpallje të publikuar në vitin 2020. Sipas Planit vjetor për vitin 2021, ende nuk janë realizuar punësime, ndërsa procedura për shpalljen publike të publikuar ende vijon. Gjatë vitit raportues, janë realizuar 9 punësime të reja me shpallje të publikuar në vitin 2020, ndërsa me vendet e zbrazura sipas bazave të ndryshme, numri i shërbimit gjyqësor në gjykatë në fund të vitit numëron 119 të punësuar nga të gjitha kategoritë.

Kapacitete hapësinore

Gjykata e Apelit Shkup, veprimtarinë e saj e realizon në ndërtesën e vet, në mënyrë që edhe në vitin raportues si edhe një periudhë më mbrapa, kapacitetet hapësinore nuk janë të përshtatshme për kryerjen e punëve nga kompetenca e tyre, duke qenë se në ndërtesën e njëjtë funksionojnë edhe institucione të tjera që përfshijnë një pjesë të konsideruar të hapësirës.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në vitin raportues 2021 Gjykata e Apelit Shkup ka pasur **20.508** lëndë në punë, të cilin numër e përbëjnë:

- 6.503 lëndë të bartura si të pakryera nga viti i kaluar (nga të cilat 4 janë gabimisht të evidentuara),
- 13.931 lëndë të reja të pranuar (nga të cilat 4 janë gabimisht të evidentuara) dhe
- 82 lëndë janë përsëri në punë.

Gjatë rrjedhjes së vitit raportues, nga numri gjithsej i lëndëve në punë, gjykata ka kryer 13.611 lëndë edhe atë 13.502 lëndë të reja të pranuar dhe 109 nga lëndët përsëri të marra në punë që do të thotë se nuk e tejkaluar fluksin, në mënyrë që gjykata konsiderohet si gjykatë **jo e përditësuar**.

Gjatë rrjedhjes së vitit raportues, duke u nisur nga numri i lëndëve të kryera dhe numri mesatar i gjyqtarëve që kanë vepruar për të njëjtat, rezulton se funksionin e gjyqtarit e kanë realizuar me angazhim të përforcuar.

Për punën më efikase dhe më të përditësuar, për përmirësimin e gjendjes më lëndët e vjetra, dhe sidomos për veprimin me lëndët në afat të arsyeshëm, është i domosdoshëm plotësimi i numrit të bartësve të funksionit të gjyqtarit, si dhe të pajisjes me kuadrin e pplotësuar nga shërbimi gjyqësor.

GJYKATA THEMELORE PENALE SHKUP

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata vitin e ka filluar me 19 850 lëndë, që në krahasim me vitin 2020 kur (GJTH Shkup Gjykata penale vitin e ka filluar me 21 427 lëndë) do të thotë se Gjykata Themelore Penale në fillim të vitit ka pasur 1577 lëndë më pak. Kjo gjykatë ka pranuar në punë 97 302 lëndë të reja dhe me 665 lëndë të marra përsëri në punë dhe me 6 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej në punë ka pasur 117 811 lëndë (në vitin 2020, 101 996) dhe me atë në krahasim me vitin e kaluar ka pasur 15 815 lëndë në punë më shumë. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë ka kryer 104 747 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 13 064 lëndë, që edhe krahas fluksit të madh të lëndëve të reja të pranuar do të thotë se gjykata ka kryer 6 786 lëndë më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Të dhënat statistikore për punën e kësaj gjykate tregojnë se edhe krahas pandemisë me virusin COVID-19 Gjykata Themelore Penale vitin raportues e ka përfunduar me rezultate pozitive, si gjykatë e përditësuar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore si lëndë në regjistrat përkatës është vepruar mbi 2204 lëndë (23 lëndë kanë qenë lëndë të pakryera me të cilat gjykata e ka filluar punën), janë kryer 2179 lëndë, ndërsa procedura nuk është kryer për 25 lëndë. Administrata gjyqësore është udhëhequr nga Kryetari i gjykatës.

Në gjykatë mbahet WEB faqja e gjykatës rregullisht dhe sipas nevojës publikohen njoftime për publikun, jepen përgjigje për mediumet, komunikim i rregullt me organizata joqeveritare, përfaqësues me organizata ndërkombëtare në vend dhe realizohen projekte për përparimin e transparencës së gjykatës. Ashtu, gjatë vitit 2021, janë publikuar 106 njoftime për publikun, 145 përgjigje të organizatave joqeveritare dhe mediumeve mbi pyetje të gazetarëve, 41 përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga qytetarët përmes portalit sud.mk., 42 përgjigje për kërkesat për qasje të lirë në informacionet me karakter publik dhe janë organizuar 2 konferenca shtypi me gazetarë. Kjo gjykatë gjatë vitit 2021 ka publikuar edhe një demant të një teksti mediumesh.

Krahas kësaj, gjatë vitit 2021, Zyra për marrëdhënie me publikun ka organizuar edhe 3 vizita fakultative të studentëve dhe ka lidhur 2 memorandume për bashkëpunim në kuadër të projektit të Ministrisë së Arsimit "Mësojmë përmes punës te punëdhënësi", në mënyrë që kanë mundur që 60 nxënës të shkollave të mesme të vizitojnë praktikën fakultative në gjykatë. Në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme gjatë pandemisë me virusin COVID-19, që vazhdon, publiku vazhdimisht është njoftuar me Protokollat dhe organizimin e punës në Gjykatë.

Gjatë vitit 2021, në WEB faqen e Gjykatës, janë publikuar 106 njoftime për publikun janë mbajtur 2 konferenca për shtyp me gazetarë, përmes postës elektronike u janë dërguar 145 përgjigje mediumeve, ndërsa qytetarëve përmes portalit sud.mk iu është dhënë përgjigje për 41 kërkesa. Gjatë vitit 2021, në ueb faqen e gjykatës janë anonimizuar dhe publikuar 1 846 vendime.

Gjykata ka vepruar edhe mbi kërkesa të parashtruara për përjashtimin e gjyqtarëve, ashtu që nga gjithsej 117 kërkesat e parashtruara, janë miratuar 28 aktvendime, me të cilat kërkesat për përjashtim të gjyqtarëve janë refuzuar, 1 aktvendim me të cilin kërkesa për përjashtim është hedhur poshtë dhe 88 aktvendime me të cilat kërkesat për përjashtim të gjyqtarëve janë aprovuar. Gjatë vitit 2021, nga gjithsej numri i kërkesave për përjashtim, 25 kërkesa janë parashtruar nga palët ndërsa 92 janë parashtruar nga vet gjyqtarët.

Gjykata Themelore Penale gjatë 2021 ka pasur komunikim të shpeshtë me nëpunësit gjyqësor si rezultat i ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për gjykatat nga viti 2007, ndërsa lidhur me lëndët e përfunduara – të arkivuara të cilat kanë mbetur në arkivat e gjykatave, përkatësisht nuk janë dorëzuar në gjykatat nën kompetencën e të cilave kanë kaluar. Kjo sidomos ka të bëjë me lëndët tregtare dhe përmbaruese që me kërkesën e palëve përmes administratës së Gjykatës Themelore Civile Shkup, vazhdimisht kanë qenë objekt i veprimit për vazhdimin e procedurës në gjykatën e theksuar. Tërë ajo procedurë ka paraqitur

ngarkesë plotësuese të administratës së gjykatës, ndërsa ka kërkuar edhe angazhim shtesë të numrit të pamjaftueshëm të nëpunësve gjyqësor, si dhe rritjen e shpenzimeve materiale.

Gjykata Themelore Penale Shkup, në vitin e kaluar e ka vazhduar edhe bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë të RMV dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të RMV në pjesën e veprimit mbi kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare, ekstradimet dhe procedurat për transferim të procedurave dhe personave të akuzuar.

Gjatë vitit 2021, me miratimin e mjeteve nga Këshilli i Buxhetit Gjyqësor të RMV, nga Gjykata Themelore Penale Shkup, është përgatitur plani vjetor për furnizime publike sipas të cilit janë parashikuar që të zbatohen 25 procedura për furnizime publike. Nga procedurat e planifikuara janë realizuar gjithsej 16 procedura nga të cilat 1 procedurë si furnizim publik grupor, 3 procedura të thjeshta të hapura dhe 12 si furnizime të vlerës së ulët.

Në mënyrë të rregullt janë realizuar obligimet financiare ndaj furnizuesve, mbrojtësve me detyrë zyrtare dhe porotëve.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Puna në Gjykatën Themelore Penale është organizuar në sektorë dhe njësi edhe atë: Njësia e specializuar gjyqësore për krim të organizuar dhe korrupsion dhe Sektori penal me sektorë të veçantë: Penal - Persona madhor, Penal - Persona të mitur, Hetim Penal, Procedurë paraprake penale, Sektori për kundërvajtje dhe Sektori për zbatimin e sanksioneve dhe masat e sigurisë.

Njësia e specializuar për krim të organizuar dhe korrupsion

Lëndët për gjykim – Nga viti i kaluar kanë mbetur 143 lëndë. Janë pranuar 165 lëndë të reja ose gjithsej në punë ka pasur 308 lëndë. Nga ato të kryera janë 159 lëndë dhe kanë mbetur 149 lëndë të pakryera. Nga gjithsej numri i lëndëve të kryera, 152 lëndë janë kryer me aktgjykim, 4 lëndë janë kryer me aktvendim dhe 3 lëndë janë kryer në tjetër mënyrë.

Vlerësimi i aktakuzës – Nga viti i kaluar kanë mbetur 10 lëndë. Janë pranuar në punë 53 lëndë ose në punë ka pasur gjithsej 63 lëndë. Nga ato të pakryera kanë mbetur 7 lëndë. Nga gjithsej numri i lëndëve të kryera 6 lëndë janë kryer me aktgjykim, 47 lëndë janë kryer me aktvendim dhe 3 lëndë janë kryer në tjetër mënyrë.

Në periudhën raportuese, nga 159 lëndët e kryera, janë ankimuar 90 lëndë ose 56,60%. Nga lëndët ankimore 62 lëndë ose 38,99% janë të konfirmuara, 16 lëndë, ose 10,06% janë të abroguara dhe 12 lëndët ose 7,55%, janë të ndryshuara.

Këshilli penal-Krim i organizuar dhe korrupsion

Në punë gjithsej ka pasur 1793 lëndë, janë kryer 1731 lëndë dhe të pakryera kanë mbetur 62 lëndë.

Në vitin 2021, janë ankimuar 208 lëndë apo 12,02% nga të cilat 189 janë të konfirmuara, 2 lëndë janë të abroguara që është 0,12% të vendimeve, ndërsa të ndryshuara janë 17 lëndë që është gjithsej 0,98%, përkatësisht 98,9% të vendimeve janë miratuar në rregull.

Penal - Persona madhor

Lëndë për gjykim – Nga viti i kaluar kanë mbetur 1 647 lëndë. Janë pranuar 3 101 lëndë të reja dhe në punë ka pasur gjithsej 4 748 lëndë. Nga ato, janë kryer 3 213 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 1 535 lëndë. Nga gjithsej numri i lëndëve të kryera, 2 998 lëndë janë kryer me aktgjykim, ndërsa 204 lëndë janë kryer me aktvendim dhe 11 lëndë janë kryer në tjetër mënyrë.

Vlerësimi i aktakuzës - Nga viti i kaluar kanë mbetur 25 lëndë. Janë pranuar 227 lëndë të reja, ashtu që në punë ka pasur gjithsej 252 lëndë. Nga ato, janë kryer 221 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 31 lëndë. Nga gjithsej numri i lëndëve të kryera, 2 lëndë janë kryer me aktgjykim, ndërsa 180 lëndë janë kryer me aktvendim dhe 39 lëndë janë kryer në tjetër mënyrë.

Cilësia e punës së Sektorit penal të personave madhor, tregon se nga 3 213 lëndët e kryera janë ankimuar 553 lëndë ose gjithsej 11,92% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera. Nga lëndët ankimore, 396 vendime apo 12,33 % janë të konfirmuara, 70 lëndë apo 2,18 %

janë të abroguara, 87 vendime apo 2,71 % janë të ndryshuara, përkatësisht 82.78 % të vendimeve janë miratuar në rregull.

Këshilli penal- persona madhor

Nga viti i kaluar ka pasur 254 lëndë, janë pranuar 2 847 lëndë të reja, dhe në punë ka pasur gjithsej 3 101 lëndë. Nga gjithsej numri i lëndëve të kryera janë 2 913 lëndë ndërsa të pakryera kanë mbetur 188 lëndë.

Cilësia e lëndëve të kryera në Këshillin penal tregon se nga gjithsej numri i 2 913 lëndëve të kryera, janë ankimuar 175 vendime apo 6%. Nga gjithsej numri i lëndëve ankimore, gjithsej 153 lëndë janë të konfirmuara apo 87,43%, 6 janë të abroguara apo 3,43% dhe 16 lëndë janë të ndryshuara apo 9,14%.

Spektori i personave të mitur

Nga viti i kaluar kanë mbetur 68 lëndë me shenjën KM, ndërsa janë pranuar 180 lëndë të reja apo gjithsej në punë në vitin 2021 ka pasur 248 lëndë. Prej tyre janë kryer 170 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 78 lëndë.

Nga viti i kaluar kanë mbetur 9 lëndë me shenjën KRM, ndërsa janë pranuar 327 lëndë të reja dhe gjithsej ka pasur 336 lëndë. Prej tyre, të kryera janë 310 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 26 lëndë KRM.

Gjatë vitit 2021 janë pranuar gjithsej 8 lëndë KCM, ndërsa në fund të vitit 2021 nuk ka mbetur asnjë lëndë pakryer.

Gjatë vitit 2021, nuk ka pasur kërkesa për vendimmarrjen e lëshimit me kusht nga dënimi i vuajtjes së burgut të personave të mitur për fëmijë bile as kërkesa për falje, dhe andaj nuk ka pasur të pranuar lëndë "UOKM" dhe "KPM".

Gjyqtarët për fëmijë veprojnë edhe mbi lëndë për kundërvajtje ndaj fëmijëve në rrezik nga 14 deri 18 vjet, ashtu që në fillim të vitit 2021 janë bartur 139 lëndë të pakryera nga viti i kaluar, ndërsa janë pranuar 463 lëndë "PRKM" përkatësisht gjyqtarët kanë vepruar për gjithsej 602 lëndë. Gjatë vitit 2021, janë kryer gjithsej 480 lëndë "PRKM", ndërsa në fund të vitit 2021 kanë mbetur gjithsej 122 lëndë të pakryera "PRKM".

Nga gjithsej numri i 480 lëndëve të kryera "PRKM", me aktvendim në 359 lëndë është shqiptuar masë edukuese "Qortim" në 11 lëndë është ndërprerë procedura, në 34 lëndë është hequr kompetenca e vendit, 3 lëndë janë kryer në tjetër mënyrë, në 60 lëndë është ndërprerë procedura, në 7 lëndë është hedhur akti iniciues ndërsa në 6 lëndë është shqiptuar masa "Mbikëqyrja e përforcuar nga prindi - kujdestari".

Spektori për kundërvajtje

Ky sektor vitin e ka filluar me 13 668 lëndë që kanë mbetur. Janë pranuar 10 381 lëndë për kundërvajtje apo në vitin 2021, sektori ka punuar me gjithsej 24 049 lëndë. Prej tyre 16 658 lëndë janë të kryera dhe të pakryera kanë mbetur 7 391 lëndë. Nga gjithsej numri i lëndëve të kryera, 13 673 lëndë janë kryer me aktgjykim, 2 670 janë kryer me aktvendim, 311 lëndë janë kryer në tjetër mënyrë dhe 4 lëndë janë kryer me marrëveshje.

Me Vendim të Kryetarit të gjykatës në fillim të vitit 2021 është formuar Këshilli penal në Sektorin për Kundërvajtje. Gjatë vitit 2021 në Këshillin penal – Sektorin për kundërvajtje janë pranuar 107 lëndë nga të cilat të kryera janë 78 lëndë. Në fund të vitit 2021 kanë mbetur të 29 lëndë të pakryera. Nga gjithsej 78 lëndët e kryera janë ankimuar 5 lëndë nga të cilat lëndë të konfirmuara janë 4 lëndë ose me përqindje 5,31%, ndërsa të abroguara ka pasur 1 lëndë apo 1,28%.

Te ky lloj i lëndëve cilësia tregon se nga 16 658 lëndët e kryera të ankimuara janë 1 331 lëndë apo 8% nga gjithsej numri i lëndëve. Nga 872 lëndët ankimore apo 65.52%, janë të konfirmuara, në 245 lëndë apo 18,41% janë të abroguara dhe në 214 të abroguara apo 16,08.

Hetimi dhe procedura paraprake

Spektori i hetimit i kësaj gjykate funksionon me përbërje të dy sektorëve edhe atë: sektori – hetimi penal që vepron për lëndë hetuese KI dhe OID sipas LPP të vjetër dhe

njësia e procedurës paraprake penale që vepron për lëndët KPP dhe KNZD (dhe UOSK lëndë), sipas LPP të ri.

Nga lëndët e vjetra hetuese-sipas LPP të vjetër, në punë ka pasur 3 lëndë dhe gjatë vitit 2021 nuk janë pranuar lëndë të tjera KI, në mënyrë që në vitin raportues 2021, gjykata në punë ka pasur 3 lëndë, 1 lëndë është kryer dhe 2 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Procedura paraprake-penale për persona madhor

Sektori i procedurës paraprake funksionon në përbërje nga sektori i procedurës paraprake – penale për persona madhor dhe sektori i procedurës paraprake në njësinë për krim të organizuar dhe korrupsion.

Sektori i procedurës paraprake – penal për persona madhor

Nga viti i kaluar ka pasur 4 lëndë të pakryera. Janë pranuar 919 lëndë të reja dhe gjithsej në punë ka pasur 921 lëndë, ndërsa kanë mbetur 2 lëndë “KPP” të pakryera.

Në këtë sektor në vitin 2021 janë evidentuar 6 “KNZD” lëndë ose gjithsej në punë gjatë vitit 2021 ka pasur 6 “KNZD” lëndë nga të cilat 4 janë kryer deri në fund të vitit 2021 dhe kanë mbetur 2 lëndë për punë.

Është vepruar për 129 lëndë paraburgimi, në mënyrë që ndaj 103 personave është caktuar masa e paraburgimit, për 20 persona është refuzuar propozimi i masës së paraburgimit dhe është caktuar masa e paraburgimit shtëpiak, përderisa për 5 persona është refuzuar propozimi për paraburgim dhe janë caktuar masa parandalimi. Për 19 persona janë paraqitur propozime për paraburgim ekstradimi dhe të njëjtëve u është caktuar masa për paraburgim ekstradimi, përderisa për 16 janë caktuar masa parandalimi. Me atë, në vitin 2021 raportues, janë caktuar masa parandalimi për gjithsej 21 persona. Krahas kësaj, janë pranuar 42 propozim marrëveshje dhe 1 propozim marrëveshje nga viti i kaluar 2020, ose gjithsej 43 propozim marrëveshje dhe të gjitha janë kryer në vitin 2021. Sektori ka vepruar dhe ka kryer 5 kërkesa për masa të veçanta hetimore, që janë evidentuar në një regjistër të veçantë. Sektori vepron mbi propozime “PIM”, masa për të cilat deri më 31.03.2021 është udhëhequr regjistër i veçantë me dorë, përderisa nga 01.04.2021 të njëjtat evidentohen në sistemin AKMIS në Regjistrin “UOSK”, në mënyrë që në këtë sistem për vitin raportues 2021 janë evidentuar 86 lëndë, nga të cilat 66 lëndë janë kryer, ndërsa 20 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Sektori i procedurës paraprake në njësinë për krim të organizuar dhe korrupsion

Në këtë sektor viti ka filluar me 1 lëndë të mbetur, janë pranuar 523 lëndë KOK-PP, përkatësisht sektori ka vepruar për 524 lëndë, nga të cilat të kryera janë gjithsej 507 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 17 lëndë KOK-PP. Gjithashtu, janë evidentuar 5 lëndë të reja OKNZD, ndërsa me 1 lëndë të mbetur nga viti 2020, gjithsej ka vepruar për 6 lëndë nga të cilat 4 lëndë janë kryer ndërsa në punë kanë mbetur 2 lëndë OKNZD.

Nga lëndët e pranuar KOK-PP, 44 lëndë janë me propozim-marrëveshje nga të cilat 42 lëndë janë kryer ndërsa 2 lëndë kanë mbetur të pakryera. Nga 66 lëndët e pranuar K-PP janë me kërkesë për masa të veçanta hetimore nga të cilat 55 lëndë janë kryer, ndërsa kanë mbetur të pakryera 6 lëndë.

Është vepruar për 122 lëndë paraburgimi, në të cilat ndaj 136 personave është caktuar masë paraburgimi, për 10 persona është caktuar paraburgim shtëpiak. Janë caktuar masa për parandalim për 11 persona. Krahas kësaj, për 5 persona është caktuar paraburgim ekstradimi.

Zbatimi i sanksioneve

Nga viti i kaluar kanë mbetur 3 541 lëndë të pakryera. Janë pranuar 25 894 lëndë të reja dhe gjithsej në punë ka pasur 29 435 lëndë. Janë kryer 26 355 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 3 080 lëndë.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në vitin 2021, gjithsej në punë ka pasur 2 449 lëndë të vjetra. Prej tyre 1472 lëndë janë kryer, ndërsa të pakryera kanë mbetur 976 lëndë.

Burime njerëzore

Gjykata e ka përfunduar vitin raportues me 51 gjyqtarë. Tre gjyqtarëve të paraparë me sistematizimin u pushon funksioni i gjyqtarit, dy janë dërguar në gjykatë tjetër, ndërsa një në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë vitit 2021 katër gjyqtarë janë shkarkuar me vendim të Këshillit Gjyqësor, nga të cilët njërit gjyqtar i është ndërprerë funksioni me kërkesë të tij. Gjithashtu, janë zgjedhur 3 gjyqtarë të rinj, ndërsa 1 gjyqtar është deleguar në Gjykatën Themelore Kumanovë.

Në gjykatë gjithsej punojnë 270 nëpunës gjyqësor si dhe 16 të punësuar që kanë statusin e nëpunësve gjyqësor ndërsa bëjnë punën ndihmës teknik dhe gjithsej 16 polic gjyqësor. 2 nëpunësve gjyqësor u pushon marrëdhënia e punës. Janë punësuar edhe 25 nëpunës gjyqësor me marrëdhënie të caktuar kohore. Krahas kësaj, në vitin raportues me shpalljen publike të zbatuar janë punësuar 2 nëpunës gjyqësor në kohë të pacaktuar. Gjatë vitit 2021, punësimi u ka pushuar 9 nëpunësve gjyqësor.

Edhe pse me aktin për sistematizimin e vendeve të punës janë paraparë edhe vende të punës për nëpunës udhëheqës gjyqësor, Gjykata Themelore Penale Shkup, përveç një udhëheqësi të sektorit dhe dy udhëheqësve të njësisë, nuk ka nëpunës tjerë udhëheqës gjyqësor. Numrit të madh të punësuarve, mungesa e nëpunësve udhëheqës gjyqësor shkakton vështirësi në punën e gjykatës. Krahas kësaj mungojnë edhe nëpunës ndihmës profesional siç janë daktilografist-procesmbajtës.

Kapacitetet hapësinore

Kapacitet hapësinore me shpërnguljen në ndërtesën e re janë të kënaqshme. Pajisja informatike përtërihet, është furnizuar edhe një pajisje e re dhe ajo është instaluar në ndërtesën e re, por ajo është gjendje që vazhdimisht duhet të përmirësohet. Gjykata Themelore Penale Shkup tregon në atë se aplikimi i AKMIS është i ngadalshëm për punë, dhe si shkak nga Edusofti është thënë se gjykata ka serverë të vjetruar që nuk kanë kurrfarë garancish dhe nuk kanë pjesë rezerve për ato. Gjatë vitit raportues gjykata nuk ka pasur mundësi që ti realizojë projektet e planifikuara, në mënyrë që gjatë vitit planifikohet që në afat mundësisht të shpejtë të bëhet zëvendësimi i serverëve të vjetruar. Krahas kësaj, si dhe në vitin raportues edhe gjatë vitit vijues është i domosdoshëm të jetë:

- mbindërtimi i sistemit për incizim audio të seancave në sallat e gjykimit me pajisje shitesë video për të njëjtat,
- pajisja e sallës së gjykimit për krim të organizuar në ndërtesën e vjetër me pajisje për audio – incizim të seancave,
- projekti për rregullimin e dy sallave më të vogla të gjykimit në katin e 7 në një më të madhe që do të shërbejë për gjykim në krimin e organizuar,
- të furnizohen 30 skanerë profesional, me qëllim që të gjitha shkresat e gjykatës të digjitalizohen dhe të futen në sistemin AKMIS,
- furnizimi i 25 lcd televizorëve në të gjitha sallat e gjykimit që do të shërbejnë për prezantimin e provave audio video.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Penale Shkup, si edhe në vitin e kaluar edhe në vitin 2021, edhe krahas punës në kushte të pandemisë me virusin KOVID19, në krahasim me punën në fjalë ka treguar cilësi të lartë dhe përditësim dhe konsiderohet si **gjykatë e përditësuar**.

Të dhënat statistikore lidhur me cilësinë e punës tregojnë se kjo gjykatë dallohet me përqindje të lartë të vendimeve të pa ankimuara, dhe me vendime ankimore dhe të konfirmuara nga gjykatat më të larta. Këto tregues tregojnë se bëhet fjalë për gjykatë me

rezultate cilësore të larta të punës. Sipas rëndësisë dhe kuantitetit të lëndëve, Gjykata Themelore Penale Shkup me siguri është një nga gjykatat më të mbingarkuara dhe nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të publikut dhe duhet edhe në të ardhmen të vazhdojë me përditësim dhe punë cilësore.

Kushtet hapësinore janë nivel relativisht të përmbushur. Sa i përket gjendjes me pajisjen informatike, patjetër të mbahet llogari që në afat të mundshëm të shpejtë të bëhet ndryshimi i serverëve të vjetruar. Krahas kësaj, i domosdoshëm është edhe mbindërtimi i sistemit për incizimin audio të seancave në sallat e gjykimit me video pajisje shtesë për të njëjtat, pajisjen e sallës së vjetër të gjykimit për krim të organizuar në ndërtesën e vjetër të gjykatës me pajisje për audio-video incizim të seancave, projektin e rregullimit të dy sallave më të vogla në një sallë më të madhe që do të shërbejë për gjykim të krimit të organizuar, të furnizohen 30 skanerë profesional me qëllim që shkresat që janë në gjykatë të digjitalizohen dhe të futen në sistemin AKMIS, si dhe furnizimi me 25 lcd televizorë në të gjitha sallat e gjykimit që do të shërbejnë për prezantimin e provave audio video. Në periudhën që vijon gjykata duhet të përforcohet me kuadro me nëpunës udhëheqës gjyqësor dhe me nëpunës ndihmës udhëheqës siç janë daktilografist-procesmbajtës.

GJYKATA THEMELORE CIVILE SHKUP

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në vitin raportues 2021, Gjykata Themelore Civile Shkup në punë ka pasur gjithsej 54.609 lëndë, nga të cilat 15.196 lëndë si të pakryera janë bartur nga viti i kaluar, 38.162 lëndë të reja, nga të cilat 1.320 lëndë përsëri në punë.

Gjatë vitit raportues nga gjithsej lëndët në punë, gjykata ka kryer 39.418 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 15.191 lëndë. Gjatë vitit 2021 Gjykata Themelore Civile e ka kaluar fluksin, ndërsa e ka zvogëluar numrin e lëndëve të mbetura për 5 lëndë.

Cilësia e punës në nivel të gjykatës

Nga lëndët ankimore dhe të cilat janë kthyer gjatë vitit raportues: 4869 janë lëndë të konfirmuara, përkatësisht 17,05%, të ndryshuara janë 348, përkatësisht 1,22%, të abroguara janë 730, përkatësisht 2.56%, pjesërisht të abroguara janë 157, përkatësisht 0.55%, në krahasim me vitin e kaluar raportues ka përmirësim të cilësisë.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit raportues në gjykatë, gjithsej në punë ka pasur 3958 lëndë me statusin e lëndëve të vjetra, nga të cilat 2254 lëndë kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar, ndërsa 2704 janë pranuar gjatë vitit 2021, nga të cilat 2443 udhëhiqen si të kryera, ndërsa 2515 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Sa i përket lëndëve të vjetra nuk është tejkeluar fluksi dhe është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur.

Burime njerëzore

Gjatë vitit 2021 gjykata kompetencat e saj ligjore i ka realizuar me një numër të vogël të gjyqtarëve nga ajo e përcaktuar sipas sistematizimit. Sa i përket nëpunësve gjyqësor edhe krahas punësimeve të përkohshme nuk ka mjaftueshëm nëpunës për mbikëqyrjen kur palët kërkojnë këqyrjen e lëndëve.

Kapacitet hapësinore

Gjykata Themelore Civile Shkup nuk ka mundësi hapësinore për ndërmarrjen e arkivit të noterëve, gjithashtu ka nevojë për pajisje të IT kompjuterëve dhe monitorëve.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Civile Shkup, gjatë vitit 2021 e ka tejkaluar fluksin e lëndëve dhe është zvogëluar numri i lëndëve të mbetura, që do të thotë se Gjykata Themelore Civile Shkup, për vitin raportues 2021 konsiderohet si **gjykatë e përditësuar**.

Propozim masa:

Që të kapërcehen mangësitë nevojitet:

Zgjedhja e gjyqtarëve;

Të gjendet hapësirë për arkivin.

GJYKATA THEMELORE VELES

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në vitin raportues 2021 Gjykata Themelore Veles, ka pasur 21.162 lëndë në punë, nga të cilat 2.177 lëndë si të pakryera janë bartur nga viti i kaluar.

Gjatë vitit raportues nga gjithsej numri i lëndëve në punë, gjykata ka kryer 18.432 lëndë, ndërsa 2.730 lëndë kanë mbetur të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore në fillim të vitit 2021 ka pasur 3 lëndë të pakryera nga viti 2020. Gjithsej numri i lëndëve në punë gjatë vitit 2021 ka qenë 1.047 lëndë nga të cilat janë kryer 1.049 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 7 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Gjatë vitit 2021, janë kryer 5.741 lëndë. Prej tyre 622 lëndë janë të konfirmuara, përkatësisht 10,08%, të abroguara janë 138 lëndë, përkatësisht 2.4% dhe të ndryshuara janë 87 lëndë, përkatësisht 1,5%.

Puna e lëndëve në sektor

Spektori penal

Lëndë të pakryera nga viti i kaluar janë 1.320 lëndë. Gjithsej numri i lëndëve në punë në vitin 2021 ka qenë 15.676 lëndë nga të cilat 13.729 lëndë udhëhiqen si të kryera, ndërsa 1947 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Spektori civil

Nga viti i kaluar kanë mbetur 857 lëndë. Gjithsej numri i lëndëve në punë në vitin 2021 ka qenë 5.486, nga të cilat 4.703 lëndë janë të kryera, ndërsa 783 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Cilësia e lëndëve në nivel të sektorit

Spektori penal

Nga 4.645 lëndët e kryera, 282 lëndë ose 6.1% janë të konfirmuara, 84 lëndë përkatësisht 1,8% janë lëndë të abroguara, përkatësisht 1,5% të ndryshuara.

Spektori civil

Nga 1.096 lëndët e kryera gjatë vitit raportues, 340 lëndë përkatësisht 3,1% janë të konfirmuara, 54 lëndë përkatësisht 4,9% janë të abroguara ndërsa 19 lëndë përkatësisht 1,7% janë të ndryshuara.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në Gjykatën Themelore Veles, gjendja me lëndët e vjetra është si vijon: gjithsej lëndë të vjetra për të cilat ka vepruar gjykata ka pasur 465, nga të cilat 180 kanë mbetur nga

viti i kaluar 2020, janë pranuar 285 lëndë, janë kryer 255 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 210 lëndë.

Burime njerëzore

Me vendim të Këshillit Gjyqësor të RMV, është konstatuar që funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Themelore Veles ta realizojnë 18 gjyqtarë. Gjatë vitit 2021 janë plotësuar 16 vende të gjyqtarëve, duke përfshirë edhe Kryetarin e gjykatës. Me vendim të Këshillit gjyqësor të RMV një gjyqtar nga muaji mars është deleguar në Gjykatën Themelore Kavadar dhe një gjyqtar gjatë tërë vitit është deleguar në Gjykatën Themelore Negotinë.

Në lidhje me burimet njerëzore sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, janë paraparë gjithsej 114, ndërsa deri më 31.12.2021, janë plotësuar 50 vende pune.

Me planin vjetor për punësim për vitin 2021 janë miratuar mjete për 3 punësime të nëpunësve gjyqësor, janë miratuar avancime të 5 nëpunësve gjyqësor në kohë të caktuar.

Kapacitet hapësinore

Në këtë gjykatë është vendosur edhe Prokuroria Themelore Publike, të cilës i janë lëshuar 9 hapësira dhe Avokatura Shtetërore, të cilës i janë lëshuar 3 hapësira për shfrytëzim.

Ndërtesa në të cilën punon gjykata është rinovuar në periudhën prej 2001 – 2009 dhe është në gjendje të mirë, përveç fasadës së ndërtesës, për të cilën edhe pse me buxhetin e vitit 2020 janë kërkuar mjete për rikonstruktim, por të njëjtat nuk janë miratuar.

Zbatohet AKMIS sistemi. Incizimi me zë përdoret në tre salla gjykimi. Në vitin 2021 për dalje në vend ngjarje janë siguruar dy laptop kompjuterë dhe dy shtypës bartës, që kanë shërbyer për shtypjen e procesverbaleve në vend ngjarje.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë së të dhënave të prononcuar rezulton se Gjykata Themelore Veles, gjatë vitit 2021 nuk ka qenë e përditësuar, për arsye se nuk ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve. Në fillim të vitit 2021, kanë mbetur të pakryera 2.177 lëndë, ndërsa gjithsej në punë ka pasur 21.162 lëndë, nga të cilat 18.432 lëndë janë të kryera, përderisa 2.730 udhëhiqen si të pakryera, ashtu që rezulton se Gjykata Themelore Veles gjatë vitit 2021, për shkak se nuk ka arritur të tejkalojë fluksin për 553 lëndë, konsiderohet si **gjykatë e pa përditësuar**.

Propozim masa:

Të merren masa për sigurimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve dhe plotësimin e vendeve të tjera të nevojshme pune.

Të vërehet mundësia për ri pajisjen teknike, përkatësisht rinovimin e gjykatës,

Të mundohet të tejkalojë fluksin e lëndëve të të gjitha llojet e lëndëve dhe të përmirësohet cilësia në vendimmarrjen e lëndëve.

GJYKATA THEMELORE GJEVGJELI

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata vitin e ka filluar me 520 lëndë. Në punë ka pranuar 9.824 lëndë të reja, 133 lëndë kanë qenë përsëri në punë, gjithsej në punë ka pasur 10.477 lëndë. Prej tyre ka kryer 10.009 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 468 lëndë. Fluksi i lëndëve është tejkaluar dhe numri i lëndëve që kanë mbetur është zvogëluar për 52 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore si lëndë në regjistrat adekuat është vepruar për 1.272 lëndë dhe janë kryer të gjitha lëndët.

Administrata gjyqësore është udhëhequr nga Kryetarja e gjykatës Marica Avramçeva Zafirova.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Sektori penal

Nga viti i kaluar kanë mbetur 142 lëndë. Janë pranuar 6.245 lëndë dhe 89 lëndë përsëri të marra në punë. Gjithsej në punë ka pasur 6.476 lëndë. Prej tyre janë kryer 6.305 lëndë dhe 171 lëndë kanë mbetur të pakryera. Numri i lëndëve që kanë mbetur është rritur për 29 lëndë.

Cilësia e punës së Sektori penal

Nga 1.152 lëndët e kryera me të drejtë ankese, 81 lëndë ose 7,03 %, janë të konfirmuara, 19 lëndë ose 1,39%, janë të abroguara dhe 18 lëndë ose 1,56 %, janë të ndryshuara.

Sektori civil

Nga viti i kaluar kanë mbetur 378 lëndë. Janë pranuar 2.307 lëndë të reja, me 44 lëndë përsëri të marra në punë, gjithsej në punë ka pasur 2.729 lëndë. Nga ato 2.432 lëndë janë të kryera ndërsa kanë mbetur 297 lëndë të pakryera. Numri i lëndëve që kanë mbetur është zvogëluar për 81 lëndë.

Cilësia e punës në sektorin civil

Nga 683 lëndët e kryera me të drejtë ankese, 164 lëndë apo 24,01 %, të konfirmuara janë 21 lëndë apo 3,08%, janë të abroguara dhe 6 lëndë, apo 0,88%, janë të ndryshuara. (Përqindja është llogaritur lidhur me numrin e lëndëve të kryera).

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fillim të vitit 2021 Gjykata Themelore Gjevgjeli ka pasur 29 lëndë të vjetra prej 2 viteve në punë. Në fund të vitit 2021 kanë mbetur 24 lëndë të vjetra në punë, që do të thotë se numri është zvogëluar për 3 lëndë.

Burime njerëzore

Në vitin raportues gjykata ka pasur numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve dhe administratës dhe në raportin nuk tregohet mungesë.

Sipas sistematizimit në Gjykatën Themelore Gjevgjeli, në vitin 2021 funksionin e gjyqtarit e kanë realizuar 9 gjyqtarë së bashku me Kryetarin e gjykatës, ndërsa një gjyqtar gjatë vitit ka shkuar në pension dhe kanë mbetur 8 gjyqtarë.

Kapacitetet hapësinore

Ndërtesa e gjykatës është funksionale dhe i përmbush nevojat e gjykatës, por nevojitet rikonstruktimi i çatisë.

Gjendja me pajisjen informatike i përmbush nevojat e gjykatës.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Për punën e gjykatës mund të përfundohet si vijon:

Nga aspekti i punës së lëndëve, gjykata është e **përditësuar**, fluksi i lëndëve është tejkaluar dhe është zvogëluar numri i lëndëve që kanë mbetur për 52 lëndë.

Cilësia e punës vërehet edhe me përqindjen e lartë të vendimeve të pa ankimuar dhe cilësinë e punës në lidhje me lëndët gjithsej të kryera.

Kushtet hapësinore dhe gjendja me pajisjen informatike dhe të sigurisë përmbushet, por nevojitet edhe rinovimi i çatisë nga ndërtesa dhe infrastruktura.

Në periudhën e ardhshme duhet të përmirësohen kapacitetet e pajisjes informatike të gjykatës.

Duhet të vazhdohet me punën cilësore.

GJYKATA THEMELORE KAVADAR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2021, në Gjykatën Themelore Kavadar nga viti 2020 kanë mbetur 1039 lëndë të pakryera, 12901 lëndë të reja të pranuar. Gjatë vitit 2021, në punë ka pasur gjithsej 14022 lëndë. Të kryera kanë qenë 13133 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 889 lëndë. Gjatë vitit 2021, Gjykata Themelore Kavadar, e ka tejkeluar fluksin, ndërsa numri i lëndëve që kanë mbetur është zvogëluar për 150 lëndë.

Cilësia e punës në nivel të gjykatës

Nga 13133 lëndët e kryera, ndërsa nga lëndët ankimore dhe të cilat janë kthyer gjatë vitit raportues: 275 lëndë janë të konfirmuara përkatësisht 2.93%, të ndryshuara janë 21, përkatësisht 0.16%, të abroguara janë 45 lëndë, përkatësisht 0.48%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit raportues në gjykatë gjithsej në punë ka pasur 239 lëndë me statusin e lëndëve të vjetra, nga të cilat 141 nga viti i kaluar që kanë mbetur të pakryera, ndërsa 98 janë pranuar gjatë vitit 2021, nga të cilat të kryera janë 189 ndërsa 39 lëndë kanë mbetur të pakryera.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Kavadar gjatë vitit 2021 e ka tejkeluar fluksin e lëndëve, e ka zvogëluar numrin e lëndëve që kanë mbetur dhe konsiderohet si **gjykatë e përditësuar**.

Propozim masa:

Zgjedhja e gjyqtarëve,

Punësimi i nëpunësve gjyqësor,

Rinovimi dhe adaptimi i ndërtesës gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE KRATOVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në Gjykatën Themelore Kratovë, nga viti i kaluar 2020 kanë mbetur gjithsej 242 lëndë, ndërsa gjatë vitit 2021 janë pranuar 2527 lëndë, 32 lëndë kanë qenë përsëri në punë, nuk ka lëndë gabimisht të evidentuara, ashtu që gjithsej numri i lëndëve në punë në vitin 2021 kanë qenë 2801 lëndë të kryera. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë, gjatë vitit 2021 janë kryer 2570 lëndë, ndërsa kanë mbetur 231 lëndë të pakryera.

Administrata gjyqësore

Në punën e administratës gjyqësore, që në fillim të vitit nuk ka pasur lëndë të pakryera, gjatë vitit 2021 janë pranuar 497 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara nuk ka. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë, janë kryer 496, ndërsa 1 lëndë ka mbetur e pakryer.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Në Sektorin civil të Gjykatës Themelore Kratovë, nga viti i kaluar kanë mbetur 130 lëndë të pakryera, janë pranuar 585 lëndë të reja, 21 lëndë kanë qenë përsëri në punë, ndërsa gabimisht të evidentuara nuk ka. Gjatë vitit 2021 në këtë sektor ka pasur gjithsej 736 lëndë në punë, nga të cilat 576 lëndë janë kryer ndërsa 160 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Në Sektorin penal të Gjykatës Themelore Kratovë nga viti i kaluar raportues kanë mbetur 112 lëndë të pakryera, janë pranuar 1445 lëndë të reja, 11 lëndë kanë qenë përsëri në punë ndërsa gabimisht të evidentuara nuk ka. Gjatë vitit 2021 në këtë sektor ka pasur

1568 lëndë në punë, nga të cilat 1498 lëndë janë kryer, ndërsa kanë mbetur 70 lëndë të pakryera.

Cilësia e lëndëve në nivel të Sektorëve në punë sipas raportit të dorëzuar është shprehur në mënyrën si vijon:

- në Sektorin civil nga gjithsej 576 lëndëve të kryera, vendimet janë konfirmuar në 100 lëndë apo 17,36%, të abroguara 17 lëndë apo 2,95%, ndërsa të ndryshuara kanë qenë 8 lëndë apo 1,38%.

- në Sektorin penal nga gjithsej 1498 lëndët e kryera, vendimet janë konfirmuar në 20 lëndë apo 1,33%, të abroguara 10 lëndë apo 0,66%, ndërsa të ndryshuara 13 lëndë apo 0,86%.

Njëkohësisht, Sektori penal ka 1 lëndë të hedhur poshtë, 0,066%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në vitin raportues 2021 Gjykata Themelore Kratovë në punë ka pasur gjithsej 49 lëndë të vjetra, nga të cilat K-5 lëndë penale për persona madhor, lëndë për kundërvajtje PRK-1, kontestime vlera e ulët MALVP-1 lëndë, konteste pune RO-3 lëndë dhe trashëgimore O-39 lëndë, të cilat u janë besuar noterëve për procedim.

Nga gjithsej 49 lëndët e vjetra, gjatë vitit 2021 17 lëndë janë të kryera, nga të cilat: 1 lëndë nga ato penale për persona madhor, 1 lëndë për kundërvajtje, 1 lëndë kontestime të vlerës së ulët, 2 lëndë konteste pune dhe 12 lëndë trashëgimore.

Në fund të vitit kanë mbetur 4 lëndë penale për persona madhor, 1 lëndë për konteste pune dhe 12 lëndë trashëgimore.

Kanë mbetur vetëm 5 lëndë të vjetra të pakryera.

Nga 39 lëndët e vjetra trashëgimore të cilat janë shpërndarë për procedim te noterit kanë mbetur 27 lëndë të pakryera, në mënyrë që ndër të tjerat, arsytet për këtë janë më tepër të natyrës objektive për shkak të faktit që në Komunën Kratovë më shumë se 3 vite nuk është emëruar noter deri në muajin shkurt 2021 kur është zgjedhur noter. Lëndët që janë shpërndarë për procedim në noter në Kumanovë, i janë shpërndarë noterit në Kratovë dhe për ato ka pasur ngecje të vogël në vendimmarrjen e lëndëve që kanë mbetur të vjetra.

Burime njerëzore

Në lidhje me burimet njerëzore, sipas Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Kratovë, janë paraparë gjithsej 53 vende pune që duhet të jenë të plotësuara në gjykatë.

Më 01.01.2021 Gjykata Themelore Kratovë, detyrat e punës për të cilat është kompetente gjykata janë kryer nga gjithsej 18 punonjës në shërbimin gjyqësor, të punësuar në kohë të pacaktuar. Me përfundimin e vitit 2021 kanë mbetur të zbrazura dhe të pa plotësuara 3 vende pune, ndërsa gjykata ka mbetur vetëm me 10 nëpunës gjyqësor, të punësuar në kohë të pacaktuar. Me shkuarjen e ardhshme në pension të edhe 2 nëpunësve gjyqësor në vitin 2022, gjendja me burimet njerëzore në Gjykatë do të jetë alarmante.

Gjykata Themelore Kratovë gjatë këtij viti si gjykatë me kompetencë themelore pushtetin gjyqësor e ka realizuar me 3 gjyqtarë siç edhe janë përcaktuar vendet e punës për këtë gjykatë me vendim të Këshillit gjyqësor, deri më 04.10.2021, kur njëri nga gjyqtarët i ka pushuar funksioni për shkak të realizimit të së drejtës së pensionit me moshë. Nga 28 dhjetori 2020, funksionin Kryetar i gjykatës e kryen një gjyqtar nga Gjykata Themelore Kumanovë, që gjatë vitit 2021 nuk ka proceduar me lëndë gjyqësore. Me këtë në gjykatë kanë mbetur që funksionin e gjyqtarit ta kryejnë 2 gjyqtarë, ndërsa Kryetari i gjykatës e kryente vetëm funksionin Kryetar të gjykatës, në përputhje me Orarin vjetor të punës për vitin 2021. Sipas Orarit të punës së gjykatës për vitin 2021 të tre gjyqtarët kanë punuar mbi lëndët nga të gjitha sferat dhe lëndët janë shpërndarë me shpërndarjen automatike në sistemin AKMIS.

Kapacitete hapësinore dhe teknologjia informatike

Gjykata Themelore Kratovë punon në ndërtesën e gjykatës së saj, që në mënyrë funksionale përshtatet për dedikimin e gjykatës themelore, në të cilën për çdo gjyqtarë ka zyrën e vet me biro pune të vetën dhe kompjuter. Në gjykatë ka 3 salla të pajisura për gjykim, në të cilat mbahen seancat gjyqësore, nga të cilat njëra sallë është e përgatitur për incizim tonik të seancave në procedurën kontestuese. Problem serioz të gjykatës që me vite zvarritet është ajo që gjykata ka sistem ngrohje-avull që punon me energji elektrike dhe e cila është jo ekonomike, e vjetruar dhe nuk e arrin temperaturën e duhur për punën normale në hapësirat gjyqësore. Gjithashtu, nevojitet që dritaret e rrënuara prej druri të zëvendësohen me të reja, dhe të përmirësohet sistemi i ngrohjes në gjykatë me burim më ekonomik të energjisë duke shfrytëzuar energjinë diellore përmes qelizave fotovoltaike për të cilat ka projekt me llogaritje sa do të kursehet energji elektrike.

Hapësirat e brendshme në gjykatë në përdhese dhe në katin e parë, ku janë vendosur sallat e gjykimit, janë të mbuluara me video mbikëqyrës. Arkivi i gjykatës është vendosur në hapësirat e podrumit dhe e njëjta në një pjesë të konsiderueshme është e pajisur me rafte metali, por të njëjtat nuk janë të mjaftueshme për tërë arkivin e gjykatës dhe duhet ri pajisje. Në hapësirat e podrumit kur bie shi vazhdimisht paraqitet ujë dhe lagështi.

Për përmirësimin e kushteve hapësinore, është përpunuar një projekt konkret për rinovimin e ndërtesës së gjykatës, në të cilën janë llogaritur lartësia e mjeteve të nevojshme për realizimin e këtij rikonstruksioni, që përbëhet nga zëvendësimi i dritareve ekzistuese prej druri me PVC dritare, rinovimi i fasadës së ndërtesës me realizimin e fasadës efikase energjetike, si dhe zëvendësimin e dyerve të brendshme në ndërtesën e gjykatës

Sa i përket teknologjisë informatike, në gjykatë puna me lëndët gjyqësore zhvillohet tërësisht në programin AKMIS.

Në Sektorin e kontabilitetit shfrytëzohet sistemi – ABMS, që ka probleme gjatë shfrytëzimit nga ana e nëpunësve gjyqësor, për shkak se është i domosdoshëm përmirësimi i këtij programi në mënyrë që nuk do të ballafaqohen me probleme gjatë punës.

Për incizimin tonik të seancave shfrytëzohet SRS FEMIDA sistemi, përkatësisht softueri për udhëheqjen e procesverbaleve të seancave. Duhet që të gjendet një mënyrë që të mirëmbahet ky sistem, ngase i njëjti në këtë gjykatë është instaluar vetëm në një sallë gjykimi dhe veç më pajisja vjetrohët. Duhet të instalohet edhe një sistem për incizim tonik në sallë tjetër gjykimi për tu plotësuar detyrimi ligjor për incizimin tonik të seancave.

Gjykata ka nevojë për përtëritjen e teknologjisë informatike, ngase tërë pajisja është veç më e vjetër prej 5 vitesh, në sallat për incizim tonik dhe gjykim nevojitet të përtërihen UPS sistemet për mbushjen me energji elektrike dhe nevojitet furnizimi i 1 Arke (dollar metalik) për rruajtjen e cedeve nga përshkrimet tonike të seancave gjyqësore, ngase gjykata ka për detyrë që ti rruajë 5 vjet.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Kratovë, gjatë vitit 2021 nuk e ka zgjedhur fluksin e lëndëve në Sektorin civil ngase në Sektorin civil në fillim të vitit ka pasur 130 lëndë të pakryera, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 160 lëndë të pakryera. Në anën tjetër, gjykata e ka zgjedhur fluksin në Sektorin penal ngase në Sektorin penal në fillim të vitit ka pasur 112 lëndë të pakryera, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 70 lëndë të pakryera.

Duke marrë parasysh se gjatë vitit 2021, Gjykata Themelore Kratovë në fillim të vitit ka pasur gjithsej 242 lëndë të pakryera, ndërsa në fund të vitit nga gjithsej numri i lëndëve në punë kanë mbetur 231 lëndë të pakryera, rezulton se Gjykata Themelore Kratovë e ka tejkaluar fluksin e lëndëve, në mënyrë që mund të konstatohet se është **gjykatë e përditësuar**.

Sa i përket cilësisë së lëndëve të kryera në nivel të gjykatës, vërehet rritja e cilësisë së lëndëve të konfirmuara dhe numri i zvogëluar i lëndëve të abroguara, por vërehen disa rënie të cilësisë me rritjen e butë të përqindjes së lëndëve të ndryshuara nga viti i kaluar raportues 2020, prej ku rezulton se gjykata në vitin e ardhshëm duhet të bëjë përpjekje në përmirësimin e cilësisë së vendimeve.

S ai përket burimeve njerëzore, si prioritet i lartë paraqitet nevoja për punësimin e 4 punësimeve të reja në shërbimin gjyqësor.

Për shkak të përmirësimit të kushteve hapësinore në gjykatë propozohet realizimi i Projektit të përpiluar për rinovimin e ndërtesës së gjykatës, që përfshin zëvendësimin e dritareve ekzistuese prej druri me dritare PVC, rinovimin e fasadës së ndërtesës me realizimin e fasadës efikase energjetike, si dhe zëvendësimin e dyerve të brendshme në ndërtesën e gjykatës. Gjithashtu, nevojitet edhe sigurimi i arkës metalike për rrualtjen e CD nga seancat e mbajtura tonike.

GJYKATA THEMELORE KRIVA PALLANKË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në fillim të periudhës raportuese për vitin 2021, në Gjykatën Themelore Kriva Pallankë kanë mbetur 1.044 lëndë të pakryera, janë pranuar 5.807 lëndë të reja, 103 lëndë janë përsëri në punë dhe 6 lëndë janë gabimisht të evidentuara apo gjithsej në punë ka pasur 6.948 lëndë, nga të cilat 5.923 lëndë të kryera, ndërsa kanë mbetur 1.031 lëndë të pakryera.

Gjykata Themelore Kriva Pallankë gjatë vitit 2021 e ka tejkaluar fluksin e lëndëve.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Gjatë vitit 2021, janë pranuar 323 lëndë të reja.

Në vitin 2021 ka pasur gjithsej 323 lëndë në punë.

Në vitin 2021 numri i lëndëve të kryera ka qenë 323 lëndë.

Spektori penal

Nga viti i kaluar 2020, në sektorin penal kanë mbetur 92 lëndë të pakryera. Në vitin 2021 janë pranuar 4.347 lëndë të reja, 48 lëndë janë përsëri në punë dhe 3 lëndë janë gabimisht të evidentuara. Gjithsej numri i lëndëve në punë gjatë vitit 2021 në sektorin penal është 4.487 lëndë. Në vitin 2021 në sektorin penal numri gjithsej i lëndëve të kryera është 4.318 lëndë. Lëndë të pakryera deri në fund të vitit 2021 kanë mbetur 169 lëndë. Spektori penal i Gjykatës Themelore Kriva Pallankë e ka tejkaluar fluksin e lëndëve.

Cilësia e Spektorit penal

Nga lëndët ankimore dhe të kryera 1.327 lëndë të cilat janë kthyer gjatë vitit 2021, të konfirmuara janë 76 lëndë apo 5,72%, të abroguara janë 19 lëndë apo 1,43% dhe të ndryshuara janë 18 lëndë apo 1,35%.

Spektori civil

Nga viti i kaluar 2020, në sektorin civil kanë mbetur 952 lëndë të pakryera. Numri i lëndëve të reja të pranuar në vitin 2021 është 1.137 lëndë, 55 lëndë janë përsëri në punë dhe 3 lëndë janë gabimisht të evidentuara. Gjithsej numri i lëndëve në punë gjatë vitit 2021 është 2.144 lëndë. Numri gjithsej i lëndëve të kryera gjatë vitit 2021 në sektorin civil është 1.282 lëndë. Deri në fund të vitit 2021 kanë mbetur 862 lëndë të pakryera në Spektorin civil të Gjykatës Themelore Kriva Pallankë.

Cilësia e spektorit civil

Nga lëndët ankimore dhe të kryera 477 që janë kthyer gjatë vitit 2021, të konfirmuara janë 213 lëndë apo 44,65%, të abroguara janë 23 lëndë apo 4,82% dhe të ndryshuara janë 6 lëndë apo 1,25%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit 2021, në Gjykatën Themelore Kriva Pallankë ka pasur 510 lëndë të vjetra, nga të cilat: 497 janë lëndë trashëgimore (noterë), 6 janë lëndë jashtë kontestimore, 6 janë kontestimore, 10 lëndë janë nga KUIKP (vuajtjen e dënimit) dhe 4 lëndë janë për kundërvajtje.

Konstatime të shkurta për kushtet e punës

Në Gjykatën Themelore Kriva Pallankë, në vitin 2021 kanë punuar gjithsej 6 gjyqtarë së bashku me Kryetarin e Gjykatës (tre gjyqtarë në sektorin penal dhe tre gjyqtarë në sektorin civil). Në vitin 2021 në këtë gjykatë ka pasur 24 nëpunës gjyqësor të punësuar. Gjendja me vendet e punës në sportelet gjyqësore dhe policisë gjyqësore është seriozisht e rrezikuar, për arsye se në sportelet janë të plotësuara vetëm vendet e punës si referent të pavarur gjyqësor për pranimin dhe dërgimin e postës gjyqësore dhe si referent i pavarur gjyqësor – udhëheqës i sportelit penal (të personave madhor), përderisa sportelet tjera (kontestimore, jashtë kontestuese dhe trashëgimore, sporteli për kundërvajtje, sporteli për përmbarrimin e sanksioneve për kundërvajtje etj.) janë pa udhëheqës dhe absolutisht pa asnjë punonjës, me përjashtim të sportelit për kundërvajtje dhe sportelit për përmbarrimin e sanksioneve për kundërvajtje, në të cilat në dy sportelet punon vetëm një nëpunës gjyqësor-referent më i ri gjyqësor, që pa dallim vëllimit dhe seriozitetit të punës, me përpjekje të mëdha i realizon punët dhe detyrat e parashtruara.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Kriva Pallankë është **gjykatë e përditësuar**, pasi që e ka tejkaluar fluksin e lëndëve.

Propozim masa:

Nevojitet që të plotësohen vendet e punës për nëpunës gjyqësor në sportelet ngase gjendja është shqetësuese sa i përket mungesës së kuadrit, si dhe plotësimi i vendeve të punës për policë gjyqësor.

Sa i përket kapaciteteve hapësinore, duhet vazhdimisht përmirësimi i të njëjtave, ngase bëhet fjalë për një ndërtesë të vjetër e ndërtuar mbi 50 vjet.

GJYKATA THEMELORE KUMANOVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVET TË GJYKATËS

Gjykata Themelore Kumanovë, vitin 2021 e ka filluar me lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020 prej 3.834 lëndë. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 30.173 lëndë të reja, 358 lëndë kanë qenë përsëri në punë, 9 lëndë kanë qenë gabimisht të evidentuara apo në punë kanë qenë gjithsej 34.356 lëndë, nga të cilat 30.775 lëndë të kryera, ndërsa 3.581 lëndë të pakryera. Fluksi është tejkaluar, përkatësisht janë kryer gjithsej 89,57% lëndë nga gjithsej numri i lëndëve në vitin 2021. Krahasuar me vitin 2020, janë kryer 1,25% më shumë lëndë në vitin 2021.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Administrata gjyqësore vitin 2021 e ka filluar me 1 lëndë të mbetur nga viti i kaluar 2020. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 4.169 lëndë të reja, gjithsej në punë kanë qenë 4.170 lëndë nga të cilat janë kryer 4.145, ndërsa të pakryera kanë mbetur 25 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Nga gjithsej 9.388 lëndët e kryera, 1.067 janë të konfirmuara apo 11,37%. Janë abroguar 269 apo 2,87%, ndërsa të ndryshuara 133 apo 1,42%.

Krahasuar me vitin 2020 kur 12,735 janë të konfirmuara, ndërsa në vitin 2021 janë të konfirmuara 11,37%, rezulton se në vitin raportues 2021 cilësia e lëndëve të konfirmuara në nivel të gjykatës është zvogëluar për 1,36%.

Në vitin 2020 janë abroguar 3,31% lëndë, ndërsa në vitin 2021 janë abroguar 2,87%, në mënyrë që rezulton se në vitin raportues 2021 janë abroguar 0,44% lëndë më pak sa i përket përqindjes së lëndëve të abroguara në nivel të gjykatës.

Në vitin 2020 të ndryshuara janë 1,86% lëndë, ndërsa në vitin 2021 janë 1,42% lëndë, në mënyrë që rezulton se në vitin raportues 2021 cilësia në nivel të gjykatës së lëndëve të ndryshuara është zvogëluar për 0,44%, përkatësisht është zvogëluar përqindja e lëndëve të ndryshuara.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Spektori penal

Spektori penal vitin 2021 e ka filluar me 2.406 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 24.031 lëndë të reja, përsëri në punë 163 lëndë, gabimisht të evidentuara 8 lëndë përkatësisht gjithsej në punë ka pasur 26.592 lëndë, nga të cilat janë kryer 24.649, ndërsa 1.943 lëndë kanë mbetur të pakryera. Fluksi është tejkualuar.

Nga gjithsej 7.457 lëndë të kryera, 319 apo 4,28 lëndë janë të konfirmuara, të abroguara janë 106 apo 1,42%, ndërsa të ndryshuara janë 78 apo 1,04%.

Krahasuar me vitin 2020 kur në sektorin penal ka pasur 7,44% lëndë të konfirmuara, tani në vitin 2021 janë 4,28% lëndë të konfirmuara, rezulton se është zvogëluar numri i lëndëve të konfirmuara për 3,16%, në krahasim me vitin 2020.

Në vitin 2020 ka pasur 1,71% lëndë të abroguara, ndërsa në vitin 2021 ka 1,42% që do të thotë se është zvogëluar numri i lëndëve të abroguara për 0,29%.

Gjithashtu, në vitin 2020 të ndryshuara kanë qenë 1,55% e lëndëve, ndërsa në vitin 2021 janë 1,04% e lëndëve, që do të thotë se ka zvogëlim të lëndëve të ndryshuara për 0,51%.

Spektori civil

Spektori civil vitin 2021 e ka filluar me 1.428 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020. Në vitin 2021 janë pranuar 6.142 lëndë të reja, 1 lëndë gabimisht e evidentuar, 195 lëndë përsëri në punë, përkatësisht gjithsej në punë ka pasur 7.764 lëndë, nga të cilat 6.126 lëndë të kryera, ndërsa 1.638 lëndë kanë mbetur të pakryera. Fluksi është tejkualuar.

Nga gjithsej 1.931 lëndët e kryera, 748 apo 38,73% e lëndëve janë të konfirmuara, 163 apo 8,44% janë të abroguara dhe 55 apo 2,84% janë lëndë të ndryshuara.

Krahasuar me vitin 2020 kur në sektorin civil ka pasur 21,81% lëndë të konfirmuara, tani në vitin 2021 janë 38,73% lëndë të konfirmuara, rezulton se ka rritje për 16,92% të lëndëve të konfirmuara në krahasim me vitin 2020.

Në vitin 2020 ka pasur 6,04% lëndë të abroguara, ndërsa në vitin 2021 ka pasur 8,44%, që do të thotë se ka rritje të lëndëve të abroguara për 2,4%.

Gjithashtu, në vitin 2020 ka pasur 2,4% lëndë të ndryshuara, ndërsa në vitin 2021 janë 2,84% e lëndëve të ndryshuara, që do të thotë se ka rritje të lëndëve të ndryshuara për 0,44%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata në vitin 2021 ka pasur në punë gjithsej 853 lëndë të vjetra për të gjitha bazat, nga të cilat 469 janë bartur nga viti i kaluar, janë kryer 478 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 375 lëndë, nga të cilat 155 lëndë që janë për trashëgimi u janë dhënë Noterëve-të besueshëm të gjykatës, deri më 31.12.2021.

Nga të dhënat e theksuara, rezulton se ka zvogëlim në numrin e lëndëve të vjetra të pakryera në krahasim me vitin 2020 nga gjithsej 94 lëndë.

Burime njerëzore

Gjykata vitin 2021 e ka filluar me 141 punonjës, por më 31.12.2021 gjykata ka pasur gjithsej 139 punonjës nga të cilët 22 janë gjyqtarë së bashku me kryetarin. Në vitin 2021 në Gjykatën Themelore Kumanovë një gjyqtar nga Gjykata Themelore Penale Shkup është dërguar përkohësisht. Në vitin 2021 njërit nga gjyqtarët i është konstatuar ndërprerja e kryerjes së funksionit të gjyqtarit për shkak të kushteve të plotësuar për pension me moshë.

Kapacitetet hapësinore

Ndërtesa në të cilën punon Gjykata Themelore Kumanovë është ndërtuar para më shumë se 50 vitesh. Nevojitet që në një afat sa më i shkurtër i mundshëm të bëhet furnizimi i sistemit të automatizuar bashkëkohor kundërzjarr fikës për hapësirë të serverit; nevojitet rikonstruktimi i instalimit elektrik për shmangien e rrezikut nga nxehja e tij, zjarri dhe ndërprerja e befasishme, për shkak të numrit të madh të konsumuesve të energjisë elektrike – kompjuterëve, shtypësve, serverëve, kondicionerëve dhe të ngjashme. Nevojitet zëvendësimi i tërësishëm i rrejtësive lokal për lidhjen e kompjuterëve personal në sistemin AKMIS. Është i domosdoshëm riparimi i tërësishëm i sistemit për ngrohjen me ujë të ngrohtë me kapacitet adekuat dhe cilësi dhe zëvendësimi i naftës me gaz natyror. Gjithashtu, nevojitet rikonstruktimi i ndërtesës në përdhese, dhe me atë edhe një pjesë të hapësirave të tjera në gjykatë, për vendosjen e sistemit një sportel në përdhese dhe shpërngulja e sallave për gjykim nga përdhësja në katet e sipërme. Të gjendet një mënyrë që Avokatura e Shtetit të RMV, të disloket nga hapësirat e gjykatës dhe të mundësohet participim adekuat në shpenzimet për mirëmbajtjen e ndërtesës, shpenzimet komunale dhe nxehjen. Prokuroria Themelore Publike dhe Ekonomia e ujërave gjendet në katin e tretë të ndërtesës dhe absolutisht nuk merr pjesë në këto shpenzime, ndërsa Avokatura e Shtetit merr pjesë në shumën minimale që janë të papërshtatshme me hapësirën që e shfrytëzon edhe kuadri punonjës. Të sigurohen mjete financiare për vendosjen e fasadës të ndërtesës së gjykatës; nevojitet sigurimi i mjeteve për rikonstruktimin e tendës – verandës, që e mbulon hyrjen e ndërtesës së gjykatës. Nevojitet sigurimi i mjeteve për pajisjen e rregullimit të arkivit gjyqësor dhe atë edhe kuti për arkivin dhe raftet adekuate metalike. Të sigurohen mjete financiare për zbatimin e furnizimit publik për blerjen e centralit të ri telefonik, për shkak që ekzistuesja është më tepër se 20 vite dhe është në defekt të tërësishëm dhe nuk funksionon. Më tutje, nevojitet edhe një hapësirë tjetër ku do të qëndrojnë persona të arrestuar, të paraburgosur dhe të shoqëruar nga INP për nevojat e gjykimeve. Hapësirat ekzistuese janë joadekuate dhe të pamjaftueshme.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Kumanovë gjatë vitit raportues nga gjithsej 34.356, nga të cilat 30.775 janë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur 3.584 lëndë. Fluksi është tejkualuar, përkatësisht janë kryer gjithsej 89,57% nga gjithsej numri i lëndëve në vitin 2021.

Nga këtu, rezulton se Gjykata Themelore Kumanovë, gjatë vitit 2021 ka qenë **gjykatë e përditësuar** dhe e ka tejkualuar fluksin.

Gjithashtu, nga analiza e sipër theksuar e cilësisë së punës në nivel të gjykatës, sidomos në sektorin penal është zvogëluar, dhe në sektorin civil nga të dhënat, rezulton se cilësia e punës është rritur në nivel të gjykatës krahasuar me vitin 2020.

Propozim masa:

Në bazë të dhënave të ekspozuara rezulton se për përmirësimin e gjendjes në gjykatë, duhen përpjekje të mëdha për përmirësimin e cilësisë së punës në nivel të gjykatës, sidomos në sektorin penal, investim në kapacitetet hapësinore të ndërtesës së gjykatës, instalim elektrik, ngrohje me ujë të ngrohtë, sistemi i kundërzjarrit, pjesëmarrja adekuate në mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e PTHP dhe Avokaturës së Shtetit, pajisjen dhe plotësimin e rregull të vendeve të punës së sistematizuara.

GJYKATA THEMELORE NEGOTINË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata Themelore Negotinë, vitin 2021 e ka filluar me 1.223 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 6.049 lëndë të reja, 42 lëndë përsëri në punë, 14 lëndë gabimisht të evidentuara, ose në punë ka pasur gjithsej 7.300 lëndë nga të cilat 6.320 lëndë janë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur 980 lëndë. Fluksi është tejkualuar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Administrata gjyqësore vitin 2021 e ka filluar me 5 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 1.067 lëndë të reja, 4 lëndë gabimisht të evidentuara, ashtu që gjithsej në punë ka pasur 1.068 lëndë, nga të cilat 1.061 janë kryer, ndërsa 7 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Nga gjithsej 238 lëndët e kryera, 174 apo 73,1% janë lëndë të konfirmuara. Të abroguara janë 37 apo 2,32%, ndërsa të ndryshuara janë 27 apo 1,70%.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Spektori penal

Spektori penal vitin 2021 e ka filluar me 93 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 274 lëndë të reja, 10 lëndë kanë qenë përsëri në punë, 0 lëndë gabimisht të evidentuara, ashtu që gjithsej në punë kanë qenë 377 lëndë, nga të cilat 303 janë të kryera, ndërsa 74 lëndë kanë mbetur të pakryera. Fluksi është tejkualuar. Nga gjithsej 377 lëndët e kryera, të konfirmuara janë 21 apo 65,63%, të abroguara janë 6 apo 18,75%, ndërsa të ndryshuara janë 5 apo 15,63%.

Vitin raportues 2021, gjykata e ka filluar me 492 lëndë të pakryera për kundërvajtje nga viti i kaluar 2020. Gjatë vitit janë pranuar 982 lëndë të reja, 9 lëndë kanë qenë përsëri në punë, 2 lëndë gabimisht të evidentuara, ashtu që gjithsej në punë ka pasur 1.481 lëndë, nga të cilat 909 kanë qenë të kryera, ndërsa kanë mbetur të pakryera 572 lëndë. Fluksi nuk është tejkualuar. Nga gjithsej 909 lëndët e kryera, 68 apo 70,83% janë të konfirmuara, 10 apo 10,47% janë të abroguara, ndërsa të ndryshuara janë 18 apo 18,75%.

Vitin raportues gjykata e ka filluar me 83 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020 për përmbarrimin e sanksioneve penale. Gjatë vitit janë pranuar 748 lëndë të reja dhe me 4 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej në punë kanë qenë 827 lëndë, nga të cilat 765 janë kryer, ndërsa kanë mbetur 62 lëndë të pakryera. Fluksi është tejkualuar.

Spektori civil

Spektori civil vitin 2021 e ka filluar me 117 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020. Gjatë vitit 2021, janë pranuar 300 lëndë të reja, 21 lëndë kanë qenë përsëri në punë, 1 lëndë e evidentuar gabimisht, ashtu që gjithsej në punë kanë qenë 437 lëndë, nga të cilat 335 janë kryer, ndërsa kanë mbetur të pakryera 102 lëndë. Fluksi i lëndëve është tejkualuar. Nga gjithsej 335 lëndët e kryera, 84 apo 77,06% janë të konfirmuara, 21 apo 19,27% janë të abroguara dhe 42 apo 3,67 janë të ndryshuara.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata vitin 2021 e ka filluar me 216 lëndë të vjetra të pakryera, nga të cilat 21 janë lëndë gjyqësore ndërsa 195 janë lëndë trashëgimore të vjetra. Në fund të vitit kanë mbetur të pakryera 17 lëndë gjyqësore, ndërsa 49 lëndë trashëgimore te Noterët.

Burime njerëzore

Gjykata vitin 2021 e ka filluar me gjithsej 26 punonjës, nga të cilët 25 janë në kohë të pacaktuar dhe 1 në kohë të caktuar. Në gjykatë punojnë 5 gjyqtarë, së bashku me kryetarin dhe një gjyqtar përkohësisht i deleguar. Gjykata ka nevojë për plotësimin e 1 vendi të zbrazur për gjyqtar dhe punësimin e bashkëpunëtorëve gjyqësorë në kohë të pacaktuar.

Kapacitetet hapësinore

Ndërtesa në të cilën punon Gjykata Themelore Negotinë, është krejtësisht në gjendje të mirë dhe i plotëson nevojat e gjykatës, ndërsa këtë vit është pajisur me mobilie të reja dhe është vendosur laminat, dhe mbetet që këtë vit të rinovohen tualetet që janë të vjetra dhe në gjendje të keqe.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë të dhënave të ekspozuara rezulton se Gjykata Themelore Negotinë gjatë vitit 2021 ka qenë e **përditësuar** dhe e ka tejkaluar fluksin.

Propozim masa

Nga të dhënat rezulton se Gjykata Themelore Negotinë gjatë vitit 2021, ka treguar rezultate të mira cilësore dhe kuantitative.

GJYKATA E APELIT GOSTIVAR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në periudhën raportuese për vitin 2021, gjykata ka pasur 3.870 lëndë gjithsej në punë, numër të cilin e përbëjnë 471 lëndë të bartura nga viti i kaluar dhe 3.399 lëndë të reja të pranuar. Gjykata ka kryer 3.207 lëndë, ndërsa 663 lëndë kanë mbetur të pakryera. Fluksi i lëndëve të reja është rritur për 476 lëndë dhe numëron 3.399 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Fluksi i lëndëve të reja në periudhën raportuese është 1.324 lëndë, që paraqet rritje prej 189 lëndëve në krahasim me vitin e kaluar. Gjatë periudhës raportuese, të gjitha lëndët nga administrata gjyqësore janë përfunduar.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Spektori penal

Në sektorin penal sipas orarit të punës së gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Gostivar për vitin 2021 kanë punuar pesë këshilla penale, nga të cilat kanë vendosur për lëndë nga regjistri "KZH" – lëndë penale të shkallës së dytë dhe nga regjistri "PRKZH" – lëndë për kundërvajtje të shkallës së dytë përderisa një këshill penal për vendosjen e lëndëve penale nga regjistri "KZHM", sipas Ligjit për të drejtën e të miturve dhe këshilli i posaçëm që ka vepruar kryesisht me lëndët penale të evidentuara në regjistrin "KSZH" dhe "KR", si dhe këshilli penal prej pesë gjyqtarëve për veprat penale për të cilat me ligj është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 15 vite ose dënim me burgim të përjetshëm.

Gjatë vitit 2021, në Sektorin penal kanë vepruar 4 gjyqtarë duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës.

Spektori penal në periudhën raportuese ka pasur 1.512 lëndë në punë, nga të cilat 187 lëndë janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar, ndërsa 1.325 lëndë janë të reja të pranuar. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë gjykata ka kryer 1.331 lëndë, ndërsa 181 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Sa i përket vitit të kaluar kur gjykata në punë ka pasur 1.281 lëndë, në periudhën raportuese vëllimi i punës është rritur për 231 lëndë dhe numëron 1.512 lëndë, kjo është fal fluksit të rritur që është për 112 lëndë më i madh në krahasim me vitin e kaluar, si dhe me numrin e rritur për 119 lëndë nga viti i kaluar.

Numri i lëndëve të kryera në Sektorin penal në periudhën raportuese është rritur për 237 lëndë në krahasim me vitin e kaluar kur ka pasur 1.094 lëndë dhe numëron 1.331 lëndë.

Përderisa numri i lëndëve të pakryera që në vitin 2020 ka qenë 187 lëndë, në këtë periudhë raportuese është zvogëluar për 6 lëndë dhe numëron 181 lëndë.

Gjatë periudhës raportuese në Gjykatë, në regjistrin "KZH" në punë ka pasur gjithsej 683 lëndë, që është rritje prej 181 lëndëve në krahasim me vitin 2020. Prej tyre 153 lëndë janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar dhe 530 lëndë janë të reja të pranuar, që është për 84 lëndë më shumë se vitin 2020. Janë kryer gjithsej 505 lëndë, që është për 156 lëndë më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Në fund të vitit kanë mbetur 178 lëndë të pakryera, përkatësisht për 25 lëndë më shumë se në vitin 2020.

Në regjistrin "KZHM" lëndë penale në procedurën kundër të miturve, shënohet zvogëlim prej 4 lëndëve në krahasim me vitin e kaluar, përkatësisht janë pranuar 10 lëndë. Së bashku me dy lëndët që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 12 lëndë. Prej tyre 10 lëndë janë kryer dhe 2 lëndë janë bartur si të pakryera në vitin e ardhshëm.

Në regjistrin "KSZH" këshilli penal ka pasur gjithsej 198 lëndë në punë, që është rritje prej 49 lëndësh në krahasim me vitin 2020. Prej tyre 11 lëndë janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar dhe 187 janë lëndë të reja të pranuar, përkatësisht 43 lëndë më shumë se vitin 2020. Gjatë periudhës raportuese janë kryer 187 lëndë.

Në regjistrin "PRKZH" janë evidentuar 539 lëndë për kundërvajtje, përkatësisht 30 lëndë më pak se në vitin 2020. Duke marrë parasysh 20 lëndët e pakryera nga viti i kaluar gjithsej në punë ka pasur 559 lëndë, nga të cilat gjatë periudhës raportuese janë kryer 558 lëndë, përderisa 1 lëndë bartet si e pakryer në vitin në vijim, që paraqet zvogëlim prej 19 lëndëve në krahasim me vitin e kaluar.

Në regjistrin "KR" ka pasur gjithsej 60 lëndë, që paraqet rritjen prej 20 lëndësh nga viti i kaluar. Gjatë periudhës raportuese janë kryer 60 lëndë.

Gjendja sa i përket kohëzgjatjes së procedurës është si në vijim:

deri në 1 muaj janë kryer 706 lëndë apo 53,05%
prej 1 - 3 muaj janë kryer 272 lëndë apo 20,44%
prej 3 – 6 muaj janë kryer 303 lëndë apo 22,76%
mbi 6 muaj janë kryer 50 lëndë apo 3,76%

Sektori civil

Gjatë vitit raportues 2021, gjithsej në punë ka pasur 2.358 lëndë civile, nga të cilat 284 janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar dhe 2.074 janë lëndë të reja të pranuar, në mënyrë që gjykata ka kryer gjithsej 1.876 lëndë, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 482 lëndë të pakryera që janë bartur në vitin e ardhshëm.

Vëllimi i punës në periudhën raportuese është rritur për 378 lëndë dhe numëron 2.358 lëndë, që i nënshtrohet fluksit të madh të lëndëve të reja. Në fakt, sa i përket vitit të kaluar kur janë pranuar 1.720 lëndë, në vitin 2021 janë pranuar 2.074 lëndë të reja përkatësisht 364 lëndë më shumë.

Në Sektorin civil, kanë vepruar këshillat që veprojnë për lëndët e evidentuara në regjistrin GZH, TSZH dhe ROZH.

Gjendja sa i përket kohëzgjatjes së procedurës është si vijon: deri në 1 muaj janë kryer 533 lëndë apo 28,41%, prej 1-3 muaj janë kryer 693 lëndë apo 36,94%, prej 3-6 muaj janë kryer 509 lëndë apo 27,13% dhe mbi 6 muaj janë kryer 141 lëndë apo 7,52%.

Cilësia e punës në nivel të gjykatës

Sipas të dhënave nga lëndët e kthyer nga Gjykata Supreme, gjykata e ka mbajtur cilësinë e lartë të punës. Në fakt, janë kthyer 132 vendime gjyqësore nga të cilat 96 janë vendime të konfirmuara apo 2,99% nga gjithsej lëndët e kryera, 8 vendime apo 0,25% nga lëndët e kryera janë të ndryshuara dhe 28 vendime apo 0,87% nga lëndët e kryera janë të abroguara.

Gjendja me lëndët e vjetra

Si lëndë të vjetra në periudhën raportuese, gjithsej në punë ka pasur 187 lëndë, nga të cilat 12 lëndë janë bartur si lëndë të vjetra të pakryera nga viti i kaluar dhe 175 lëndë kanë qenë të reja të pranuar, përkatësisht iu ka kaluar periudha prej 6 muajve nga dita e pranimit të lëndës në Gjykatë. Prej tyre janë kryer gjithsej 166 lëndë, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 21 lëndë të vjetra të pakryera që barten për vitin e ardhshëm.

Burime njerëzore

Sipas vendimit të Këshillit gjyqësor të RMV nr. 07-1103/1 të datës 04.06.2012, funksionin e gjyqtarit në gjykatë është përcaktuar që ta kryejnë 16 gjyqtarë duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës, por gjatë vitit raportues, gjykata ka funksionuar me një përbërje jo të plotë të gjyqtarëve, në mënyrë që funksionin e gjyqtarit e kanë kryer 11 gjyqtarë përfshirë edhe kryetarin e gjykatës.

Sipas Rregullores për sistematizimin dhe organizimin e brendshëm të vendeve të punës, janë përcaktuar gjithsej 110 vende të punës për nëpunës gjyqësor dhe 10 realizues të punësuar sipas LMP, si dhe 8 polic, përkatësisht janë paraparë 128 realizues.

Deri në fund të vitit raportues, detyrat e punës i kanë realizuar 32 nëpunës gjyqësor, 2 mirëmbajtës të higjienës, 1 vozitës dhe 1 pjesëtar i policisë gjyqësore, përderisa vende të paplotësuara të punës sipas Sistematizimit numëron 91 realizues.

Duke qenë se një nëpunësi gjyqësor i është pezulluar vendi i punës për shkak të përsosmërisë profesionale deri më 11.02.2022, ndërsa në vitin 2021 tri vende të punës janë zbrazur.

Gjykata e Apelit Gostivar që të arrijë efikasitetin maksimal në punën në të gjitha sektorët dhe sferat, përkatësisht që ti realizojë në mënyrë cilësore dhe profesionale të gjitha qëllimet dhe detyrat e punës në kuadër të kompetencave të saj, nevojiten punësime të reja të kuadrit profesional, si dhe personelit administrativo – teknik dhe të pjesëtarëve të policisë gjyqësore.

Kapacitetet hapësinore

Gjykata punon në kushte dhe kapacitete hapësinore që i përmbushin nevojat, nëse merren parasysh numri i të punësuarve dhe nevojat për punësime.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE

Pikëpamjet përfundimtare për vitin 2021 dhe propozim masat që gjykata i ka ndërmarrë në periudhën raportuese, kanë dhënë rezultat por gjykata objektivisht është përballur me probleme nga aspekti i numrit të bartësve të funksionit të gjyqtarit, ngase ka punuar me një numër të vogël të gjyqtarëve prej të cilëve janë të sistematizuar.

Në periudhën raportuese, gjykata ka pasur vështirësi edhe në veprimin, lidhur me numrin e nevojshëm të paplotësuar të realizuesve në shërbimin gjyqësor, dhe që të arrihet efikasiteti maksimal në veprimin në të gjitha sektorët dhe sferat, përkatësisht t'i realizojë detyrat e punës në mënyrë cilësore dhe profesionale nevojiten punësime të reja të kuadrit profesional si dhe të personelit administrativo – teknik dhe pjesëtarëve të policisë gjyqësore.

Në fakt, duhet vazhdimisht të vazhdohet me aktivitetet për mbindërtimin e vazhdueshëm dhe përsosmërinë e teknologjisë informatike, të bëhet zëvendësimi i pajisjes së rrënuar dhe trajnimi adekuat për shfrytëzim.

Nëpunësit profesional gjatë vitit raportues kanë kontribut të veçantë në funksionimin e gjykatës përmes realizimit të detyrave të punës në mënyrë profesionale dhe të përgjegjshme, lidhur me përpunimin e vendimeve gjyqësore dhe të tjera.

Të dhënat mbi numrin e lëndëve të kryera në periudhën raportuese flasin se gjykata nuk e ka tejkaluar fluksin e lëndëve, por duke marrë parasysh faktin se në vitin e kaluar është rritur numri i lëndëve të reja të pranuar, në gjykatë duhet të optimizohet numri i gjyqtarëve me punën në fjalë.

Duke qenë se gjykata në vitin raportues nuk e ka tejkaluar fluksin e lëndëve të reja të pranuar dhe në fund të vitit ka 663 lëndë të pakryera, rezulton se është gjykatë **e pa përditësuar** për periudhën raportuese.

Sa i përket cilësisë së punës, të dhënat e treguara përmbushen me të gjitha bazat, por tregojnë edhe atë se cilësia e punës doemos të jetë vazhdimisht në vëzhgim dhe të merren masa për përmirësim.

Sidomos, cilësia paraqet imperativ në punë, nëse merren parasysht rezultatet dhe të dhënat nga puna e Gjykatave Themelore nga rajoni i apeleve. Ashtu që, gjykata do të duhet në vazhdim që të ndjek gjendjen, të tregojë dhe t'i ndihmojë gjykatat më të ulëta në pjesën e praktikës gjyqësore dhe të bëjë unifikimin në zbatimin e ligjeve.

GJYKATA THEMELORE GOSTIVAR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2021 në nivel të gjykatës ka pasur gjithsej 37242 lëndë në punë, nga të cilat 29766 janë lëndë të kryera, përderisa 7476 janë lëndë të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE, gjithsej në punë ka pasur 861 lëndë, janë kryer 854 lëndë, 7 lëndë llogariten si të pakryera.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Spektori civil

Në punë ka pasur gjithsej 15713 lëndë, nga të cilat 13250 janë të kryera, ndërsa 2463 janë të pakryera.

Cilësia e punës – Të kryera janë 1828, nga të cilat: 286 përkatësisht 15.65% janë të konfirmuara, 119 përkatësisht 6,51% janë të abroguara dhe 25 përkatësisht 1,37% janë të ndryshuara.

Spektori penal (sfera)

Në punë ka pasur gjithsej 21529 lëndë, janë kryer 16516 lëndë, ndërsa 5013 janë të pakryera.

Cilësia e punës – janë kryer 6490, nga të cilat: 223 përkatësisht 3,44 % të konfirmuara, 78 përkatësisht 1.20 % të abroguara dhe 66 përkatësisht 1,02 % janë të ndryshuara.

Cilësia e punës për të gjitha bazat

Gjithsej 8318 lëndë janë të kryera, nga të cilat: 509 përkatësisht 6,12 % janë të konfirmuara, të abroguara janë 197 përkatësisht 2,37%, të ndryshuara 91 përkatësisht 1.09%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjithsej në punë ka pasur 2574 lëndë të vjetra të pakryera, nga të cilat 1049 janë të kryera, ndërsa të pakryera mbesin 1518 lëndë.

Burime njerëzore

Në vitin 2021 gjykata ka pasur 19 gjyqtarë, 68 të punësuar në shërbimin gjyqësor, 6 të punësuar sipas LMP dhe 5 polic gjyqësor.

Për veprimin optimal të shërbimit gjyqësor në Gjykatën Themelore Gostivar gjatë vitit 2020, është dashur të realizohen më shumë punësime, për vendet e zbrazura të punës.

Kapacitetet hapësinore

Tregohet në kushtet jo adekuate hapësinore. Teknologjia informatike e vjetër përkatësisht kompjuterë, shtypës dhe skanerë. Duhet rritja e sigurimit të gjykatës, video

mbikëqyrje e modernizuar dhe përgatitja e tri sallave të gjykimit me incizim tonik

PIKËPAMJET PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Gostivar, nuk e ka tejkaluar fluksin e lëndëve dhe konsiderohet si gjykatë e pa përditësuar.

Propozim masa

Të merren masa për plotësimin e vendeve të nevojshme të punës.

Të shihet mundësia për ri pajisjen teknike të gjykatës.

Të merren masa/plan që të kapërcehet fluksi.

GJYKATA THEMELORE DIBËR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2021 në nivel të gjykatës ka pasur gjithsej 11.546 lëndë në punë, nga të cilat janë kryer 11.054 lëndë, përderisa 492 llogariten si lëndë që kanë mbetur, ndërsa 336 lëndë kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në punë ka pasur 354 lëndë, nga të cilat 352 janë të kryera, ndërsa 1 lëndë ka mbetur e pakryer.

Cilësia e punës në nivel të gjykatës

Janë kryer 1.588 lëndë, nga të cilat: 52 lëndë apo 3.27% janë të konfirmuara, 15 lëndë apo 0.94% janë të abroguara dhe 4 përkatësisht 0.25% janë të ndryshuara.

Spektori civil

Në punë ka pasur gjithsej 6.602 lëndë, nga të cilat 6.145 janë të kryera, 457 lëndë të pakryera.

Cilësia e lëndëve

Janë kryer 13 lëndë, nga të cilat: 25 lëndë apo 11.73% janë të konfirmuara, 8 përkatësisht 3.75% të abroguara dhe 2 lëndë përkatësisht 0.93 % të ndryshuara.

Spektori penal

Në punë ka pasur gjithsej 4.591 lëndë, nga të cilat 4.557 janë të kryera, 34 lëndë janë të pakryera.

Cilësia e lëndëve

Janë kryer 1.375 nga të cilat: 17 lëndë përkatësisht 1.23% të konfirmuara, 7 lëndë përkatësisht 5.09% të abroguara dhe 4 lëndë përkatësisht 0,29% të ndryshuara.

Burime njerëzore

Në periudhën raportuese funksionin e gjyqtarit e kanë realizuar kryetari i gjykatës dhe tre gjyqtarë, por më 01.03.2021, për arsyen se kryetari është emëruar drejtor i Akademisë për gjyqtarë dhe prokuror publik, vendi i gjyqtarit është lënë në pezullim. Sipas vendimit të Këshillit gjyqësor janë paraparë 5 gjyqtarë së bashku me kryetarin e gjykatës, përderisa sipas Rregullores për organizim dhe sistematizim të brendshëm të vendeve të punës janë sistematizuar 18 vende pune, për të cilat janë paraparë 52 realizues.

Në vitin 2021 me kontratë pune deri më 31.12.2021 janë angazhuar 2 realizues. Nevojitet që në vitin 2022 të plotësohen 3 vende të zbrazura në kohë të pacaktuar.

Kapacitete hapësinore

Në këtë gjykatë zbatohet AKMIS sistemi. Një sallë gjykimi është pajisur me incizimin tonik të seancave dhe e njëjta shfrytëzohet. Sa i përket teknologjisë informatike është në nivel të përmbushur.

Është formuar zyra për marrëdhënie me publikun, e cila çdo ditë realizon kontakte me qytetarë dhe palë në pikëpamjen e marrjes së informacioneve nga puna e gjykatës, por në raportin nuk është theksuar se a është përcaktuar person i obliguar për marrëdhënie me publikun.

Përgatitja e gjykatës nuk është në nivel të përmbushur, ka nevojë për rinovimin e çatisë së pjesës së vjetër të ndërtesës gjyqësore, ngase gjatë shiut pikon, ka nevojë të ndërtohet një ashensor, që personat me nevoja të posaçme të kenë qasje në sallat e gjykimit në katin e dytë dhe të ndërtohet një tualet të cilin do ta shfrytëzonin personat me nevoja të posaçme.

PIKËPAMJET PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë të dhënave rezulton se Gjykata Themelore Dibër gjatë vitit 2021 ka qenë gjykatë **e pa përditësuar**, ngase nuk ka mundur të tejkalojë fluksin e lëndëve. Në fillim të vitit 2021, kanë mbetur 336 lëndë të pakryera, ndërsa gjithsej në punë ka pasur 11.546 lëndë, nga të cilat të kryera janë 11.054 lëndë, përderisa 492 lëndë llogariten si të pakryera, ashtu që rezulton se Gjykata Themelore Dibër gjatë vitit 2021, ka qenë gjykatë e pa përditësuar ngase nuk ka arritur ta kapërcejë fluksin për 156 lëndë.

Propozim masa

Të merren masa për sigurimin e numrit të duhur të gjyqtarëve dhe plotësimin vendeve tjera të duhura të punës.

Të shikohet mundësia për ri pajisjen teknike, përkatësisht rinovimin e gjykatës,

Të mundohet të tejkalohet fluksi i lëndëve të gjitha llojet e lëndëve dhe të përmirësohet cilësia e vendimmarrjes së lëndëve.

GJYKATA THEMELORE KËRÇOVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në Gjykatën Themelore Kërçovë, nga viti i kaluar kanë mbetur gjithsej 1.669 lëndë të pakryera, janë pranuar 7.793 lëndë të reja, 293 lëndë janë përsëri të evidentuara, 4 lëndë janë gabimisht të evidentuara, përkatësisht gjithsej në punë kanë qenë 9.751 lëndë, të cilat janë përfshirë me normën orientuese.

Gjatë vitit raportues gjykata ka kryer 7.677 lëndë, ndërsa të pakryera deri në fund të vitit raportues kanë mbetur 2.074 lëndë.

Nga e theksuara rezulton se Gjykata Themelore Kërçovë nuk e ka tejkaluar fluksin e lëndëve të reja në vitin raportues dhe për 405 lëndë e ka rritur numrin e lëndëve që kanë mbetur të pakryera.

Në vitin raportues të Gjykatës Themelore Kërçovë, janë theksuar në një vëllim të madh të punës lëndët që janë dhe që nuk janë të përfshira me normën orientuese, ashtu që është konstatuar se nga viti i kaluar gjykata ka pasur në punë 2051 lëndë, janë pranuar 18.208 lëndë të reja, 293 janë përsëri të evidentuara, 4 lëndë janë gabimisht të evidentuara ose gjithsej 20.548 lëndë, nga të cilat të kryera janë 18.035 lëndë, ndërsa 2513 janë lëndë të pakryera, në mënyrë që është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 462 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në fillim të vitit raportues, gjykata nuk ka pasur lëndë që kanë mbetur të pakryera nga administrata gjyqësore, por gjatë vitit raportues janë pranuar 1003 lëndë të reja, nga të cilat 1002 lëndë janë të kryera, ndërsa një lëndë ka mbetur e pakryer.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Në fillim të vitit raportues, **sektori penal** në punë ka pasur 478 lëndë, të cilat si të pakryera janë bartur nga periudha e kaluar raportuese.

Gjatë vitit raportues janë pranuar 6.160 lëndë të reja, 66 lëndë janë përsëri të evidentuara, ndërsa 1 lëndë është gabimisht e evidentuar.

Sektori penal gjatë vitit raportues në punë ka pasur 6.703 lëndë penale, ndërsa 5949 lëndë të kryera, që do të thotë se sektori **nuk e ka tejkaluar** fluksin, ndërsa kanë mbetur të pakryera 754 lëndë.

Sa i përket cilësisë së punës të sektorit penal, të dhënat tregojnë se gjatë vitit raportues nga gjithsej 3.169 lëndët e kryera për të cilat mund të deklarohet mjet i rregullt juridik, 132 vendime apo 4,16% janë të konfirmuara, 24 vendime apo 0,75% janë të abroguara dhe 23 vendime apo 0,72% janë të ndryshuara.

Në fillim të vitit raportues, **sektori civil** ka pasur 1.191 lëndë në punë, të cilat si të pakryera janë bartur nga periudha e kaluar raportuese.

Gjatë vitit raportues janë pranuar 1.633 lëndë të reja, 227 lëndë janë përsëri të evidentuara, ndërsa 3 lëndë janë gabimisht të evidentuara, ashtu që gjithsej në punë ka pasur 3.048 lëndë civile.

Gjyqtarët e sektorit civil gjatë vitit raportues kanë kryer gjithsej 1.728 lëndë, ndërsa si të pakryera kanë mbetur 1.320 lëndë.

Nga e theksuara rezulton se sektori civil në vitin raportues **e ka tejkaluar fluksin e** lëndëve të reja.

Sa i përket cilësisë së punës në sektorin civil, të dhënat tregojnë se gjatë vitit raportues nga gjithsej 1.728 lëndët e kryera, të konfirmuara janë 212 apo 12,26% vendime, të abroguara janë 115 apo 6,65 vendime dhe të ndryshuara janë 5 apo 0,28% vendime.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në Gjykatën Themelore Kërçovë në fund të vitit raportues, kanë mbetur të pakryera 261 lëndë, nga të cilat: 23 lëndë për pronësi, 54 lëndë të vlerës së ulët, 7 lëndë jashtë kontestimore, 6 ndarje fizike, 2 KUIKP, 63 konteste pune, 17 nga marrëdhënia obliguese dhe 89 trashëgimore, që tregon se ka rritje të numrit të lëndëve të pakryera të vjetra.

Burime njerëzore

Sa i përket burimeve njerëzore, gjatë vitit raportues kanë punuar 7 gjyqtarë dhe 49 persona të personelit administrativ.

Nga tetë gjyqtarët, 1 gjyqtar ka shfrytëzuar pushim mjekësor tërë vitin, ashtu që gjykata ka punuar me 7 gjyqtarë përfshirë edhe kryetarin e gjykatës.

Gjatë vitit raportues nuk ka punësime të realizuara, ndërsa janë zbrazur 8 vende të punës të nëpunësve gjyqësor sipas bazave të ndryshme, në mënyrë që edhe më tej ka mungesë të personelit gjyqësor dhe një pjesë e konsideruar e vendeve të parapara të punës nuk janë plotësuar, dhe sidomos për administrator gjyqësor.

Kapacitetet hapësinore

Sa i përket kushteve hapësinore për punën e kësaj gjykate, sugjerohet për nevojën nga vendosja e një sistemi sportel, kërkesë kjo që është dërguar në Këshillin e Buxhetit Gjyqësor para disa viteve, por deri më tani nuk janë miratuar mjete, ndërsa ka nevojë edhe për ndërrimin e mobilieve për zyrat në të gjitha hapësitat, pasi që ekzistuesi është vjetërsuar dhe dëmtuar.

Pesë hapësirat e ndërtesës gjyqësore i shfrytëzojnë nga Prokuroria Themelore Publike dhe Avokatura e Shtetit Kërçovë, dhe nëse ka zgjidhje për lirimin e këtyre hapësirave gjendja dukshëm do të përmirësohet.

KONSTATIME PËRFUNDIMARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Kërçovë, në vitin raportues nuk e ka tejkaluar fluksin vjetor të lëndëve në nivel të gjykatës nëse merret parasysh se janë pranuar gjithsej 7.793 lëndë që përfshihen në normën orientuese, ndërsa të kryera janë gjithsej 7.677 lëndë dhe është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 405 lëndë, ashtu që konsiderohet si **gjykatë e pa përditësuar** për periudhën raportuese 2021.

Gjatë vitit raportues në Gjykatën Themelore Kërçovë është rritur numri i lëndëve të pakryera të vjetra krahasuar me vitin e kaluar.

Gjykata Themelore Kërçovë, me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat (Gazeta zyrtare e RMV numër 96/2019) bëhet fjalë për kompetencë të zgjeruar që kompetenca e paragrafëve (1) dhe (2) të nenit 31 të Ligjit për Gjykatat, e realizon edhe për rajonin e Gjykatës Themelore Dibër, ashtu që duke u nisur nga numri total i lëndëve dhe numrit ekzistues të gjyqtarëve, do të duhet që Këshilli gjyqësor të shqyrtojë mundësinë për rritjen e numrit të gjyqtarëve në mënyrë që gjykata do të mund të arrijë të jetë e përditësuar duke qenë se kjo gjykatë edhe në periudhën e kaluar raportuese nuk ka qenë në gjendje të tejkalojë fluksin e lëndëve të reja.

Gjithashtu, nevojitet që gjatë periudhës së ardhshme të plotësohen vendet e punës sipas sistematizimit, sidomos vendet profesionale të punës: këshilltar, bashkëpunëtor i lartë, bashkëpunëtor profesional, të zgjidhet çështja mbi hapësirën e gjykatës, dhe vet gjyqtarët të bëjnë përpjekje në përmirësimin e cilësisë për vendimmarrjen e lëndëve dhe të rrisin përditësimin e gjykatës si dhe t'iu japin prioritet vendimmarrjes së lëndëve të vjetra.

GJYKATA THEMELORE TETOVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata vitin e ka filluar me 2.881 lëndë, ndërsa ka pranuar 56.536 lëndë të reja. Përsëri në punë janë marrë 318 lëndë, ndërsa gabimisht janë evidentuar 5 lëndë. Nga këtu, ka pasur gjithsej 59.730 lëndë në punë, nga të cilat janë kryer 57.349 lëndë, ndërsa 2.381 lëndë kanë mbetur të pakryera. Fluksi i lëndëve në vitin vijues është tejkaluar. Numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera është zvogëluar për 500 lëndë, apo për 17,35% krahasuar me ato të vitit 2020.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore si lëndë në regjistrat adekuat është vepruar për 2.737 lëndë, janë kryer 2.736 lëndë, ndërsa procedura për 1 lëndë nuk është kryer.

Administrata gjyqësore menaxhohet nga Kryetari i gjykatës Mr. Hasan Asani.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Sektori penal

Nga viti i kaluar kanë mbetur 1.345 lëndë të pakryera. Janë pranuar 30.348 lëndë të reja, 158 lëndë janë marrë përsëri në punë, ndërsa 2 lëndë kanë qenë gabimisht të evidentuara. Gjithsej në punë ka pasur 31.849 lëndë, nga të cilat janë kryer 30.881 lëndë, përderisa të pakryera kanë mbetur 968 lëndë. Numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera është zvogëluar për 377 lëndë apo për 28,03%.

Te ky lloj i lëndëve cilësia e punës është si vijon: prej 451 lëndët ankimore, 285 lëndë apo 63,19% janë të konfirmuara, 92 lëndë apo 20,40% janë të abroguara dhe 74 lëndë apo

16,41% janë të ndryshuara. Përqindjet janë marrë në raport me numrin e 451 lëndëve ankimore.

Sektori civil

Nga viti i kaluar kanë mbetur 1.453 lëndë të pakryera. Janë pranuar 23.532 lëndë të reja dhe me 159 lëndë të marra përsëri në punë gjithsej në punë ka pasur 25.144 lëndë. Janë kryer 23.732 lëndë, përderisa 1.412 lëndë kanë mbetur të pakryera. Numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera është zvogëluar për 41 lëndë apo për 2,82%.

Te ky lloj i lëndëve cilësia e punës është si vijon: prej 429 lëndëve ankimore, 277 lëndë apo 64,57% janë të konfirmuara, 103 lëndë apo 24,01% janë të abroguara dhe 49 lëndë apo 11,42% janë të ndryshuara.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata Themelore Tetovë, në vitin 2021 ka pasur gjithsej 412 lëndë në punë. Në fund të vitit 2021 kanë mbetur 194 lëndë të pakryera, që do të thotë se numri është zvogëluar për 218 lëndë.

Burime njerëzore

Një numër i madh i vendeve të punës të parapara me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën Themelore Tetovë nuk janë plotësuar. Duke qenë se Gjykata ka pasur nevojë të jashtëzakonshme për disa vende pune janë miratuar mjete për angazhimin e përkohshëm të 11 referentëve të rinj gjyqësor dhe 3 mirëmbajtës të higjienës. Një pjesë e vendeve të punës janë plotësuar me punësimin në kohë të pacaktuar përmes ndërmarrjes së nëpunësve.

Njëkohësisht 2 personave iu është ndërprerë marrëdhënia e punës, dhe është potencuar nevoja për punësimin e realizuesve në policinë gjyqësore.

Kapacitetet hapësinore

Gjykata Themelore Tetovë nuk disponon me buxhet personal për investimin në mirëmbajtjen e ndërtesës së gjykatës, gjë kjo që bie në kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë.

Kjo gjykatë përballet me probleme rreth nxehjes (për shkak të instalimit të tërësishëm të vjetërsuar), si dhe mirëmbajtja e hapësirave të podrumit që nuk janë të rinovuar.

Ndërtesën e gjykatës të Gjykatës Themelore Tetovë e shfrytëzojnë Prokuroria Themelore Publike Tetovë, Avokatura e Shtetit Tetovë, si Shërbimi i provës, dhe sipas kësaj siç përmend edhe kryetari i gjykatës, është e domosdoshme të ndërtohet edhe një kat për të cilin është projektuar ideja, por për realizimin nevojiten mjete financiare. Është përgatitur edhe vendimi mbi idenë për ndërtimin e ashensorit në ndërtesën e gjykatës për realizimin e të cilës gjithashtu duhet të sigurohen mjete nga buxheti gjyqësor.

Në hyrjen e ndërtesës së gjykatës është vendosur detektor metali dhe detektor me rreze, që në momentin është jashtë funksionit. Janë vendosur kamera për video mbikëqyrje, ndërsa PP aparateve iu bëhet rregullisht riparimi.

Lëndët në gjykatë rruhen në dollap (metali dhe të drurit) që janë me bravë ose janë me dry, me të cilën mundësohet rruajtja e sigurt e lëndëve.

Në Gjykatën Themelore Tetovë, gjatë vitit 2021 janë realizuar 10 procedura për furnizimin publik.

Janë furnizuar rafte metali për nevojat e arkivit të gjykatës, janë ndërruar dyert e brendshme dhe është bërë lyerja e mureve të brendshme.

Sa i përket pajisjes informatike janë aktivizuar 120 njësi punuese – kompjuterë personal që janë të lidhur me rrjetin dhe kanë qasje në aplikacionet e programeve përkatës. Nevojitet ndërrimi i tërësishëm i Cat 6 rrjetit ngase e njëjta korrespondon me aplikacionet dhe pajisjen kompjuterike që përdoret. Njëkohësisht, një pjesë të rëndësishme nga pajisja informatike është e vjetër dhe e amortizuar, ndërsa propozim i njësisë së IKT është që të bëhet zëvendësimi i shtypshkronjave lokal në ato me rrjet.

Katër prej tetë sallave të gjykimit disponojnë me incizim tonik, të njëjtat janë funksionale dhe me të bëhet audio incizimi.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Tetovë është **gjykatë e përditësuar**, ngase e ka tejkuluar fluksin e lëndëve të reja dhe ka arritur të zvogëlojë numrin e lëndëve që kanë mbetur të pakryera deri në fund të vitit.

Cilësia e punës shihet edhe me përqindjen e lartë të vendimeve të konfirmuara nga gjykata e shkallës së dytë.

Duhet të sigurohen kushte hapësinore adekuate për punë.

Në periudhën e ardhshme duhet të përmirësohen kapacitetet e pajisjes informatike të gjykatës, të përmirësohet pajisja me kuadro dhe përsosmëria e vazhdueshme e të punësuarve.

Duhet të vazhdohet me punën cilësore.

GJYKATA E APELIT MANASTIR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2021, në Gjykatën e Apelit Manastir nga 25 vendet e gjyqtarëve së bashku me Kryetarin e gjykatës, kanë vepruar 18 gjyqtarë, ndërsa 1 gjyqtari edhe më tej i pushon vendi i punës, pasi që është zgjedhur për anëtar i Këshillit gjyqësor të RMV, ndërsa në muajin mars 2021 një gjyqtar ka kaluar në pension.

Në Gjykatën e Apelit Manastir, nga viti 2020 ka në mbetur 540 lëndë të pakryera. Gjatë vitit 2021 mbi të gjitha bazat janë pranuar 4703 lëndë, (7 gabimisht të evidentuara) dhe 27 përsëri në punë ose gjithsej në punë ka pasur 5263 lëndë, nga të cilat 4566 lëndë janë të kryera, ndërsa kanë mbetur të pakryera 697 lëndë.

Cilësia në nivel të gjykatës

Sipas të dhënave për lëndët e kthyer nga Gjykata Supreme e RMV, gjatë vitit 2021 janë konfirmuar gjithsej 112 lëndë apo 2,47%, janë abroguar 32 lëndë apo 0,70, të ndryshuara janë 18 lëndë apo 0,39%.

Cilësia në nivel të sektorëve

Spektori civil

Nga viti 2020 kanë mbetur të pakryera 456 lëndë. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 3217 lëndë (gjashtë gabimisht të evidentuara) dhe 18 lëndë përsëri në punë, ose gjithsej në punë ka pasur 3685 lëndë, nga të cilat 3127 janë lëndë të kryera, ndërsa kanë mbetur të pakryera 558 lëndë.

Cilësia në sektorin civil

Sipas të dhënave për lëndë të kthyer nga Gjykata Supreme e RMV, të konfirmuara janë gjithsej 91 lëndë apo 2,93%, të abroguara janë 27 lëndë apo 0,87%, ndërsa të ndryshuara janë 18 lëndë apo 0,58%.

Spektori penal

Nga viti 2020 kanë mbetur 84 lëndë të pakryera. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 1486 lëndë të reja, 1 gabimisht e evidentuar dhe 9 përsëri në punë apo gjithsej në punë ka pasur 1578 lëndë, nga të cilat 1439 lëndë janë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur 139 lëndë.

Cilësia në sektorin penal

Sipas të dhënave për lëndët e kryera nga Gjykata Supreme e RMV, gjatë vitit 2021 janë konfirmuar 21 lëndë apo 1,47%, janë abroguar 5 lëndë apo 0,35%, ndërsa të ndryshuara nuk ka.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në vitin 2021 në fund të vitit kanë mbetur 13 lëndë të vjetra, nga të cilat 7 janë penale, ndërsa 6 janë lëndë civile.

Burime njerëzore

Në fund të vitit 2021 në gjykatë janë punësuar gjithsej 63 persona, së bashku me gjyqtarët, nëpunësit gjyqësor, policinë gjyqësore dhe personelin ndihmës – teknik.

Kapacitetet hapësinore

Edhe më tej qëndron nevoja për rinovimin e zyrave gjyqësore, furnizimin me inventar, riparimin e nyjave sanitare.

Vitin e kaluar 2021 Prokuroria Themelore Publike është shpërngulur nga ndërtesa e gjykatës, por në ndërtesë edhe më tej qëndron Prokuroria e Lartë Publike.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në Gjykatën e Apelit Manastir në vitin 2021:

Në punë ka pasur gjithsej 5263 lëndë të përfshira me normën orientuese dhe 1175 lëndë nga administrata gjyqësore.

Janë kryer 4566 lëndë të përfshira me normën orientuese dhe 1171 lëndë nga administrata gjyqësore.

Në vitin 2021 nuk është tejkalluar fluksi për 137 lëndë.

Në vitin 2021 në fund të vitit kanë mbetur 13 lëndë të vjetra.

Gjykata e Apelit Manastir nuk ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve në mënyrë që konsiderohet si **gjykatë e pa përditësuar**.

Propozim masa:

Në vitin 2022 sipas sistematizimit të plotësohen të gjitha vendet e zbrazura nga kuadri profesional dhe personeli administrativo – teknik.

Plotësimi me pajisje kompjuterike, furnizimi me inventar dhe sigurimi i mjeteve për realizimin e furnizimeve publike të planifikuara.

Përforcimi i bashkëpunimit me Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe ndjekja dhe realizimi i planit për vendimmarrjen e lëndëve të vjetra të pakryera gjatë vitit 2022 në gjykatat themelore, dhe me kërkesë të gjyqtarëve nga gjykatat themelore të realizohen edhe më shumë takime pune për sugjerimin e çdo lloj ndihme.

GJYKATA THEMELORE MANASTIR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata Themelore Manastir, vitin 2021 e ka filluar me 3.702 lëndë të vjetra që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 27.542 lëndë të reja, 9 lëndë janë gabimisht të evidentuara, 305 lëndë janë përsëri në punë apo në punë ka pasur gjithsej 31.235 lëndë, nga të cilat janë kryer 26.624, ndërsa kanë mbetur të pakryera 4.611 lëndë. Fluksi nuk është tejkalluar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Administrata gjyqësore vitin 2021 e ka filluar me 21 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 1.673 lëndë, 0 lëndë gabimisht të evidentuara, ndërsa të pakryera kanë mbetur 15 lëndë. Fluksi është tejkaluar.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Nga gjithsej 26.624 lëndët e kryera, 895 lëndë janë të konfirmuara apo 3,36%, të abroguara janë 199 apo 0,45% ndërsa të ndryshuara janë 115 apo 0,43%.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Sektori penal

Sektori penal vitin 2021 e ka filluar me 1.449 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 18.401 lëndë të reja, 1 lëndë gabimisht e evidentuar, 106 lëndë përsëri në punë, dhe gjithsej në punë ka pasur 19.955 lëndë, nga të cilat janë kryer 17.677, ndërsa 2278 lëndë kanë mbetur të pakryera. Fluksi nuk është tejkaluar. Nga gjithsej 17.677 lëndët e kryera, 205 apo 1,16% janë lëndë të konfirmuara, të abroguara janë 80 apo 0,45% dhe të ndryshuara janë 50 apo 0,28%.

Sektori civil

Sektori civil vitin 2021 e ka filluar me 2.232 lëndë të vjetra të pakryera nga viti i kaluar 2020. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 7.163 lëndë të reja, 8 janë lëndë gabimisht të evidentuara, 199 lëndë përsëri në punë, dhe gjithsej në punë ka pasur 9.586 lëndë, nga të cilat 7.268 janë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur 2.318 lëndë. Fluksi është tejkaluar. Nga gjithsej 7.268 lëndët e kryera, 690 apo 9,49 % lëndë janë të konfirmuara, të abroguara janë 119 apo 1,64 % dhe të ndryshuara janë 65 apo 0,89%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata vitin 2021 e ka filluar me 104 lëndë të vjetra të pakryera dhe 71 lëndë trashëgimore te Noterët, dhe në fund të vitit 2021 numri i lëndëve të pakryera të vjetra është rritur dhe tani ka 118, ndërsa numri i lëndëve trashëgimore te Noterët është zvogëluar.

Burime njerëzore

Gjatë vitit 2021, gjykata ka punuar me 75 realizues të punësuar në kohë të pacaktuar, nga të cilët 1 administrator gjyqësor, 1 udhëheqës i sektorit të informatikës, 1 këshilltar informatikë, 9 kuadro profesionale, 3 referentë të pavarur, 12 referentë të lartë, 20 referentë gjyqësor, 18 referentë të rinj, 1 kontabilist, 1 shofer 1 arkivist, 1 shofer, 6 polic, 1 mjeshtër i përgjithshëm, 1 telefonist, 1 mbajtës të higjienës dhe 23 persona të punësuar në kohë të caktuar të kuadrove të ndryshme, që pjesërisht i përgjigjet vëllimit të punës së gjykatës. Gjykata ka emëruar një person për marrëdhënie me publikun.

Kapacitetet hapësinore

Gjykata Themelore Manastir është e përgatitur mirë nga ana e hapësirës, me një numër të konsideruar të zyrave, sallave të gjyimit dhe sporteleve, ndërsa disponon edhe me teknologji informatike në nivel të lakmueshëm, me 60 kompjuterë, shtypshkronja dhe skanerë.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë të dhënave të ekspozuara rezulton se Gjykata Themelore Manastir, gjatë vitit 2021 konsiderohet si **gjykatë e pa përditësuar**, ngase nuk e ka tejkaluar fluksin.

Propozim masa

Në periudhën e ardhshme do të duhet t'i kushtohet vëmendje të posaçme vendimmarrjes së shpejtë të lëndëve të vjetra, si dhe tejkalimin e fluksit të lëndëve të reja.

GJYKATA THEMELORE KRUSHEVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në periudhën raportuese për vitin 2021, në gjykatë kanë mbetur 241 lëndë të pakryera, ndërsa gjithsej numri i lëndëve të pranuar të reja numëron 2.074, përsëri në punë ka pasur 13 lëndë, ashtu që gjithsej numri i lëndëve në punë në vitin raportues numëron 2.328 lëndë. nga ky numër të kryera kanë qenë 2.008 lëndë, ndërsa si të pakryera kanë mbetur 320 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në Gjykatën Themelore Krushevë si lëndë që trajtohen nga sfera e administratës gjyqësore janë më shumë lloje të lëndëve të evidentuara në Regjistër edhe atë: SU-SU-07, SU-DOV, SU-STRDOV, SU-IZZ, UPP dhe SPI.

Në administratën gjyqësore nga viti i kaluar kanë mbetur 7 lëndë të pakryera, ndërsa janë pranuar 436 lëndë të reja ose gjithsej në punë ka pasur 442 lëndë, nga të cilat 435 janë lëndë të kryera, ndërsa 7 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Spektori penal:

Në Sektorin penal të Gjykatës Themelore Krushevë, gjithsej numri i lëndëve të pakryera nga viti i kaluar është 113 lëndë, ndërsa janë pranuar 894 lëndë të reja, ndërsa 8 lëndë janë përsëri në punë apo gjithsej në punë ka pasur 1.015 lëndë, nga të cilat 911 lëndë janë të kryera, ndërsa 104 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Nga gjithsej numri i 337 lëndëve ankimore- të kryera, 7 lëndë janë të konfirmuara që numëron 2,08%, 8 lëndë janë të abroguara që numëron 2,37%, 6 lëndë janë të ndryshuara që numëron 1,78%, 0 lëndë janë pjesërisht të abroguara që numëron 0% dhe 2 lëndë janë të hedhura poshtë, që numëron 0,59%.

Spektori civil

Në Sektorin civil të Gjykatës Themelore Krushevë, gjithsej numri i lëndëve të pakryera nga viti i kaluar numëron 122 lëndë, ndërsa janë pranuar 735 lëndë të reja, 5 lëndë janë përsëri në punë apo gjithsej në punë ka pasur 862 lëndë, nga të cilat 654 lëndë janë të kryera, ndërsa 208 lëndë kanë mbetur të pakryera. Nga gjithsej numri i 155 lëndëve të kryera dhe ankimore, 3 lëndë janë të konfirmuara që numëron 1,94%, 0 lëndë është e abroguar që numëron 0%, lëndë të ndryshuara nuk ka, lëndë pjesërisht të abroguara nuk ka dhe nuk ka lëndë të hedhura poshtë.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës, sipas Raportit vjetor të punës së Gjykatës Themelore Krushevë numëron edhe atë: nga gjithsej numri i 492 lëndëve të kryera dhe ankimore, 10 lëndë janë të konfirmuara që numëron 2,03%, 8 lëndë janë të abroguara që numëron 1,63%, 6 lëndë janë të ndryshuara që numëron 1,22%, nuk ka lëndë pjesërisht të abroguara dhe 2 lëndë janë të hedhura poshtë.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fund të vitit 2021, në Gjykatën Themelore Krushevë, janë evidentuar 30 lëndë të vjetra edhe atë: 26 trashëgimore nga Noterë, 1 lëndë penale për persona madhor dhe 3 lëndë për kundërvajtje.

Burime njerëzore

Gjykata Themelore Krushevë funksionin e saj në vitin 2021, e ka kryer me 16 të punësuar, nga të cilët 2 (dy) gjyqtarë, duke llogaritur edhe kryetarin e Gjykatës, një gjyqtar të deleguar dhe 14 të punësuar si personel teknik.

Sipas Sistematizimit në Gjykatën Themelore Krushevë, janë paraparë 26 vende pune pa gjyqtarët.

Gjatë periudhës raportuese edhe në periudhën e vitit të kaluar, për shkak të pensionimit të rregullt dhe raste të tjera të paplotësuara kanë mbetur 10 vende pune.

Duke marrë parasysh vëllimin e punës me prioritet është plotësimi i 3 vendeve me prioritet të punës së nëpunësve gjyqësor.

Kapacitete hapësinore

Kushtet hapësinore në Gjykatën Themelore Krushevë janë në nivel të kënaqshëm. Të gjithë të punësuarit kanë zyra përkatëse të aftësuara për punën e saj. Zyrat dhe një sallë gjykimi janë pajisur me mjete ndihmëse teknike (kompjuterë dhe shtypshkronja) që nevojiten për realizimin pa pengesë të detyrave punuese. Ndërtesa e Gjykatës Themelore Krushevë, është e siguruar me tre polic gjyqësor që punojnë në dy ndërresa. Për shkak të mos plotësimit të një vendi pune – polic gjyqësor, në ndërrimin e tretë gjykata është siguruar nga policia e rregullt. Një pjesë nga pajisja informatike që është e vjetërsuar është zëvendësuar me pajisje të re përkatësisht me kompjuterë të rinj. Momentalisht në Gjykatën Themelore Krushevë, në punë janë të aktivizuar 15 kompjuterë-stacione punuese, një tastierë serveri, në të cilën janë instaluar katër makina virtuale, 2 skanerë dhe 13 shtypshkronja lokale të laserit. Gjatë vitit 2020 është vendosur një pajisje për video – mbikëqyrje. Në vitin 2018 dhe 2019 një pjesë nga stacionet e punës që janë vjetërsuar përkatësisht në funksion nga viti 2003, janë zëvendësuar me kompjuterë të rinj. Gjykata disponon edhe me një video ekran kompjuterik në të cilin publikohen lëndët e planifikuara dhe informacione tjera të karakterit publik. Nga ana e aplikacioneve programore, në gjykatë çdo ditë shfrytëzohen si vijojnë: AKMIS – programi për evidencën komplet dhe qarkullimin e lëndëve gjyqësore, që një periudhë të caktuar ndërtohet me versione të reja nga firma EDUSOFT, AMBS programi për evidentimin komplet dhe qarkullimin e lëndëve gjyqësore, që në periudha të caktuara ndërtohet me versione të reja nga firma EDUSOFT, AMBS programi për kontabilitet, puna magazinierë dhe materiale që shfrytëzohet në tërësi dhe FEMIDA programi për incizimin tonik të seancave civile që në tërësi është në funksion dhe shfrytëzohet nga muaji maj 2013. Moduli për skanimin dhe formimin e dosjes elektronike të lëndëve shfrytëzohet tërësisht. Gjatë rrjedhjes së punës paraqiten probleme të zakonshme që sipas gjykatës deri tani korrigjohen dhe tejkalohen në kohë.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në kuptim të sipër ekspozuarës, mund të konstatohet se Gjykata Themelore Krushevë nuk ka arritur që të tejkalojë fluksin e lëndëve të pranuar të reja në vitin rrjedhës 2021, ngase 320 lëndë kanë mbetur të pakryera, duke marrë parasysh faktin që në vitin e theksuar janë pranuar 2.087 lëndë të reja, ndërsa nga viti i kaluar kanë mbetur 241 lëndë të pakryera, përkatësisht nga gjithsej numri i lëndëve të reja të pranuar dhe lëndë nga viti i kaluar, si dhe lëndë përsëri në punë që numëron gjithsej 2.087 lëndë në punë, 2.008 lëndë janë të kryera, ndërsa 320 lëndë kanë mbetur të pakryera. Sa i përket përditësimit të gjykatës konsideroj se Gjykata Themelore Krushevë, në vitin raportues është **gjykatë e pa përditësuar**.

Me plotësimin e vendeve të lira të punës të parapara me Aktin për sistematizimin e Gjykatës Themelore Krushevë dhe me tejkalimin e çështjeve të zakonshme të cilat paraqiten lidhur me teknologjinë informatike dhe burimet njerëzore, do të mund që Gjykata Themelore Krushevë në të ardhmen të jetë më efikase, më cilësore dhe të mos ketë lëndë të pakryera duke respektuar parimin e sundimit të së drejtës.

GJYKATA THEMELORE OHËR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në vitin raportues 2021 Gjykata Themelore Ohër ka pasur gjithsej 20.600 lëndë në punë, nga të cilat 4.076 lëndë janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar, 16.534 janë pranuar lëndë të reja dhe 10 lëndë të evidentuara gabimisht.

Gjatë vitit raportues nga gjithsej numri i lëndëve në punë, gjykata ka kryer 16.225 lëndë, ndërsa 4.375 lëndë kanë mbetur të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Nga viti i kaluar kanë mbetur 15 lëndë të pakryera. Gjithsej numri i lëndëve të reja të pranuar është 691. Gjithsej numri i lëndëve në punë është 706. Janë kryer gjithsej 687 lëndë. Në fund të vitit të pakryera kanë mbetur 19 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Gjatë vitit 2021, në gjykatë janë kryer 7.030 lëndë, për të cilat lejohet mjet juridik.

1.357/1.240 janë lëndë ankimore, nga të cilat 836 lëndë janë të konfirmuara, përkatësisht 67,4%, 225 lëndë përkatësisht 18,1% janë të abroguara, 117 lëndë përkatësisht 9,4% janë të ndryshuara, 42 lëndë përkatësisht 3,4% janë pjesërisht të abroguara, ndërsa 15 lëndë përkatësisht 1,2% janë të hedhura poshtë dhe 1 lëndë, përkatësisht 0,1% të tjera.

Puna me lëndët në nivel të sektorit

Spektori penal

Lëndë të pakryera nga viti i kaluar janë 1.502 lëndë. Gjithsej numri i lëndëve të pranuar të reja gjatë vitit 2021 është 10.873 lëndë, gjithsej numri i lëndëve gabimisht të evidentuara është 5. Gjithsej numri i lëndëve në punë në vitin 2021 është 12.370 lëndë. Gjithsej numri i lëndëve të kryera është 10.868. Në fund të vitit 2021 kanë mbetur 1.502 lëndë të pakryera.

Spektori civil

Lëndë të pakryera nga viti i kaluar janë 2.559 lëndë. Gjithsej numri i lëndëve të pranuar të reja gjatë vitit 2021 është 4.970, gjithsej numri i lëndëve gabimisht të evidentuara është 5. Gjithsej numri i lëndëve në punë në vitin 2021 është 7.524. Gjithsej numri i lëndëve të kryera është 4.670. Në fund të vitit 2021 kanë mbetur 2.854 lëndë të pakryera.

Cilësia e lëndëve në nivel të sektorit

Spektori penal

Gjatë vitit 2021, në sektorin janë kryer 3.495 lëndë për të cilat lejohet mjet juridik.

Janë ankimuar 463/407 lëndë, nga të cilat 259 lëndë përkatësisht 63,6% janë të konfirmuara, 90 lëndë, përkatësisht 22,1% janë të abroguara, 41 lëndë përkatësisht 10,1% janë të ndryshuara, 4 lëndë përkatësisht 1% janë pjesërisht të abroguara, ndërsa 9 lëndë përkatësisht 2,2% janë të hedhura poshtë dhe 1 lëndë përkatësisht 0,2% janë të tjera.

Spektori civil

Gjatë vitit 2021, në sektorin janë kryer 3.535 lëndë për të cilat lejohet mjet juridik.

Janë ankimuar 894/833 lëndë, nga të cilat 577 lëndë përkatësisht 69,3% janë të konfirmuara, 135 lëndë përkatësisht 16,2% janë të abroguara, 76 lëndë përkatësisht 9,1% janë të ndryshuara, 38 lëndë përkatësisht 4,6% janë pjesërisht të abroguara, ndërsa 6 lëndë përkatësisht 0,7% janë të hedhura poshtë.

Gjendja me lëndët e vjetra të pakryera

Në Gjykatën Themelore Ohër, ka gjithsej 991 lëndë të vjetra të pakryera, deri më 2019, nga të cilat 630 lëndë të vjetra janë trashëgimore, të cilat janë në punë te Noterët: konteste të vlerës së vogël 27 lëndë, konteste pune 59, konteste tregtare 3, për falimentim 2, penale ndaj personave madhor 66 lëndë, për kundërvajtje 40, VPP lëndë 94, trashëgimore 630 (në punë te Noterët), urdhërpagesa sipas kundërshtimeve 1, KUIKP 8, konteste pune 5, konteste obliguese 47, konteste familjare 1, lëndë për fyerje dhe shpifje 2, KPP 2, IKP 1, RVPP 2 dhe IPRK 1.

Sipas viteve struktura e lëndëve të vjetra të pakryera është si vijon: 1 nga viti 2008, 1 nga viti 2009, 1 nga viti 2012, 2 nga viti 2013, 24 nga viti 2014, 10 nga viti 2015, 14 nga viti 2016, 209 nga viti 2017, 336 nga viti 2018 dhe 393 lëndë të vjetra të pakryera nga viti 2019.

Burime njerëzore

Gjykata Themelore Ohër, vitin 2021 e ka përfunduar me gjithsej 80 punonjës nga të cilët 14 gjyqtarë, në mënyrë që 1 gjyqtar me gjysmë orari pune dhe kryetari i gjykatës. Gjithsej numri i gjyqtarëve sipas sistematizimit duhet të jenë 18 gjyqtarë. Gjithsej punonjës në shërbimin gjyqësor janë 65, ndërsa gjykata ka nevojë për plotësimin e 15 vendeve të punës me prioritet për nëpunësit gjyqësor të disa kategorive.

Teknologjitë informatike

Në gjykatë ka gjithsej 80 kompjuterë, që sipas karakteristikave dhe gjendjes së moshës një pjesë e konsideruar e tyre nuk i plotësojnë kërkesat themelore për realizimin më të shpejtë dhe efikase të detyrave të punës të punonjësve. Për këtë shkak nevojitet të zëvendësohen kompjuterët e vjetërsuar si dhe shtypshkronjat me minimum 10 kompjuterë të ri, si dhe me 10 shtypshkronja. Nevojitet që të ndërrohet edhe serveri që do të jetë me kapacitet më të lartë të memories që ti përmbush nevojat e gjykatës. Nevojitet që të sigurohet mbështetja e harduerit për pajisjen e incizimit tonik, si dhe përshtatjen e softuerit për incizim tonik për platformat më të reja të Windows.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Ohër, nuk e ka tejkalluar fluksin dhe konsiderohet si gjykatë e pa përditësuar.

Nevojitet që të plotësohen vendet për gjyqtarët dhe për kuadër profesional – administrativ.

GJYKATA THEMELORE PRILEP

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata Themelore Prilep vitin 2022 e ka filluar me 4876 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar. Gjatë vitit 2021 në gjykatë janë pranuar 14405 lëndë të reja për të gjitha bazat dhe së bashku me lëndët e mbetura nga viti i kaluar përfshirë edhe lëndët gabimisht të evidentuara, gjithsej në punë ka pasur 19.270 lëndë. Janë kryer gjithsej 15496 lëndë, nga të cilat 7934 lëndë civile, 7243 lëndë penale.

Sipas llojeve të lëndëve në vitin 2021 janë kryer, 2086 lëndë për kundërvajtje, 1674 lëndë penale, 1479 lëndë proceduese civile, 6333 lëndë jashtë kontestuese dhe 3228 të realizimit të sanksioneve. Fluksi i lëndëve është zvogëluar në nivel vjetor në krahasim me vitin e kaluar 2020 dhe më 31.12.2021, kanë mbetur 2.914 lëndë të pakryera, nga të cilat sipas llojeve të lëndëve, realizimi i sanksioneve 440 lëndë, penale K 570 lëndë, kontestuese

908 lëndë, lëndë jashtë kontestuese 518 lëndë dhe për kundërvajtje 1278 lëndë. Fluksi i lëndëve është tejkualuar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Gjatë vitit 2021, në gjykatë ka pasur gjithsej 19270 lëndë në punë, nga të cilat 4876 lëndë kanë mbetur të pakryera në fillim të vitit, janë pranuar 632 lëndë të reja, janë kryer 15496 lëndë, 3 774 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Spektori penal

Në këtë sektor gjykata vitin e ka filluar me 3208 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2020, nga të cilat: realizimi i sanksioneve 302 lëndë, penale të persona të mitur 36 lëndë, penale të personave madhor 632 lëndë, vlerësim i aktakuzës 4 lëndë dhe për kundërvajtje 1400 lëndë. Në vitin 2021 në këtë gjykatë janë pranuar 6366 lëndë të reja, 3 lëndë gabimisht të evidentuara, janë kryer 7243 lëndë, kanë mbetur 2328 lëndë të pakryera. Sipas numrit të lëndëve të reja të pranuar dhe lëndëve të kryera në këtë sektor për vitin 2021, është tejkualuar fluksi i lëndëve, veçanërisht të lëndët penale për persona madhor-lutje në sferën penale dhe në lëndët – veprime nga procedura e kaluar, nuk është tejkualuar fluksi i lëndëve të reja.

Spektori civil

Në Sektorin civil të gjykatës ka pasur 1664 lëndë që kanë mbetur nga viti i kaluar 2020, është zvogëluar fluksi i lëndëve të reja në krahasim me vitin e kaluar 2020 lëndë të reja të pranuar nga kjo sferë në gjykatë kanë qenë 1771 lëndë, gjithsej në punë kanë qenë 9367 lëndë, janë kryer 7934, kanë mbetur 1433 lëndë të pakryera.

Fluksi i lëndëve në nivel të gjykatës është tejkualuar, përveç në kontestet e punës, kontestet familjare, përsëritja e procedurës në lëndë kontestuese, jashtë kontestuese – vlera e vogël.

Cilësia e punës për të gjitha bazat

Gjatë vitit 2020 nga 15506 lëndët e evidentuara, (sipas të dhënave janë kryer 14.868 lëndë), të konfirmuara kanë qenë 278 apo 1,79%, të abroguara 76 lëndë apo 0,49%, të ndryshuara 52 lëndë apo 0,03% dhe të hedhura poshtë – 3 lëndë apo 0,01%.

Cilësia e punës në Sektorin penal – Gjatë vitit 2021 nga 714 lëndët e kryera penale, të konfirmuara kanë qenë 105 apo 14,7%, të abroguara 25 lëndë apo 3,5%, të ndryshuara 39 lëndë apo 5,4%, pjesërisht të abroguara 1 apo 0,14%, të hedhura poshtë – 2 lëndë apo 0,28% dhe të tjera 2 apo 0,28%.

Në nivel të njësisë për kundërvajtje nga 2086 lëndët e kryera, 34 lëndë janë të konfirmuara apo 1,62%, 8 lëndë janë të abroguara apo 0,38% dhe 7 lëndë janë të ndryshuara apo 0,33%.

Në këtë sektor gjyqtarët kanë realizuar më shumë se norma orientuese.

Cilësia e punës në Sektorin civil – Nga gjithsej 1622 lëndët e kryera, të konfirmuara janë 196 apo 12,8%, të abroguara janë 81 lëndë apo 4,9%, të ndryshuara janë 53 lëndë apo 3,2%. Vërehet një numër i madh i vendimeve të abroguara dhe të ndryshuara në krahasim me vitin e kaluar.

Në këtë sektor gjyqtarët kanë realizuar më shumë se norma e paraparë orientuese mbi të gjitha lëndët.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata vitin 2021 e ka përfunduar me gjithsej 267 lëndë të vjetra edhe atë në sferën penale gjithsej 204 lëndë, nga të cilat 1 lëndë nga viti 2013, 2 lëndë nga viti 2014, 7 lëndë nga viti 2016, 20 lëndë nga viti 2017, 57 nga viti 2018, 112 nga viti 2019 dhe 5 nga viti 2020.

Në sektorin civil më 31.12.2021 kanë mbetur gjithsej 63 lëndë, nga të cilat 1 lëndë nga viti 2015, 1 lëndë nga viti 2017, 6 lëndë nga viti 2018 dhe 55 lëndë nga viti 2019.

Burime njerëzore

Në Gjykatën Themelore Prilep në vitin 2021, funksionin e gjyqtarit e kanë kryer 13 gjyqtarë, 6 gjyqtarë në sektorin penal dhe 7 gjyqtarë në Sektorin civil, në mënyrë që një gjyqtar nga Sektori civil me kërkesën e tij është shkarkuar nga funksioni i gjyqtarit me vendim të Këshillit gjyqësor të RMV, që në krahasim me vitin e kaluar 2020 është zvogëlim i numrit të gjyqtarëve, për një gjyqtar.

Gjatë vitit 2021 në gjykatë janë plotësuar 16 vende pune të kategorive të ndryshme të nëpunësve gjyqësor.

Kapacitete hapësinore

Gjykata Themelore Prilep ka kapacitete të mira hapësinore. Disponon me një numër të mjaftueshëm të pajisjes kompjuterike për nëpunësit gjyqësor. Për përmirësimin e gjendjes së sigurisë të punonjësve dhe palëve, gjykata vlerëson se ka nevojë për modernizimin e pajisjes për video mbikëqyrje në ndërtesën e gjykatës, që në një pjesë është e vjetërsuar dhe jo funksionare.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në krahasim me vitin e kaluar raportues 2020 kur kjo gjykatë ka qenë jo përditësuar, në vitin 2021, duke marrë parasysh se fluksi i lëndëve në nivel të gjykatës është tejkaluar, Gjykata Themelore Prilep është **gjykatë e përditësuar**.

Propozim masa:

Për përmirësimin e gjendjes në gjykatë sa i përket lëndëve të vjetra të pakryera sidomos në sektorin penal, nevojitet që ti kushtohet vëmendje të madhe dhe angazhim gjyqtarëve në përfundimin e atyre lëndëve, njëkohësisht të plotësohen vendet e zbrazura të gjyqtarëve dhe të përmirësohet gjendja me pajisjen për video mbikëqyrjen e gjykatës.

GJYKATA THEMELORE RESNJË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2021 në nivel të gjykatës në punë ka pasur gjithsej 4995 lëndë, nga të cilat janë kryer 4503 lëndë, ndonëse 492 udhëhiqen si të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Gjithsej në punë ka pasur 842 lëndë, janë kryer 836 lëndë, ndërsa 6 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Sektori civil

Në punë ka pasur gjithsej 2062 lëndë, nga të cilat janë kryer 1823, të pakryera janë 239 lëndë.

Cilësia e punës

Të kryera kanë qenë 451 lëndë, nga të cilat: 28 lëndë përkatësisht 6,21% janë të konfirmuara, 12 lëndë përkatësisht 2,66% janë të abroguara, 5 lëndë përkatësisht 1.11% janë të ndryshuara.

Sektori penal

Në punë ka pasur gjithsej 2933 lëndë, nga të cilat 2680 janë të kryera, ndërsa 253

lëndë kanë mbetur të pakryera.

Cilësia e punës

Janë kryer 1098 lëndë, nga të cilat 32 përkatësisht 2,91% janë të konfirmuara, 8 përkatësisht 0,73% janë të abroguara dhe 7 përkatësisht 0,64% janë lëndë të ndryshuara.

Cilësia e punës për të gjitha bazat

Gjithsej 1549 lëndë të kryera nga të cilat: 60 lëndë janë të konfirmuara përkatësisht 3,87%, 20 lëndë të abroguara përkatësisht 1,29%, 12 të ndryshuara përkatësisht 0,77%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjithsej në punë ka 35 lëndë të pakryera, nga të cilat 29 përkatësisht 82,86%, janë të kryera, kanë mbetur 6 lëndë të pakryera përkatësisht 17,14%.

Burime njerëzore

Në vitin 2021 gjykata ka pasur 3 gjyqtarë, 1 bashkëpunëtor të ri gjyqësor, 4 referentë gjyqësor në sportele, 1 përkthyes, 1 arkëtar, 3 daktilografistë, 1 informatist, 1 ekonom që punon edhe si vozitës, 1 mjeshtër i përgjithshëm, 1 dorëzues, 4 polic gjyqësor dhe 1 mirëmbajtës të higjienës.

Gjatë vitit 2021 nuk është plotësuar një vend i zbrazur gjyqtari dhe nuk janë realizuar punësime të reja.

Kapacitete hapësinore

Nuk janë theksuar vërejtje për kushtet hapësinore, pas kësaj tregohet për nevojën për ri pajisjen e gjykatës në aspektin e teknologjisë informatike dhe teknologjisë tjetër.

KONSTATIME PËRFUNDMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Resnjë e ka tejkalluar fluksin e lëndëve dhe konsiderohet si gjykatë e përditësuar.

Propozim masa

Të merren masa për plotësimin e vendit të zbrazur të gjyqtarit.

Të shihet mundësia për ri pajisjen teknike të gjykatës.

Të mbahet vazhdimësia përkatësisht dinamika e punës.

GJYKATA THEMELORE STRUGË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata vitin e ka filluar me 2696 lëndë. Në punë ka pranuar 16058 lëndë të reja dhe me 122 lëndë përsëri të marra në punë, si dhe 9 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej në punë ka pasur 18867 lëndë. Prej tyre ka kryer 15270 lëndë dhe kanë mbetur 3597 lëndë të pakryera. Fluksi i lëndëve nuk është tejkalluar dhe është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur për 901 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore si lëndë në regjistrat përkatës ka vepruar për 2139 lëndë dhe të gjitha lëndët janë të kryera.

Administrata gjyqësore menaxhohet nga Kryetari i gjykatës Ifet Ibraimoski.

Në vitin raportues gjykata ka pasur administrator gjyqësor dhe obligimet që sipas Ligjit për shërbimin gjyqësor janë në kompetencë të tij i ka realizuar ai person.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Sektori penal

Nga viti i kaluar kanë mbetur 1157 lëndë të pakryera. Janë pranuar 8109 lëndë të reja dhe me 53 lëndë që janë marrë përsëri në punë, si dhe me 6 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej në punë ka pasur 9313 lëndë. Nga ato të kryera janë 7290 lëndë dhe kanë mbetur 2023 lëndë të pakryera. Është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 866 lëndë.

Cilësia e punës në Sektorin penal

Nga 7290 lëndët e kryera, janë ankimuar 177 lëndë. Prej 125 lëndët ankimore apo 70,62% janë të konfirmuara, 42 lëndë apo 23,73% janë të abroguara dhe 10 lëndë apo 5,65% janë të ndryshuara.

Sektorin civil

Nga viti i kaluar ka pasur 1539 lëndë të pakryera. Janë pranuar 5810 lëndë të reja dhe me 69 lëndë të marra përsëri në punë, si dhe 3 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej në punë ka pasur 7415 lëndë. Prej tyre 5841 lëndë janë kryer ndërsa të pakryera kanë mbetur 1574 lëndë. Është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 33 lëndë.

Cilësia e punës në Sektorin civil

Prej 5841 lëndët e kryera, ankimore janë 258 lëndë. Prej 193 lëndët ankimore apo 74,81% janë të konfirmuara, 45 lëndë apo 17,44 janë të abroguara dhe 20 lëndë apo 7,75% janë të ndryshuara.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fillim të vitit 2021, Gjykata Themelore Strugë ka pasur 77 lëndë të vjetra prej 2 vitesh në punë. Në fund të vitit 2021, në punë kanë mbetur 92 lëndë të vjetra, që do të thotë se numri është rritur për 15 lëndë.

Burimet njerëzore

Sipas sistematizimit në Gjykatën Themelore Strugë duhet të sistemohen 15 gjyqtarë, por gjatë vitit raportues 2021 funksionin e gjyqtarit e kanë ushtruar 8 gjyqtarë së bashku me Kryetarin e gjykatës.

Sipas Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Strugë, janë paraparë 120 vende pune nga të cilat 49 janë plotësuar.

Kapacitete hapësinore

Ndërtesa e gjykatës është relativisht e re dhe është ri ndërtuar dhe rinovuar, është furnizuar me mobilie të reja për të gjitha hapësirat. Janë të pajisura dy salla gjykimi me pajisje për incizim tonik.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Për punën e gjykatës mund të përfundohet si në vazhdim:

Nga aspekti i punës me lëndët, Gjykata Themelore Strugë është **gjykatë e pa përditësuar**. Fluksi i lëndëve nuk është tejkuluar, ndërsa është rritur numri i lëndëve të mbetura për 901 lëndë.

Cilësia e punës dallohet edhe me përqindjen e lartë të vendimeve jo ankimore dhe puna cilësore në raport me gjithsej lëndët e kryera.

Kushtet hapësinore dhe gjendja me pajisje sigurie dhe informatike janë të kënaqshme.

Në periudhën e ardhshme duhet të përmirësohen kapacitetet e pajisjes informatike të gjykatës dhe të përmirësohet gjendja me kuadro të administratës gjyqësore dhe policisë gjyqësore.

Nevojitet të vazhdohet me punën cilësore.

GJYKATA E APELIT SH TIP

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata e Apelit Shtip, vitin 2021 e ka filluar me 161 lëndë të pakryera nga viti i kaluar, ndërsa gjatë vitit në punë ka pranuar 2823 lëndë të reja, ashtu që në punë ka pasur gjithsej 2984 lëndë. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë janë kryer 2532 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 452 lëndë.

Në vitin raportues numri i lëndëve të reja të pranuar në krahasim me vitin e kaluar 2020 është më i madh për 250 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në vitin 2021, nga administrata gjyqësore është vepruar për lëndë të evidentuara në regjistrat përkatës edhe atë për gjithsej 1 567 lëndë dhe të gjitha janë kryer gjatë vitit raportues.

Me bazë të njoftimeve të ndryshme në administratën gjyqësore kanë arritur 1253 lëndë, më tej në regjistrin e besueshëm janë evidentuar 14 lëndë, në regjistrin për evidencë të parashtrësive dhe ankesave janë evidentuar 41 parashtrësia, 246 kërkesa për përjashtim të gjyqtarëve dhe të kryetarit dhe 13 kërkesa për qasje të lirë në informacionet.

Gjatë vitit 2021, pas miratimit të mjeteve nga Këshilli i buxhetit gjyqësor të RMV, nga Gjykata e Apelit Shtip, është përpiluar plani vjetor për furnizime publike sipas të cilit janë paparaparë dhe realizuar 3 furnizime publike.

Për shkak të pandemisë së KOVID 19, një pjesë e gjyqtarëve dhe administratës kanë munguar për shkak të pushimit mjekësor, ndërsa një periudhë gjykata ka punuar me orar të shkurtuar pune deri në orën 14,00.

Gjatë vitit, kryetari i Gj.A. Shtip së bashku me gjyqtarët e të dyja sektorëve me orar të përgatitur paraprakisht, kanë vizituar të gjitha gjykatat themelore të rajonit të apelit të kësaj gjykate, në mënyrë që janë përgatitur edhe raporte të posaçme, në të cilat janë konstatuar gjendjet me menaxhimin dhe qarkullimin e lëndëve në këto gjykata, kushtet me kuadro dhe kushtet hapësinore të punës, si dhe nevojat informatike të gjykatave dhe gjyqtarëve.

Përmes zyrës për marrëdhënie me publikun, kjo gjykatë në vitin 2021 ka pranuar 897 parashtrësia me shkrim. Janë pranuar 13 kërkesa për informacion me karakter publik, nga të cilat 9 janë të aprovuara dhe është dhënë informacioni i kërkuar, ndërsa 4 kërkesa janë refuzuar pasi që është vlerësuar se informacioni i kërkuar nuk është informacion me karakter publik.

Krahas kësaj, në ueb faqen e gjykatës rregullisht janë publikuar edhe informacione për publikun dhe raporte mujore dhe periodike mbi punën e gjykatës, njoftime, konkurse, buletine. Në vitin raportues janë publikuar 2473 vendime.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Puna në sektorë

Gjykata e Apelit Shtip është themeluar për gjykatat themelore Berovë, Vinicë, Dellçevë, Koçan, Radovish, Sveti Nikollë, Strumicë dhe Shtip. Puna e Gjykatës së Apelit Shtip është e organizuar në dy sektorë, përkatësisht në Sektorin penal dhe Sektorin civil.

Në vitin raportues 2021, kjo gjykatë në punë ka pasur gjithsej 2984 lëndë, nga të cilat ka arritur të kryejë 2532 lëndë apo gjithsej 84,85% nga gjithsej numri i lëndëve në punë. Të pakryera kanë mbetur 452 lëndë apo 15,15% nga gjithsej numri i lëndëve.

Gjendja me punën e lëndëve në sektorë është si në vijim:

Në Sektorin penal, nga viti i kaluar ka pasur mbetje prej 18 lëndëve të shkallës së dytë penale dhe për kundërvajtje të evidentuara si KZH, 4 lëndë për këshillin penal të shkallës së dytë KSZH, 3 lëndë për kundërvajtje të shkallës së dytë PRKZH apo gjithsej 25 lëndë të pakryera, me të cilat ka filluar viti raportues. Më tutje, 7 lëndë përsëri në punë dhe të evidentuara si lëndë penale të shkallës së dytë, 1 lëndë gabimisht e evidentuar si lëndë për kundërvajtje e shkallës së dytë. Janë pranuar 398 lëndë penale dhe për kundërvajtje të shkallës së dytë në procedurë kundër të miturve KZHM, 153 lëndë për këshillin penal të shkallës së dytë KSZH, 389 lëndë për kundërvajtje të shkallës së dytë PRKZH dhe 12 lëndë të evidentuara në regjistrin si lëndë penale të ndryshme.

Gjykata në vitin raportues në sektorin penal gjithsej në punë ka pasur 990 lëndë, nga të cilat ka kryer 956 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 34 lëndë, përkatësisht sektori penal ka arritur të kryejë 96,6% nga gjithsej numri i lëndëve, ndërsa në punë kanë mbetur gjithsej 3,4% lëndë nga gjithsej numri i lëndëve.

Në Sektorin civil, nga viti i kaluar kanë mbetur prej 91 lëndëve civile GZH, 21 lëndë të shkallës së dytë nga kontestet për marrëdhënie pune ROZH, 24 lëndë të shkallës së dytë të kontesteve tregtare TSZH, ose gjithsej nga viti i kaluar kanë mbetur 136 lëndë me të cilat ka filluar viti raportues. Lëndë të reja të pranuar gjatë vitit ka pasur 833 lëndë civile të shkallës së dytë GZH, 686 lëndë të shkallës së dytë lëndë të kontesteve të punës ROZH, 279 lëndë të shkallës së dytë të kontesteve tregtare TSZH dhe 35 lëndë të ndryshme civile R apo gjithsej në sektorin civil nga viti i kaluar kanë mbetur 136 lëndë, me të cilat ka filluar viti raportues.

Gjykata, në vitin raportues në sektorin civil në punë ka pasur gjithsej 1994 lëndë, nga të cilat ka arritur të kryejë 1576 lëndë ndërsa kanë mbetur 418 lëndë të pakryera, përkatësisht sektori civil ka arritur të kryejë 79% nga gjithsej numri i lëndëve në punë në këtë sektor, ndërsa kanë mbetur 21% lëndë të pakryera nga gjithsej numri i lëndëve që kanë qenë në punë.

Cilësia e punës në sektorët

Gjendja me cilësinë e vendimeve të sjella është treguar në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve të kryera.

Në Sektorin penal nga gjithsej numri i 956 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 24 lëndë apo 2,51%, të abroguara janë 5 lëndë apo 0,52%, të ndryshuara janë 1 lëndë apo 0,10% dhe të hedhura poshtë janë 10 apo 1,05%.

Në Sektorin civil nga gjithsej 1.576 lëndët e kryera, të konfirmuara janë 61 lëndë apo 3,87%, të abroguara janë 18 lëndë apo 1,14%, të ndryshuara janë 4 lëndë apo 0,25% dhe të hedhura poshtë janë 19 apo 1,21%.

Këto përqindje çojnë në përfundimin se gjykata në vitin raportues ka pasur cilësi të lartë të lëndëve të kryera.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fund të vitit raportues 2021, gjendja me lëndët e vjetra të pakryera sipas vitit të pranimit në Gjykatën e Apelit Shtip është si në vijim:

KZH – kanë mbetur 12 lëndë të pakryera: (1 lëndë nga viti 2011, 1 lëndë nga viti 2015, 4 lëndë nga viti 2017, 1 lëndë nga viti 2018 dhe 5 lëndë nga viti 2019);

GZH – kanë mbetur 66 lëndë të pakryera: (1 lëndë nga viti 2010, 1 lëndë nga viti 2011, 1 lëndë nga viti 2012, 1 lëndë nga viti 2013, 1 lëndë nga viti 2015, 1 lëndë nga viti 2016, 3 lëndë nga viti 2017, 12 lëndë nga viti 2018 dhe 45 lëndë nga viti 2019);

TSZH – kanë mbetur 16 lëndë të pakryera: (1 lëndë nga viti 2014, 1 lëndë nga viti 2017, 5 lëndë nga viti 2018 dhe 9 lëndë nga viti 2019);

ROZH – kanë mbetur 5 lëndë të pakryera nga viti 2019.

Konstatime të shkurtra mbi kushtet e punës lidhur me burimet njerëzore, përgatitjen e gjykatës dhe kapacitetet hapësinore

Gjatë vitit 2021, Gjykata e Apelit Shtip ka pasur 53 punonjës, nga të cilët 11 gjyqtarë së bashku me kryetarin e gjykatës, 34 nëpunës gjyqësor, 6 pjesëtarë të policisë gjyqësore dhe 2 mirëmbajtëse të higjienës.

Gjykata deri më 14.07.2021 ka punuar me 11 gjyqtarë duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës, i cili ka kryesuar me të dy këshillat penale dhe ka qenë anëtarë në të dy këshillat civile. Në datën e sipër cekur, gjykata ka punuar me 9 gjyqtarë ngase me Vendim të Këshillit gjyqësor të RMV, dy gjyqtarë nga materia civile janë larguar nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës. Kjo ka imponuar që në gjykatë të formohet vetëm një këshill civil në vend të dy, që ka sjellë në mbetjen e 452 lëndëve, nga të cilat 418 nga materia civile dhe 34 nga materia penale. Krahas gjendjeve të theksuara të datës 13.07.2016 është zgjedhur për Kryetar të GjTh Vinicë, ndërsa kryetari i mëparshëm i gjykatës në vitin 2020, është zgjedhur për gjyqtar në Gjykatën Supreme dhe vendi i tij ka mbetur i paplotësuar. Të gjitha faktorët e theksuar kanë ndikuar që viti raportues të përfundojë me një numër të konsideruar të lëndëve të mbetura nga viti i kaluar.

Kapacitetet hapësinore të ndërtesës së Gjykatës së Apelit Shtip në parim i përmbushin nevojat e kushteve për realizimin e detyrave të punës, përveç që ka një mungesë të hapësirave për vendosjen më të përshtatshme të këshilltarëve gjyqësor dhe bashkëpunëtorët si dhe procesmbajtësit. Vlerësimi është se kjo gjendje mund të tejkalohet vetëm në qoftë se Prokuroria Themelore e Lartë që është e vendosur në ndërtesën e gjykatës të zhvendoset në ndërtesë tjetër. Hapësirat në të cilat janë vendosur gjyqtarët dhe nëpunësit gjyqësor janë të pajisura me mobilie të duhura dhe me pajisje informatike, çdo gjyqtarë ka kompjuterin e tij dhe qasje në AKMIS dhe në internet. Gjykata disponon me tri salla gjykimi prej të cilave njëra është me sistem të incizimit tonik dhe ato në tërësi i përmbushin nevojat e gjykatës. Sa i përket nevojës për përdorimin dhe zbatimin e sistemit informativ i njëjti në tërësi është funksional. Gjatë vitit 2021 është bërë një zëvendësim i 40 kompjuterëve me të rinj, janë siguruar edhe 15 dëgjuese dhe 5 ueb kamera për ndjekjen e trajnimeve përmes internetit.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata e Apelit Shtip, në vitin 2021 me numrin e rritur të vëllimit të punës dhe numrin e zvogëluar të gjyqtarëve ka punuar si **gjykatë e pa përditësuar**. Nga të dhënat tregues për gjendjen me lëndët konstatohet se gjykata nuk ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve të reja dhe të zvogëlojë mbetjen nga viti i kaluar ngase numri i lëndëve të pakryera është rritur për 291 lëndë. Gjatë vitit raportues janë pranuar gjithsej 2823 lëndë (në krahasim me vitin 2020 kur janë pranuar 2.573 lëndë), dhe së bashku me 161 lëndët nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 2.984 lëndë, nga të cilat 2532 gjithsej të kryera, ndërsa 452 lëndë kanë mbetur të pakryera. Kjo i dedikohet numrit dukshëm të zvogëluar të gjyqtarëve në krahasim me vitin e kaluar, të cilët edhe pse janë angazhuar maksimalisht nuk ka qenë e mundshme të tejkalojnë fluksin në tërësi.

Gjithsej numri i lëndëve të pakryera që kanë mbetur në fund të vitit 2021, 452 lënë për të gjitha bazat, sipas mesatares së gjithsej 2.532 lëndëve të kryera në vitin raportues, mund të kryhet për dy muaj. Cilësia e vendimeve të sjella edhe në dy sektorët është në nivel të lartë.

Gjatë vitit 2021 nevojitet që gjyqtarët të mbajnë përditësimin e gjykatës dhe ti kryejnë lëndët e vjetra, sidomos lëndët që janë të viteve më të vjetra. Megjithatë për më shumë përditësim të gjykatës është e domosdoshme që në gjykatë të zgjedhën së paku 4 gjyqtarë të rinj.

Gjykata ka nevojë për disa bashkëpunëtorë profesional, ngase edhe pse me sistematizimin janë paraparë 8 bashkëpunëtorë profesional, janë plotësuar vetëm dy vende.

Për shkak se nga viti 2020, përmes transferimit të përhershëm Këshilli gjyqësor e ka transferuar referentin e lartë gjyqësor koordinator i shërbimit teknik – vozitës, ai vend ka mbetur i paplotësuar. Gjykata e Apelit Shtip, ka nevojë për të plotësuar atë vend pune për funksionimin me kohë të punëve teknike.

Gjykata e Apelit Shtip ka nevojë për serverë të rinj dhe modernizimin e vazhdueshëm të pajisjes informatike.

GJYKATA THEMELORE BEROVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATË

Në Gjykatën Themelore Berovë, nga viti i kaluar 2020 të pakryera kanë mbetur gjithsej 658 lëndë, ndërsa gjatë vitit 2021 janë pranuar 3772 lëndë të reja, 40 lëndë përsëri në punë, 1 lëndë gabimisht të evidentuara, ashtu që gjithsej numri i lëndëve në punë gjatë vitit 2021 ka qenë 3611, ndërsa 858 lëndë kanë mbetur të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në punën e administratës gjyqësore, lëndë të pakryera në fillim të vitit nuk ka, gjatë vitit 2021 janë pranuar 646 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara nuk ka. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë, janë kryer 645 lëndë, ndërsa ka mbetur e pakryer vetëm 1 lëndë.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Në **Sektorin penal** të Gjykatës Themelore Berovë, nga viti i kaluar kanë mbetur 210 lëndë të pakryera, gjatë vitit 2021 janë pranuar 1353 lëndë të reja të këtij lloji dhe 21 lëndë përsëri në punë, ndërsa gabimisht të evidentuara nuk ka. Gjithsej numri i lëndëve në Sektorin penal në vitin raportues 2021 ka qenë 1584, nga të cilët gjatë vitit 2021 janë kryer 1209 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 375 lëndë.

Në **Sektorin civil** të Gjykatës Themelore Berovë, nga viti i kaluar kanë mbetur 155 lëndë të pakryera, ndërsa lëndë të reja të këtij lloji janë pranuar 203 lëndë, përsëri në punë ka pasur 19 lëndë, ndërsa 1 lëndë ka qenë gabimisht e evidentuar. Gjithsej numri i lëndëve në Sektorin civil, në vitin raportues 2021 ka qenë 376 lëndë, nga të cilat janë kryer 208 lëndë dhe kanë mbetur 168 lëndë të pakryera.

Cilësia e lëndëve në nivel të Sektorëve në punën sipas raportit të dorëzuar është shprehur në mënyrën si vijon:

Në Sektorin penal nga gjithsej 752 lëndët e kryera, vendimet janë të konfirmuara në 7 lëndë apo 50%, të abroguara 3 lëndë apo 21,43%, ndërsa të ndryshuara 4 lëndë apo 28,53%.

Në Sektorin civil, nga gjithsej 208 lëndët e kryera, vendimet janë konfirmuar në 37 lëndë apo 67,27%, të abroguara 14 lëndë apo 25,45%, ndërsa të ndryshuara janë 4 lëndë apo 7,28%.

Në Sektorin për kundërvajtje nga gjithsej 457 lëndët e kryera, vendimet janë konfirmuar në 9 lëndë apo 75%, të abroguara 2 lëndë apo 16,66%, ndërsa të ndryshuara kanë qenë 3 lëndë apo 8,33%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në Gjykatën Themelore Berovë në vitin e kaluar 2021 janë evidentuar 21 lëndë të vjetra dhe atë për shkak të ndryshimeve të kuadrit për arsye të pensionimit dhe kohën ndryshe të gjyqtarëve të depërtuar nga gjykatat tjera, të cilët përkohësisht procedojnë në punën e gjykatës, ndërsa lëndët i shpërndahen një gjyqtari tjetër. Pastaj, duhet kohë për marrjen në punë të lëndës për shkak ndryshimit të përbërjes së gjykatës. Sa i përket vendimmarrjes së tyre, gjykata ka përgatitur plan që realizohet me sukses.

Burime njerëzore

Në vitin raportues 2021, në Gjykatën Themelore Berovë, është vërejtur një problem në di proporcionin sa i përket detyrave të besuara të punës në vendet e punës me shkallë të

lartë të vendit të punonjësve të pensionuar që i zëvendësojnë, ndërsa paga nuk është e përshtatur për shkak të mospagimit të mjeteve financiare. Gjithashtu, ka mungesë të regjistruarëve dhe daktilografistëve.

Kapacitete hapësinore

Kapacitetet hapësinore të Gjykatës Themelore Berovë pjesërisht i përmbushin nevojat për realizimin e punëve nga sfera e ofrimit të ndihmës juridike të qytetarëve. Gjendja e ndërtesës është relativisht funksionare, në përdorim është vetëm një sallë gjykimi, ashtu që në të ardhmen një pjesë e hapësirave duhet të dedikohen dhe të vihen në funksion për të paktën edhe një sallë gjykimi, ndërsa punën normale të gjyqtarëve, sidomos në periudhën kur edhe më tej për shkak të pandemisë nga Kovid-19 nevojitet që të përmirësohen kushtet gjatë gjykimit, përkatësisht gjatë kontakteve me palët, si dhe gjatë rrjedhjes së gjykimit. Nevojitet përmirësimi i disa pozicioneve ndërtimore që nuk janë ri konstruktuar më shumë se 40 vite edhe atë dyshemetë në realizim të dyshemesë "perlit" me syntelon në gjendje jashtëzakonisht të keqe. Gjithashtu, në gjendje të keqe janë edhe pllakat e dyshemesë qeramike. Gjithashtu, në gjendje të keqe janë edhe pllakat e dyshemesë qeramike të korridorit të përdhësës dhe të katit, dhe njëkohësisht, lajmërohet problemi edhe në konstruksionin e çatisë, që është nga metali dhe në disa vende rrjedh dhe i duhet riparim në afat mundësisht të shkurtër.

Një pjesë e teknologjisë informatike është vjetërsuar. Duhet furnizimi i 3 kompjuterëve personal dhe një aparat për fotokopjim.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Berovë, gjatë vitit 2021 nuk e ka zgjidhur fluksin e lëndëve në Sektorin civil, pasi që në këtë sektor në fillim të vitit ka pasur 155 lëndë të pakryera, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 168 lëndë të pakryera. Gjithashtu, gjykata nuk ka zgjidhur fluksin as në Sektorin penal, ngase në këtë sektor në fillim të vitit ka pasur 210 lëndë të pakryera, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 375 lëndë të pakryera.

Duke marrë parasysh se gjatë vitit 2021, Gjykata Themelore Berovë në fillim të vitit ka pasur gjithsej 658 lëndë të pakryera, ndërsa në fund të vitit nga gjithsej numri i lëndëve në punë kanë mbetur 858 lëndë të pakryera, rezulton se Gjykata Themelore Berovë nuk e ka tejkalluar fluksin e lëndëve, në mënyrë që mund të konstatohet se është **gjykatë e pa përditësuar**.

Sa i përket cilësisë së lëndëve të kryera në nivel të sektorit, në Sektorin penal vërehet rritja e cilësisë së lëndëve të konfirmuara dhe numri i zvogëluar i lëndëve të abroguara, por ka edhe disa rënie të cilësisë me një rritje të lehtë në përqindjen e lëndëve të abroguara dhe të ndryshuara nga viti i kaluar 2020, prej ku edhe rezulton se gjykata në vitin e ardhshëm duhet të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së lëndëve të konfirmuara dhe numër të ulët të lëndëve të abroguara dhe të ndryshuara.

Kapacitetet hapësinore i përmbushin nevojat për realizimin e punëve nga sfera e ofrimit të ndihmës juridike për qytetarët. Gjykata ballafaqohet edhe këtë vit me probleme dhe i nevojitet rregullimi i dyshemeve të zyrave dhe korridoreve, rregullimi i brendshëm i gjykatës dhe riparimi i konstruksionit të çatisë.

Teknologjia informatike në një pjesë është vjetërsuar dhe i nevojitet furnizimi me kompjuterë të rinj, printerë dhe aparate kopjimi.

Sa i përket burimeve njerëzore ka një problem në di proporcionin në raport me detyrat e besueshme të punës në vendet e punës me shkallë më të lartë të vendit të punonjësve të pensionuar të cilët i zëvendësojnë, por gjithashtu, nevojiten edhe regjistruarët të rinj dhe daktilografistët.

GJYKATA THEMELORE VINIÇË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në Gjykatën Themelore Viniçë kanë mbetur 483 lëndë të pakryera nga viti i kaluar 2020, në vitin 2021 janë pranuar 4315 lëndë të reja, përsëri në punë kanë qenë 28 lëndë apo gjykata ka pasur në punë gjithsej 4826 lëndë. Krahasuar me vitin 2020, Gjykata ka pasur në punë 1359 lëndë më shumë – të normuara dhe të pa normuara. Janë kryer gjithsej 4 122 lëndë, 703 lëndë kanë mbetur të pakryera. Në vitin 2021 gjykata nuk e ka tejkualuar fluksin e lëndëve, si edhe vitin e kaluar 2020, numri i lëndëve që kanë mbetur është rritur për 220 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Gjatë vitit 2021 janë pranuar 752 lëndë dhe të gjitha janë kryer, nuk ka lëndë të pakryera nga viti i kaluar.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Sektori penal

Në këtë sektor, Gjykata e ka filluar vitin me 381 lëndë që kanë mbetur të pakryera, në vitin 2021 gjykata ka pranuar 2323 lëndë të reja, 22 lëndë të pranuar përsëri në punë, gjithsej në punë nga kjo sferë ka pasur 2726 lëndë. Në vitin 2021 ka pasur 2145 lëndë të kryera, 572 lëndë kanë mbetur të pakryera. Fluksi vjetor i lëndëve të reja është rritur, është rritur edhe numri i lëndëve të kryera, por fluksi nuk është tejkualuar, është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera në krahasim me vitin 2020.

Sektori civil

Në sektorin civil të gjykatës nga viti 2020 kanë mbetur 102 lëndë, në vitin raportues 2021 janë pranuar 1240 lëndë të reja, 6 lëndë të pranuar përsëri në punë apo gjithsej në punë në këtë sektor kanë qenë 1348 lëndë, janë kryer 1217 lëndë, kanë mbetur të pakryera 131 lëndë. Edhe pse është rritur numri i lëndëve në krahasim me vitin 2020, fluksi vjetor i lëndëve edhe në këtë sektor nuk është tejkualuar.

Cilësia e punës mbi të gjitha bazat

Gjatë vitit 2021 nga gjithsej 1179 lëndët e kryera, 51 lëndë kanë qenë të konfirmuara apo 4,3%, të abroguara 23 apo 1,9% dhe të ndryshuara 8 apo 0,7%.

Sektori penal nga 919 lëndët e kryera, 29 lëndët kanë qenë të konfirmuara apo 3,15%, të abroguara kanë qenë 18 lëndë apo 1,95% dhe të ndryshuara kanë qenë 6 lëndë apo 0,65%.

Sektori civil nga 260 lëndët e kryera, 22 lëndë kanë qenë të konfirmuara apo 8,46%, 5 lëndë të abroguara apo 1,92% dhe 2 lëndë të ndryshuara apo 0,77%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata vitin 2021 e ka përfunduar me gjithsej 12 lëndë të vjetra edhe atë: 1 lëndë nga viti 2015, 3 lëndë nga viti 2018 dhe 8 lëndë nga viti 2019.

Në krahasim me vitin e kaluar 2020 kur numri i lëndëve që ishin të pakryera ishte 20 lëndë, në vitin 2021 është zvogëluar numri i lëndëve të vjetra.

Burime njerëzore

Në vitin 2021 gjykata ka punuar me dy gjyqtarë dhe UD kryetarin e gjykatës. Një nga gjyqtarët që punon në materien penale me Vendim të Këshillit gjyqësor është deleguar për kryerjen e funksionit të gjyqtarit nga Gjykata Themelore Koçan në Gjykatën Themelore Viniçë deri më 12.05.2022.

UD Kryetar i Gjykatës Themelore Viniçë, i cili është edhe gjyqtar në Gjykatën Themelore Shtip, krahas punëve të kryetarit, i realizon edhe punët e administratorit pasi që

gjykata nuk ka administrator, pastaj vepron edhe mbi lutjet, vërtetimet e marrëveshjeve, vërtetimin e dokumenteve me Apostil dhe vulë KRI. Në rast të përjashtimit të gjykatës të një gjyqtari nga materia penale apo sfera civile kërkohet që Gjykata e Apelit Shtip të caktojë një gjykatë tjetër apo delegimin e gjyqtarëve nga një gjykatë tjetër nga rajoni i Gjykatës Themelore Shtip.

Gjykata në vitin 2021 ka punuar me 19 nëpunës gjyqësor dhe plotësimi i tillë i vendeve të punës nuk i përgjigjet vëllimit të punës. Në fakt, në fund të vitit 2020 dhe fillim të vitit 2021 janë zbrazur dy vende pune, për pranim dhe dorëzim të postës dhe udhëheqës të sportelit, të njëjtët nuk janë paraparë as në Planin vjetor për punësim për vitin 2022. Vendi i punës – udhëheqës sporteli në sektorin civil nuk është plotësuar dhe punët në këtë vend pune i janë shpërndarë në mënyrë plotësuese udhëheqësve të sportelit penal dhe atyre për realizimin e sanksioneve.

Kapacitete hapësinore

Ndërtesa në të cilën është vendosur gjykata nuk i përmbush në tërësi nevojat e gjykatës, në fakt, mungon edhe një sallë gjykimi dhe një hapësirë magazine, siç ka qenë gjendja edhe në vitin e kaluar raportuese 2020. Gjykata ka vetëm një automjet, disponon me teknologji informatike, por duhet edhe ri përtëritja e lidhjes së rrjetit ekzistues që është konstatuar edhe në raportin për këtë gjykatë për vitin 2020.

KONSTATIME PËRFUNDIMATRE ME PROPOZIM MASA

Krahasuar me vitin 2020, është rritur numri lëndëve që kanë mbetur, fluksi i lëndëve nuk është tejkaluar, në mënyrë që Gjykata Themelore Vinicë është gjykatë e pa përditësuar, nevojitet pajisja e tërësishme e gjykatës si për atë sa i përket numrit të gjyqtarëve ashtu edhe në pjesën e nëpunësve gjyqësor sipas akteve me të cilat është caktuar numri i nevojshëm i gjyqtarëve dhe nëpunësve.

GJYKATA THEMELORE DELLÇEVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2021 në nivel të gjykatës ka pasur gjithsej 5.862 lëndë, nga të cilat 4.683 lëndë janë të kryera, përderisa 1.179 lëndë udhëhiqen si të pakryera. Fluksi është tejkaluar, përkatësisht janë kryer gjithsej 79,88% nga gjithsej numri i lëndëve në vitin 2021.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në punë ka pasur 640 lëndë, janë kryer 636 lëndë, kanë mbetur të pakryera 4 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Janë kryer 1.247 lëndë, nga të cilat 91 lëndë apo 80,53% janë të konfirmuara, të abroguara 15 përkatësisht 13,27% dhe të ndryshuara 7 përkatësisht 6,19%.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Spektori penal

Në punë ka pasur gjithsej 677 lëndë, nga të cilat 467 janë të kryera, ndërsa 210 kanë mbetur të pakryera.

Cilësia e punës: Janë kryer 467 lëndë, nga të cilat 9 përkatësisht 60% janë të konfirmuara, të abroguara 4 përkatësisht 26,66%, të ndryshuara 2 përkatësisht 13,33%.

Spektori civil

Në punë ka pasur gjithsej 513 lëndë, nga të cilat 239 janë të kryera, kanë mbetur 274 lëndë të pakryera.

Cilësia e punës: Janë kryer 239 lëndë nga të cilat 76 përkatësisht 86,36% të konfirmuara, të abroguara 8 përkatësisht 9,1%, të ndryshuara 4 përkatësisht 4,54%.

Sektori për kundërvajtje

Në punë ka pasur gjithsej 931 lëndë, nga të cilat 541 janë të kryera, 390 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Cilësia e punës: Janë kryer 541 lëndë, nga të cilat 6 përkatësisht 60% të konfirmuara, të abroguara 3 përkatësisht 30%, të ndryshuara 1 përkatësisht 10%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fillim të vitit 2021 kanë mbetur 33 lëndë të pakryera, janë pranuar 51 lëndë të reja, gjithsej në punë ka pasur 84 lëndë, nga të cilat 30 lëndë të kryera ndërsa kanë mbetur 54 lëndë të pakryera.

Burime njerëzore

Në vitin 2021 në Gjykatën Themelore Dellçevë gjithsej ka pasur 32 persona të punësuar, nga të cilët dy gjyqtarë, ndërsa njëri prej tyre është kryetar. Me Vendim të Këshillit gjyqësor në Gjykatën Themelore Dellçevë, përkohësisht është deleguar një gjyqtar nga Gjykata Themelore Koçan që të realizojë funksionin e gjyqtarit për një kohë prej 6 muajsh, ndërsa në muajin shkurt i është vazhduar delegimi edhe për 6 muaj. Sipas sistematizimit, funksionin e gjyqtarit duhet ta ushtrojnë katër gjyqtarë me kryetarin e gjykatës. Sipas sistematizimit, planit për punësim, për vitin 2021 dhe nevojat reale të gjykatës, duhet punësimi i së paku 5 nëpunësve gjyqësor të kategorive të ndryshme. Në vitin 2021 në gjykatë nuk ka punësime të reja, por as edhe avancime.

Kapacitete hapësinore

Gjykata Themelore Dellçevë punon në ndërtesë, në të cilën tri hapësira i shfrytëzon Prokuroria Publike Dellçevë, me hyrje të veçantë. Theksohet nevoja për rinovimin urgjent të nxehjes me avull dhe ndërrimin e dy kazanëve me avull. Nevoja për rinovimin është theksuar edhe në raportin e punës së Gjykatës Themelore Dellçevë për vitin 2020. Gjithashtu nevojitet të vendoset derë detektor në hyrjen e gjykatës dhe të vendosen kamera të cilat deri tani nuk janë vendosur, për përmirësimin e gjendjes së sigurisë së gjykatës.

Në këtë gjykatë zbatohet AKMIS sistemi. Një sallë gjykimi është pajisur me incizimin tonik të seancave dhe e njëjta shfrytëzohet. Sa i përket teknologjisë informatike, e njëjta i përmbush nevojat momentale. Aplikacionet programore në gjykatë funksionojnë mirë. Është formuar zyra për marrëdhënie me publikun, që çdo ditë realizon kontakte me qytetarë dhe me palë në aspektin e marrjes së informacioneve nga puna e gjykatës. Gjithashtu është caktuar një person për marrëdhënie me publikun.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë të dhënave të ekspozuara, rezulton se Gjykata Themelore Dellçevë gjatë vitit 2021 ka qenë e përditësuar, ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve dhe të kryejë 79,88% nga gjithsej numri i lëndëve në punë. Në fillim të vitit 2021 kanë mbetur 992 lëndë të pakryera, ndërsa gjithsej në vitin 2021 kanë qenë në punë 5.862 lëndë, nga të cilat 4.683 janë kryer, përderisa 1.179 udhëhiqen si të pakryera, ashtu që rezulton se Gjykata Themelore Dellçevë gjatë vitit 2021 është **gjykatë e pa përditësuar**, pasi që nuk ka arritur të tejkalojë fluksin.

Propozim masa

Në bazë të dhënave të ekspozuara, rezulton se për përmirësimin e gjendjes në gjykatë, duhet përpjekje më të mëdha për përmirësimin e cilësisë së punës në nivel të gjykatës, dhe sidomos në sektorin penal;

ë merren masa për sigurimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve dhe plotësimin e vendeve tjera të nevojshme të punës,

Të shihet mundësia për ri pajisjen teknike, përkohësisht rinovimin e gjykatës si dhe përmirësimin e gjendjes së sigurisë së gjykatës, me vendosjen e derës detektorë të hyrjes së gjykatës dhe kamera.

GJYKATA THEMELORE KOÇAN

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në vitin raportues 2020, Gjykata Themelore Koçan, ka pasur në punë gjithsej 14.422 lëndë, nga të cilat 2.487 lëndë si të pakryera janë bartur nga viti i kaluar, 11.826 janë lëndë të reja të pranuar, nga të cilat 3 gabimisht të evidentuara dhe 112 lëndë përsëri në punë.

Gjatë vitit raportues nga gjithsej numri i lëndëve në punë, gjykata ka kryer 12.399 lëndë dhe kanë mbetur 2.023 lëndë të pakryera. Gjykata Themelore Koçan gjatë vitit 2021 e ka tejkualuar fluksin e lëndëve, ndërsa e ka ulur numrin e lëndëve që kanë mbetur për 464 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në fillim të vitit 2021 kanë mbetur 11 lëndë të pakryera. Gjatë vitit 2021 numri i lëndëve të reja të pranuar është 2.160 lëndë. Gjithsej numri i lëndëve në punë në vitin 2021 është 2.171 lëndë. Gjithsej numri i lëndëve të kryera në vitin 2021 është 2.168 lëndë, 3 lëndë janë të pakryera.

Spektori penal

Nga viti i kaluar 2020, në sektorin penal kanë mbetur 1.826 lëndë të pakryera.

Numri i lëndëve të pranuar të reja në vitin 2021 është 6.812 lëndë, lëndë përsëri në punë ka pasur 62 dhe 2 lëndë kanë qenë lëndë gabimisht të evidentuara.

Gjithsej numri i lëndëve në punë gjatë vitit 2021 është 8.700 lëndë.

Gjithsej numri i lëndëve të kryera gjatë vitit 2021 në sektorin penal është 7.183 lëndë, ndërsa 1.517 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Spektori penal i Gjykatës Themelore Koçani e ka tejkualuar fluksin e lëndëve, ndërsa e ka zvogëluar numrin e lëndëve që kanë mbetur për 309 lëndë.

Cilësia e Sektorit penal

Nga 2.543 lëndët e ankimuar që janë kthyer gjatë vitit 2021, të konfirmuara janë 134 lëndë apo 5,3%, të abroguara janë 45 lëndë apo 1,8% dhe të ndryshuara janë 19 lëndë apo 0,7% lëndë.

Spektori civil

Nga viti i kaluar 2020, në sektorin civil kanë mbetur 648 lëndë të pakryera.

Numri i lëndëve të pranuar të reja në vitin 2021 është 2.854 lëndë, 50 lëndë janë përsëri në punë dhe 1 lëndë është gabimisht e evidentuar.

Gjithsej numri i lëndëve në punë gjatë vitit 2021 është 3.551 lëndë.

Gjithsej numri i lëndëve të kryera gjatë vitit 2021 në sektorin civil është 3.048 lëndë.

Deri në fund të vitit 2021 kanë mbetur 503 lëndë të pakryera.

Spektori civil i Gjykatës Themelore Koçani e ka tejkualuar fluksin e lëndëve dhe ka zvogëluar numrin e lëndëve që kanë mbetur për 145 lëndë.

Cilësia e sektorit civil

Nga 857 lëndët ankimore dhe të kryera, që janë kthyer gjatë vitit 2021, janë konfirmuar 209 lëndë apo 24,4%, të abroguara janë 43 lëndë apo 5% dhe të ndryshuara janë 14 lëndë apo 1,6%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit 2021 në Gjykatën Themelore Koçan, në punë ka pasur gjithsej 304 lëndë të vjetra, më të vjetra se 2 vite, gjatë vitit më të vjetra se 2 vite kanë mbetur edhe 284 lëndë, apo gjithsej në punë ka pasur 588 lëndë më të vjetra prej 2 vite, nga të cilat 379 janë kryer, ndërsa kanë mbetur të pakryera 209 lëndë të vjetra. Nga këtu, mund të arrihet në përfundim

se në fund të vitit 2021 numri lëndëve që kanë mbetur në krahasim me fillimin e vitit është zvogëluar për 95 lëndë.

Konstatime të shkurta mbi kushtet e punës

Kapacitete hapësinore

Gjykata ballafaqohet me mungesë të sallave të gjykimit, për arsye se një pjesë e konsideruar e kapaciteteve hapësinore i shfrytëzojnë Prokuroria Themelore Publike dhe Avokatura e Shtetit. Kapacitetet hapësinore nuk i përmbushin nevojat e gjykatës edhe sa i përket nëpunësve gjyqësor edhe krahas funksionimit të mirë të sistemit sportel.

Teknologjia informatike

Gjykata është e pajisur me teknologjinë informatike e cila maksimalisht shfrytëzohet për evidentimin e plotë të lëndëve gjyqësore me shfrytëzimin e tre aplikacioneve të softuerit.

Burime njerëzore

Në Gjykatën Themelore Koçan sipas Rregullores për organizmin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës, në këtë gjykatë janë paraparë 88 vende pune, nga të cilët deri më 31.12.2021 ka pasur gjithsej 41 nëpunës.

Në Gjykatën Themelore Koçan gjatë vitit janë zbrazur 5 vende pune.

Sipas Vendimit të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për Gjykatën Themelore Koçan është paraparë të veprojnë dhe të ushtrojnë funksionin e gjyqtarit 10 gjyqtarë, megjithatë me pensionimin e gjyqtarëve dhe shkarkimin e një gjyqtari me kërkesën e tij gjatë vitit 2021, në momentin kanë qenë të plotësuara vetëm 8 vende, por megjithatë kanë vepruar vetëm 7 gjyqtarë, ngase vetëm 1 gjyqtar me anë të delegimit gjatë vitit 2021 funksionin e gjyqtarit e ka ushtruar në Gjykatën Themelore Vinicë, ku qëndron edhe më tej.

Me këtë numër të gjyqtarëve është vështirësuar edhe formimi i këshillave, në mënyrë që është paraqitur nevoja nga përjashtimi në lëndët penale për shkak të një gjyqtari të caktuar me ligj që të veprojë në ndonjë lëndë. Problemi rreth emërimit të një gjyqtari të dytë të këshillit gjykues prej 5 anëtarëve, dhe me atë edhe nevoja e shpeshtë që të kërkohet caktimi i një gjykate tjetër të veprojë mbi lëndë penale, por edhe domosdoshmëria e gjyqtarëve që janë të specializuar të punojnë në materien civile të marrin në punë edhe lëndë për kundërvajtje dhe ndonjëherë edhe lëndë penale.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Koçan është **gjykatë e përditësuar**, ngase e ka tejkuluar fluksin e lëndëve dhe e ka zvogëluar numrin e lëndëve që kanë mbetur në nivel të gjykatës.

Propozim masa

Të sigurohen disa kapacitete hapësinore për salla gjykimi, zyra për punonjësit dhe hapësira për avokatë.

Të tentohet në vazhdimësi në plotësimin e vendeve të zbrazura të punës për nëpunësit gjyqësor me profile të ndryshme, ngase numri i këtyre vendeve të punës gjatë vitit raportues është i dukshëm.

Gjithashtu duhet të plotësohen vendet e zbrazura të gjyqtarëve për realizimin papengesë të Orarit vjetor të punës së gjykatës.

GJYKATA THEMELORE RADOVISH

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2021 në Gjykatën Themelore Radovish janë pranuar 8197 lëndë, nga viti i kaluar 2020 kanë mbetur 602 lëndë të pakryera, përsëri në punë kanë qenë 62 lëndë, apo gjithsej në punë ka pasur 8861 lëndë. Janë kryer 7922 lëndë, 939 lëndë kanë mbetur të pakryera. Fluksi i lëndëve të reja nuk është tejkaluar, edhe pse gjykata ka kryer më shumë lëndë në krahasim me vitin e kaluar 2020, njëkohësisht ka pranuar edhe disa lëndë të reja. Është rritur edhe numri i lëndëve të pakryera në krahasim me vitin 2020, për 337 lëndë më shumë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në vitin 2021, gjykata ka pranuar 860 lëndë të reja nga administrata gjyqësore, 1 lëndë ka mbetur e pakryer nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 861 lëndë, nga të cilat 860 lëndë janë kryer, ka mbetur e pakryer 1 lëndë, është tejkaluar fluksi i lëndëve.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Në vitin 2021 nga 58 lëndët e kthyer të ankesave nga Gjykata Themelore Shtip 101 lëndë apo 6,55% janë të konfirmuara, të abroguara janë 35 lëndë apo 2,27% dhe 19 lëndë apo 1,23% të ndryshuara, dhe 1 lëndë pjesërisht e abroguar apo 0,06%, 2 lëndë janë të hedhura poshtë apo 0,12% nga gjithsej lëndët e kryera.

Spektori penal

Në fillim të vitit 2021 ky Sektor ka pasur 210 lëndë të pakryera, 1538 lëndë të reja të pranuar (K, K-PP, KS, PRK), 17 lëndë të pranuar përsëri në punë ose gjithsej 1765 lëndë. Janë kryer 1184 lëndë, 581 lëndë kanë mbetur të pakryera, fluksi i lëndëve të reja nuk është tejkaluar. Numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera në fund të periudhës raportuese, për lëndët penale ka qenë 86 lëndë dhe është zvogëluar në krahasim me vitin 2020. Sa i përket lëndëve K-PP për vitin 2021, nuk ka lëndë të pakryera-lëndë të mbetura. Te lëndët për kundërvajtje është rritur numri i lëndëve në punë për 702 lëndë në krahasim me vitin e kaluar, njëkohësisht edhe numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera është rritur për 376 lëndë.

Cilësia e punës në këtë Sektor është si vijon: Nga gjithsej 1128 lëndët e kryera, 42 apo 3,72% lëndë janë të konfirmuara, të abroguara janë 12 lëndë apo 1,06%, të ndryshuara 13 lëndë apo 1,15%. Cilësia e punës në këtë Sektor është përmirësuar në krahasim me vitin e kaluar 2019.

Spektori civil

Në vitin raportues 2021 në këtë Sektor në punë ka pasur gjithsej 533 lëndë, 327 lëndë të reja, përsëri në punë 29 lëndë, numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera në fillim të vitit ka qenë 177 lëndë, janë kryer 413 lëndë, 120 lëndë kanë mbetur të pakryera. Numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera në periudhën raportuese është zvogëluar për 57 lëndë në krahasim me vitin 2020 kur ka pasur 177 lëndë të pakryera, është tejkaluar fluksi i lëndëve të reja në këtë sektor.

Cilësia e punës në këtë Sektor është si vijon: Nga gjithsej 413 lëndët e kryera, 59 lëndë janë të konfirmuara apo 14,2%, 23 lëndë të abroguara apo 5,56%, 1 lëndë është pjesërisht e abroguar apo 0,24% dhe të ndryshuara janë 3 apo 0,72% lëndë.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit 2021 gjykata ka vepruar për 118 lëndë të vjetra me 73 lëndët e bartura nga viti 2020. Në fund të vitit 2021 kanë mbetur të pakryera 2 lëndë penale nga viti 2019, 45 lëndë trashëgimore, 8 lëndë për vuajtje të dënimit me burg, 3 lëndë për kundërvajtje, 4 lëndë jashtë kontestimore dhe 1 lëndë VPP1. Është konstatuar rritja e numrit të lëndëve të vjetra të pakryera në krahasim me vitin e kaluar 2020.

Burime njerëzore

Gjykata ka punuar me një numër të vogël të gjyqtarëve nga numri i paraparë, që sipas vendimit të Këshillit gjyqësor të RMV numëron 6 gjyqtarë. Funkcionin e gjyqtarit në këtë gjykatë e kanë realizuar UD Kryetar i gjykatës deri më 08.05.2020 dhe 3 gjyqtarë,

ndërsa nga 08.05.2020, kryetari i gjykatës dhe 3 gjyqtarë, nga të cilët njërit nga gjyqtarët me kërkesën e tij i ka pushuar funksioni më 25.05.2021. Gjykata ka punuar me një numër të vogël të gjyqtarëve nga numri i paraparë, që sipas vendimit të Këshillit gjyqësor të RMV numëron 6 gjyqtarë.

Gjykata Themelore Radovish, si edhe vitin e kaluar ashtu edhe vitin 2021 është e vendosur në ndërtesën në të cilën krahas gjykatës janë të vendosur edhe Prokuroria Themelore Publike Radovish dhe njësitë rajonale të Agjencisë për kadastër dhe patundshmëri dhe Drejtoria e të ardhurave publike. Të gjitha këto organe përdorin hyrjen e përbashkët, vendin e përbashkët të korridorit, instalim të pjeshëm dhe të përbashkët, gjë kjo që shkakton probleme të karakterit organizativ, sidomos në pjesën e sigurimit, sigurimin përkatës të njerëzve dhe pronës në ndërtesën e gjykatës, gjykata nuk ka bibliotekë të posaçme, disponon me pajisje informatike. Me furnizimin e kompjuterëve si në vitin raportues, ashtu edhe në vitin e kaluar është përmirësuar dukshëm pajisja informatike, me atë është përmirësuar kapaciteti dhe realizimi i veprimeve dhe të punës në përgjithësi të gjykatës.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Radovish në vitin 2021, ka qenë **gjykatë e pa përditësuar**, nuk ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve të reja, është rritur numri i lëndëve të pakryera në 602 lëndë, që paraqet rritje për 18 lëndë.

Cilësia e vendimeve të marra është në nivel të mirë. Propozim masat, në një afat kryesisht të shkurtër të plotësohen vendet e zbrazura të gjyqtarëve dhe vendet e punës për nëpunës gjyqësor.

GJYKATA THEMELORE SVETI NIKOLLË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2021 në Gjykatën Themelore Sveti Nikollë, të pakryera nga viti i kaluar kanë mbetur 360 lëndë, janë pranuar 5.317 lëndë të reja, përsëri në punë janë 44 lëndë, gabimisht të evidentuara 2 lëndë, gjithsej në punë kanë qenë 5,719 lëndë, janë kryer 4.796 lëndë, ndërsa kanë mbetur 923 lëndë të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në fillim të vitit raportues 2021 janë pranuar 880 lëndë të reja, gjithsej në punë ka pasur 880 lëndë, nga të cilat janë kryer 880 lëndë, lëndë të pakryera nuk ka.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Spektori penal

Në fillim të vitit 2021 ka pasur 207 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 2.951 lëndë, përsëri në punë janë 17 lëndë, 2 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej në punë 3.173 lëndë, janë kryer 2.447 lëndë, ndërsa kanë mbetur 726 lëndë të pakryera.

Cilësia e punës në këtë sektor është si vijon: nga gjithsej 2.447 lëndët e kryera 34 apo 1,39% lëndë janë të konfirmuara, të abroguara janë 13 apo 0,53% dhe të ndryshuara janë 3 lëndë apo 0,12%.

Spektori civil

Në fillim të vitit 2021, ka pasur 153 lëndë të pakryera, janë pranuar 1487 lëndë të reja, përsëri në punë kanë qenë 26 lëndë, gabimisht të evidentuar 0 lëndë, gjithsej në punë 1666 lëndë, janë kryer 1469 lëndë, ndërsa 197 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Cilësia e punës në këtë sektor është si vijon: nga gjithsej 1469 lëndët e kryera, 66 lëndë apo 4,49% janë të konfirmuara, të abroguara janë 14 lëndë apo 0,95% dhe të ndryshuara janë 7 apo 0,48%.

Cilësia e punës në nivel të gjykatës është si vijon: nga gjithsej 4.796 lëndët e kryera, 100 lëndë apo 2,08% janë të konfirmuara, të abroguara janë 27 lëndë apo 0,56% dhe të ndryshuara janë 10 apo 0,21%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fund të vitit raportues, nga lëndët që i kanë kryer gjyqtarët, kanë mbetur 6 lëndë të vjetra të pakryera nga realizimi i sanksioneve të cilët për të parën herë janë evidentuar në vitin 2019, 1 lëndë e vjetër e pakryer nga ato penale për persona madhor që herën e parë janë evidentuar në vitin 2018 dhe 1 lëndë e vjetër e pakryer për ndarje fizike e evidentuar herën e parë në vitin 2019.

Burime njerëzore

Në Gjykatën Themelore Sveti Nikollë për realizimin e funksionit të gjyqtarit janë paraparë 4 gjyqtarë. Gjatë vitit 2021 funksionin e gjyqtarit e kanë ushtruar 3 gjyqtarë të zgjedhur në gjykatë. Vendi nuk është plotësuar edhe për 1 gjyqtar.

Sipas Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në këtë gjykatë janë sistemuar 19 vende pune, ndërsa janë paraparë 40 realizues për vende të veçanta të punës.

Gjatë vitit 2021 gjykata ka punuar me 21 nëpunës gjyqësor.

Nevojitet punësimi me prioritet të dy realizuesve – policë në gjykatë, dhe njëkohësisht sipas sistematizimit ka disa vende të pa plotësuar, që në detaje janë theksuar në Raportin e punës në këtë gjykatë për vitin 2021.

Kapacitete hapësinore

Ndërtesa e Gjykatës Themelore Sveti Nikollë është ndërtuar në vitin 1976. Gjyqtarët janë të vendosur në zyra të veçanta, dhe ka zyra pune edhe për punonjësit tjerë të gjykatës.

Kapacitetet hapësinore janë të kënaqshme, nevojitet të ndërrohen dritaret, ngase janë të përpunuara nga druri dhe me kalimin e kohës kanë duruar deformime dhe dëmtime pasi që ka humbje të madhe të ngrohjes.

Teknologjitë informatike

Në gjykatë përdoret teknologjia informatike dhe në vitin 2021 janë siguruar 2 printerë me rrjete. Janë blerë edhe 1 shtëpizë kompjuteri dhe 1 UPS pajisje, nevojitet furnizimi edhe i 4 kompjuterëve më të fuqishëm me 64-bit-e.

Punësime të planifikuara dhe të realizuara

Në vitin e kaluar është planifikuar plotësimi i vendeve të punës, por asnjë punësim nuk është realizuar.

Vlerësimi i gjendjes së sigurisë së punonjësve, palëve, lëndëve dhe pajisjes së gjykatës sipas standardeve

Policia gjyqësore bën rregullisht kontrollin gjatë hyrjes së palëve dhe vizitorëve tjerë në gjykatë, por ka mungesë sa i përket pajisjes, uniformave dhe mjeteve teknike për realizimin e kontrollit dhe të njëjtët nuk janë të armatosur, që ndikon në gjendjen e sigurisë në gjykatë.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Sveti Nikollë, nuk ka arritur të tejkalojë fluksin dhe as të zvogëlojë numrin e lëndëve që kanë mbetur nga viti i kaluar dhe konsiderohet si **gjykatë e pa përditësuar**.

Propozim masa:

Nevojitet të plotësohen vendet e punës të gjyqtarëve dhe të kuadrit profesional – administrativ.

GJYKATA THEMELORE STRUMICË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata vitin e ka filluar me 3.514 lëndë, ndërsa ka pranuar 19.500 lëndë të reja. Të marra përsëri në punë 110 lëndë, ndërsa gabimisht të evidentuar 1 lëndë. Nga këtu, në punë ka pasur gjithsej 23.123 lëndë, nga të cilat 19.937 lëndë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur 3.186 lëndë. Fluksi i lëndëve është tejkaluar dhe është zvogëluar numri i lëndëve të mbetura për 328 lëndë, përkatësisht për 9,33% në krahasim me ato të vitit 2020.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore si lëndë në regjistrat përkatës është vepruar për 3.434 lëndë, janë kryer 3.418 lëndë, ndërsa procedura nuk është kryer në 16 lëndë.

Administrata gjyqësore është udhëhequr nga Kryetari i gjykatës Emil Gligorov.

Puna e lëndëve dhe cilësia e punës

Spektori penal

Nga viti i kaluar kanë mbetur 1.907 lëndë. Janë pranuar 10.133 lëndë të reja dhe 58 lëndë janë marrë përsëri në punë. Gjithsej në punë ka pasur 12.098 lëndë, nga të cilat 9.306 janë të kryera, përderisa 2.792 lëndë kanë mbetur të pakryera. Është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur për 885 lëndë apo për 46,41 %.

Te ky lloj i lëndëve cilësia e punës është si vijon: nga 3.119 lëndët e kryera (sipas të dhënave nga tabela nr.5 që nuk përshtatet me të dhënë për lëndët e kryera nga tabela nr.4) janë ankimuar 301 lëndë. Pas kësaj, 242 lëndë apo 7,76% janë të konfirmuara, 36 lëndë apo 1,15% janë të abroguara dhe 23 lëndë apo 0,74% janë të ndryshuara. Përqindjet janë fituar në raport me numrin e 3.119 lëndëve të kryera.

Spektori civil

Nga viti i kaluar ka pasur mbetje prej 1.607 lëndëve. Janë pranuar 9.367 lëndë të reja dhe me 52 lëndë të marra në punë, si dhe 1 lëndë gabimisht të evidentuar, gjithsej në punë ka pasur 11.025 lëndë. Janë kryer 10.631 lëndë, përderisa të pakryera kanë mbetur 394 lëndë. Numri i lëndëve që kanë mbetur është zvogëluar për 1.213 lëndë apo për 75,48%.

Te ky lloj i lëndëve cilësia e punës është si vijon: nga 1.148 lëndët (sipas një të dhëne nga tabela nr.5 që nuk përshtatet me të dhënat për lëndët e kryera nga tabela nr.4), të ankimuar janë 224 lëndë. Nga 152 apo 13,24% lëndët e ankimuar janë të konfirmuara, 3,40% janë të abroguara dhe 33 lëndë apo 2,87% janë të ndryshuara. Përqindjet janë marrë në raport me numrin e 1.148 lëndëve të kryera.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata Themelore Strumicë në fillim të vitit 2021 ka pasur 48 lëndë të vjetra. Në fund të vitit 2021 kanë mbetur 22 lëndë të vjetra, që do të thotë se numri është zvogëluar për 26 lëndë.

Burime njerëzore

Sipas sistematizimit në Gjykatën Themelore Strumicë, duhet të jenë të sistemuar 20 gjyqtarë, por gjatë vitit raportues funksionin e gjyqtarit e kanë ushtruar 11 gjyqtarë bashkë me Kryetarin e gjykatës.

Sipas Rregullores për organizim dhe sistematizim të brendshëm të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Strumicë janë paraparë 117 vende pune nga të cilat janë plotësuar 66.

Kapacitete hapësinore

Në Gjykatën Themelore Strumicë në vitin 2021 nuk është furnizuar me pajisje të re, ndërsa ekzistuesja është aktualisht e mirëmbajtur.

Gjykata ende ballafaqohet me mungesë të karrigeve në sallat e gjykimeve dhe në zyrat, sidomos që nga furnizimi i kaluar janë amortizuar 200 karrige, ashtu që prioritet i nevojshëm është furnizimi me karrige të reja.

Njëkohësisht, sipas të theksuarës dera me detektor metali në Gjykatë është në gjendje të keqe dhe duhet urgjentisht ndërrimi me një të ri, ndërsa Kryetari konsideron se nevojitet të sigurohet edhe një aparat skaner.

Vijon procedura për pajisjen e sallës më të madhe të gjykimit në Gjykatën Themelore Strumicë me audio dhe video pajisje digjitale për ndjekjen e gjykimeve.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Strumicë e ka tejkualuar fluksin dhe konsiderohet si **gjykatë e përditësuar**. Cilësia e punës dallohet edhe me përqindje të lartë të vendimeve jo ankimore dhe puna cilësore në krahasim me gjithsej lëndët e kryera.

Kushtet hapësinore dhe gjendja me pajisjen informatike është e përbushur.

Në periudhën e ardhshme duhet të përmirësohen kapacitetet e pajisjes informatike të gjykatës, të përmirësohet pajisja me kuadro, të furnizohet mobilie e domosdoshme, si dhe të ndërrohet detektor dera prej metali e vjetërsuar.

Nevojitet të vazhdohet me punë cilësore.

GJYKATA THEMELORE SHTIP

PUNA E LËNDËVE

Në fund të vitit 2020 kanë mbetur gjithsej 3379 lëndë të pakryera. Gjatë vitit 2021 janë pranuar gjithsej 21517 lëndë, 3 gabimisht të evidentuara dhe 256 lëndë të marra përsëri në punë apo gjithsej në punë ka pasur 25149 lëndë, 21916 lëndë kanë qenë të kryera, ndërsa kanë mbetur 3233 lëndë të pakryera.

Gjatë vitit 2021 nga administrata gjyqësore në punë kanë qenë gjithsej 1487 lëndë, ndërsa janë kryera të gjitha 1487 lëndët.

Cilësia në nivel të gjykatës

Sipas të dhënave për lëndë të kthyera nga Gjykata e Apelit gjatë vitit 2020, të konfirmuara janë 507 lëndë apo 7,4%, të abroguara janë 187 lëndë apo 2,76% dhe të ndryshuara janë 63 lëndë apo 0,93% në krahasim me gjithsej numrin e lëndëve.

Spektori civil

Në fund të vitit 2020 kanë mbetur 1406 lëndë të pakryera, gjatë vitit 2021 janë pranuar 5907 lëndë, 3 lëndë kanë qenë gabimisht të evidentuara dhe 143 lëndë janë marrë përsëri në punë apo gjithsej në punë ka pasur 7453 lëndë, nga të cilat 5872 janë të kryera, ndërsa kanë mbetur 1581 lëndë të pakryera.

Cilësia në Sektorin civil

Sipas të dhënave për lëndë të kthyera nga Gjykata e Apelit gjatë vitit 2021 të konfirmuara janë 385 lëndë apo 18,90%, të abroguara janë 110 lëndë apo 5,40% dhe të ndryshuara janë 30 lëndë apo 1,47% në raport me gjithsej lëndët e kryera.

Spektori penal

Në fund të vitit 2020 kanë mbetur 1972 lëndë të pakryera, gjatë vitit 2021 janë pranuar 14124 lëndë, ashtu që gjithsej në punë ka pasur 16209 lëndë, nga të cilat 14557 kanë qenë të kryera, ndërsa kanë mbetur 1652 lëndë të pakryera.

Cilësia në sektorin penal

Sipas të dhënave për lëndët e kthyera nga Gjykata e Apelit gjatë vitit 2021 të konfirmuara janë 122 lëndë apo 2,57%, të abroguara janë 77 lëndë apo 1,62%, ndërsa të ndryshuara janë 33 lëndë apo 0,70% në raport me gjithsej lëndët e kryera.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fillim të vitit 2021 gjykata në punë ka pasur 176 lëndë të vjetra, gjatë vitit janë pranuar 321 lëndë, ashtu që në punë ka pasur gjithsej 497 lëndë të vjetra, nga të cilat 322 janë të kryera, dhe në fund të vitit kanë mbetur 175 lëndë të vjetra të pakryera.

Burime njerëzore

Gjykata Themelore Shtip, në fillim të vitit 2020 ka punuar me 13 gjyqtarë nga të paraparat 19. Në muajin maj një gjyqtar, i cili përkohësisht është deleguar në Gjykatën Themelore Berovë është kthyer. Një gjyqtar ka shkuar në pension në muajin Gusht, ndërsa një gjyqtari i pezullohet funksioni pasi që është anëtarë në Këshillin gjyqësor. Mungon edhe personel administrativ në sportel, bashkëpunëtorë profesional, daktilografistë dhe personel teknik.

Kapacitete hapësinore

Kapacitetet hapësinore në të cilat funksionon gjykata nuk janë në nivel të kënaqshëm. Imponohet nevoja për disa salla gjykimi, duke qenë se gjyqtarët gjykojnë në kabinetet e tyre.

Për njësinë në Probishtip është siguruar dhe pajisur hapësirë për funksionimin normal të tij.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në Gjykatën Themelore Shtip në vitin 2021, gjithsej në punë ka pasur 25149 lëndë, nga të cilat të pranuar janë 21773 lëndë dhe 1486 nga administrata gjyqësore.

Janë kryer 21916 lëndë dhe 1487 nga administrata gjyqësore që tregon se fluksi është tejkualuar dhe është zvogëluar numri i lëndëve të mbetura për 143 lëndë.

Në vitin 2020 kanë mbetur 176 lëndë të vjetra, që tregon rritjen e lëndëve të vjetra për 62.

Gjykata Themelore Shtip, në vitin 2020 ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve dhe e ka zvogëluar numrin e lëndëve të mbetura, në mënyrë që e njëjta llogaritet si **gjykatë e përditësuar**.

Propozim masa

Në vitin 2022 të plotësohen të gjitha vendet e zbrazura të kuadrit profesional dhe personelit administrativo – teknik sipas sistematizimit.

Ri plotësimi me pajisje kompjuterike, furnizim me inventar dhe sigurimi i mjeteve për realizimin e furnizimeve të planifikuara.

Intensivi i bashkëpunimit me gjykatat më të larta dhe realizimi i planit për vendosjen e lëndëve të vjetra.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEANCA E PËRGJITHSHME**